



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 8 KORRIK 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 8. JULA 2010. GODINE

KORRIK – JULI
2010

E enjte, më 8 korrik 2010, ora 10:00

Drejtën seancën: Anëtarë i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Ibrahim Gashi.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, fillojmë me seancën.

Në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës, siç e dini, është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjatë deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Në bazë të nenit 47.3, deputetët e lajmëruar dhe të cilët kanë mbetur pa diskutuar, u jepet fjala në fillim të mbledhjes plenare të radhës.

Nga mbledhja e kaluar kanë mbetur pa diskutuar deputetët Driton Tali dhe Qamile Morina, ndërkaq sot është paraqitur deputetja Donika Kadaj – Bujupi, në emër të Grupit. E keni fjalën, zonja deputete!

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ajo çka desha të ngrejë sot si çështje, është ma tepër një kërkesë për Qeverinë e Republikës së Kosovës, po mungesa e tyre këtu sigurisht që, si zakonisht, kërkesat e deputetëve do të bien në vesh të shurdhër. Megjithatë, unë do ta them atë që e kam pasur në mendje ta them dhe lidhet me breshërin në Gjakovë, i cili ka sjellë dëme të mëdha ditëve të fundit. Do të thotë, breshëri që ka përfshirë territorin e komunës së Gjakovës të dielën pasdite, ka shkaktuar dëme të mëdha për fermerët gjakovarë, duke dëmtuar me të madhe kulturat bujqësore, të mbjella në pranverë dhe në vjeshtë. Fermerëve u ka shkuar munda i vitit kot ngase gruri, misri, perimet dhe pemët janë rrafshuar për toke. Komisionet të cilat kanë dalë në terren, nesër do të sjellin kërkesë në Qeverinë e Kosovës për kompensimin e këtyre dëmeve, dëmet që janë shumë të mëdha dhe përafërsisht sillen rreth gjysmë milioni euro, sipas të dhënave paraprake. Për të zbutur sado pak situatën e rëndë të krijuar, sidomos kur kihet parasysh që shpenzimet vjetore deri në ditën e sotme kur është dashur të korren të mirat, ne si grup parlamentar i kërkojmë Qeverisë së Kosovës që në periudhën sa më të shkurtër kohore të bëhet kompensimi i dëmeve. Edhe një herë do të dëshironim t'i kujtojmë Qeverisë së Kosovës se për dëmet e shkaktuara vitin e kaluar, komuna e Gjakovës nuk ka marrë asnjë dëmshpërblim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Nga deputetët e mbetur nga seanca e kaluar, fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Edhe kësaj here e mora fjalën për të kërkuar nga ART që çekun prej 16.200.000 eurove, sepse deri më tani as Qeveria, as Kuvendi, as EULEX-i, as Piter Feith nuk mund të bëjnë asgjë në këtë drejtim. Kësaj radhe do ta lus ambasadorin e SHBA-ve në Kosovë, të nderuarin zotëri Kristopher Dell, se ndoshta do të ketë sukses duke pasur parasysh autoritetin dhe respektin që kemi ne kosovarët për SHBA-në, për të gjitha që bëri SHBA-ja për Kosovën.

Zoti ambasador Dell,

Këtë lutje jam duke ua bërë juve edhe nga fakti se ju, i nderuari zotëri ambasador, jeni duke i ndihmuar Kosovës edhe në procesin e privatizimit dhe dhënies me koncesion të aseteve më të rëndësishme të Kosovës, si dhe jeni duke dhënë kontribut të madh edhe në luftën kundër korrupsionit. Ky çek ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me këto dy fusha, ka të bëjë me

korupsionin, sepse mbahet pa kurrfarë arsytimi ligjor çeku prej më shumë se tre vite e katër muaj. Një gjë të tillë e konfirmoi edhe kryetari i Bordit të ART-së, më 8 qershor në mbledhjen e Komisionit gjegjës, po citoj: “Kur është shtruar pyetja parlamentare, më pas kemi filluar investigimet dhe në arkiv është gjetur garancia, më pastaj paskan filluar investigimet dhe në arkiv është gjetur garancioni”. Kështu deklaron ky zotëria, sepse për buxhetin qindra miliardësh të Kosovës them me cinizëm, 16.200.000 euro nuk janë asgjë, dhe thotë njeriu se ART ka punë tjera më të rëndësishme se sa validitetin legal të tenderit për Operatorin e dytë mobil. Madje, kryetari i Bordit në atë mbledhje deklaron zyrtarisht se çekun nuk mund ta dorëzoj aty ku e ka vendin, sepse po e citoj: “Kemi iniciuar procedurën e vlerësimit në aspektin ligjor se çfarë implikimesh ka në shtetin e Kosovës për të vazhduar se a ka padi aktive gjyqësore dhe a ka pretendime pronësore nga ajo pjesë e konzorciumit”. Siç po e sheh, i nderuari zoti ambasador, në Kosovë zyrtarët edhe këso budallallëqe deklarojnë dhe pas tre vite e gjysmë japin këso broçkulla për arsytim. Ata nuk e kanë të qartë se janë disa institucione tjera që duhet të merren me kompleksitetin e tërheqjes së letrave në vlerë. ART, siç po shihet, nuk e ka të qartë që nuk është institucion, nuk është mekanizëm financiar as gjyqësor, se shteti i ka mekanizmat dhe i ka institucionet tjera që do të duhej të merreshin me këto gjëra, e ART të merret me rregullimin e sektorit të telekomunikacionit, ku mbizotëron një kaos me operatorët ilegalë.

Zoti ambasadorë, siç dihet, po të ndodhte një gjë e tillë në SHBA, njerëzit e involvuar nuk do të promovoheshin me karrierat e tyre, duke u bërë ambasadorë në shtetet e rëndësishme, apo riemëruar në të njëjtit bord, por do të suspendoheshin nga puna dhe përgjegjësit kryesor do të ndiqeshin penalisht, por jo në Kosovë, zoti ambasador Dell, siç jeni edhe ju dëshmitar. Ju faleminderit, me shpresë se zoti ambasador Kristopher Dell do të ndërmarr masa për ta alokuar atë çek. Ju falënderohem edhe një herë, qytetarë të nderuar!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

1. Deklarimi i deputetëve jashtë rendit të ditës

KRYETARI: Deputetë të nderuar,
Nga seanca e kaluar, deputetja Qamile Morina e ka fjalën.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar, por çështja për të cilën kam dashur të diskutoj, nuk është më aktuale, kështu që tërhiqem nga diskutimi.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, në kuadër të kësaj teme të lirë e shoh me interes që Qeveria e vendit, ashtu qysh ka përgatitur shumë strategji, të cilat i kemi aprovuar, disa tjera janë në vijim e sipër, mendoj se është me shumë rëndësi të përgatit edhe strategjinë për vitin 2011 deri në vitin 2020 lidhur me ndërtimin e infrastrukturës, qoftë të asaj hekurudhore, qoftë të magjistraleve, qoftë të rrugëve të tjera që kanë të bëjnë, pra, në mes të komunave dhe kështu me radhë. Mendoj që deri në vjeshtë ka kohë dhe atëherë kur do të aprovojmë Buxhetin për vitin 2011 dhe Kornizën afatmesme, në mënyrë të veçantë, është mirë që ta bëjnë gati edhe këtë strategji që thashë, bashkë me strategjitë e tjera, sepse është me rëndësi për zhvillimin e përgjithshëm të vendit në pajtim me politikat që i bën Qeveria, që s’kam asnjë dilemë se besoj do të ndërtohet një strategji që do të ketë, pra, të them kështu, orientime themelore që të ndërtohen edhe ato pjesë të hekurudhës qoftë në jug, në veri, në perëndim apo në lindje të Kosovës.

Prandaj, që të kemi pra standarde, që përcaktojnë realisht, pra, secila në pajtim me ligjin, cilat janë rrugë regionale, magjistrale dhe të tjera, që të mos kemi edhe korridore, edhe laramani nganjëherë, që po japin një keqkuptim tjetër, mendoj që është me shumë rëndësi, pra, që kjo punë të bëhet deri në vjeshtë. Dhe do të jetë me interes të jashtëzakonshëm, pra, që të kemi një zhvillim harmonik, duke u bazuar mbi politikat e drejta të arsyeshme që janë me interes të ndërtimit të infrastrukturës, duke u nisur qoftë nga ato që kanë edhe karakterin politik, po edhe ekonomik, në mënyrë të veçantë, pra, që të gjithë qytetarët ta gëzojnë këtë infrastrukturë. Kështu, edhe një herë po e potencoj nevojën për një strategji për ndërtimin e infrastrukturës, të përgatitet për vjeshtë edhe ta kemi gati ta aprovojme bashkë me kornizën, sepse mendoj që viti tjetër do të jetë viti i zgjedhjeve, pastaj do të fillojnë të gjitha partitë të ndërtojnë, por është tepër vonë atëherë. Mendoj që mund të bëhet gati Qeveria dhe bashkërisht të jemi pjesë e kësaj strategjie. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryetar i Kuvendit,

Zotëri kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Grupi kuvendor i Aleancës Kosova e Re, pa dyshim, me bazë përjeton shqetësim referuar indolencës edhe indiferencës së disa nga ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilët nuk e ushtrojnë funksionin e ekzekutivit në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që i ka krejt 162 nene. Konkretisht, nuk i përfillin vendimet e formës së prerë të përmbarueshme, përfundimtare, që është obligim primar i ministrave. Nuk quhet rastësisht Qeveria ekzekutiv. Qeveria e ka për detyrë ekzekutimin e padiskutueshëm të akteve të formës së prerë, ju lutem, eventualisht do të mund të ngritte, po e zëmë, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë apo për rishikim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë, ama duhet përmbaruar. Nuk është fjala për një..., vetëm një vendim ose aktvendim, apo aktgjykim i tillë i formës së prerë po të ishte, do të ishte shqetësuese. Janë mbi 60 akte juridike administrative, të cilat nuk i ekzekuton. Janë edhe 45 apo 6 të tilla që nuk ka raportime. Prandaj, apeli jonë është ky që të përmbarohen vendimet e formës së prerë dhe në atë mënyrë të zbatohet ligji. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, Slobodan Petroviqi e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvaženi premijeru, zameniče premijera, ministri, narodni poslanici,

Čuli ste pre 4 dana šta se desilo u severnoj Mitrovici. Ono što nisam bio u prilici da tog dana budem u Parlamentu, imam i političku i moralnu obavezu da vas informišem i ujedno da se zahvalim svim poslaničkim grupama koje su osudile ovaj teroristički akt. Ono što mogu da kažem da, evo samo danas smo dobili pismo gotovo od svih vlada u regionu, dobili smo pismo iz Brisela, gde se osuđuje ovaj teroristički akt i ujedno daje podrška za dalju našu aktivnost. Ono što gospodine predsedniče ja imam potrebu da kažem vama i uvaženim kolegama, da evo već četvrti dan se istraga ne vodi za ovaj nemili događaj i to je posebno nešto što treba da zabrine sve nas ovde. Ja sam isto uputio kritike i na račun EULEX-a, ICO-a i svih onih struktura koje su obavezne da sprovode bezbednost za sve građane Kosova, posebno ako imamo evo već činjenicu da jedan visoki funkcioner koji se bavi politikom, u interesu zaštite građana bude na njega izvršen atentat i da se jednostavno četiri dana ništa ne rešava, to je sigurno za sve nas jedno ozbiljno pitanje.

Napad na člana ove Skupštine, u svakom društvu, u normalnom svetu ugrožava demokratiju, ugrožava i preti zakonodavnoj grani vlasti, ozbiljno destabilizuje društvo i ja mislim da mi kao najviša institucija imamo obavezu i odgovornost da pokrenemo i motivišemo sve one koji su zaduženi da sprovedu istragu. Svesni ste isto činjenice da se već pokušava da se manipuliše sa počinioćima i ja vas upozoravam da ne bi se prebacilo na drugu stranu, molim vas da najozbiljnije shvatite ovo. Ono što mogu da vam kažem iz prve ruke, da postoje policajci na severu Kosova koji su u okviru KPS-a, koji sumnjaju da ima i u okviru KPS-a ljudi koji ne žele da se istraga sprovede. Isto želim javno da vam kažem da postoje i kamere koji su snimale to na zgradi OSCE-a, na zgradi Raiffaisen banke, na zgradi Studentskog doma i policajci koji žele da reše ovaj slučaj, jednostavno treba da dobiju mandat. Još jednom vas upozoravam vreme prolazi, ti dokazi će polako da se gube i doći ćemo ponovo u situaciju da može neko da optužuje ili jednog ili drugog. Ovaj počinioć ima jasno ime, to je kriminalac, to je atentator koji je pucao na sve nas zajedno. Ja vas molim da najozbiljnije shvatite ovo, znam da nije sve u našim rukama, ali vas molim i vas predsedniče, i vas premijeru, i vas zameniče premijera, i vas ministre, i vas narodne poslanike da uzmete učešće, date vaš doprinos u rešavanju ovog slučaja. Još jednom se zahvaljujem u ime Samostalne liberalne strane, u ime porodice Miletić, koji svima onima koji su u ovim teškim momentima dali podršku za prevazilaženje ovoga. Ja kao predsednik Samostalne liberalne strane odgovorno tvrdim i kažem da se mi nismo uplašili, na protiv, samo su nam dali još jedan motiv više i pokazali da smo na pravom putu, ali vas još jednom molim da nam date podršku kako bi pronašli počinioće pod hitno i da ih jednostavno privedemo pred licem pravde, jer više je dosta ovih aktivnosti, jer to ugrožava kompletno sve građane Kosova. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit shumë, Slobodan!
Fjalën e ka Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryetar!

E kam një lutje për juve, kryetar. Ju kisha lutur që në të ardhmen, kur të vinë propozimet nga grupet parlamentare pa arsytim për shkurtimin e kohës për deputetët, sidomos për të opozitës, mos t'i mbështetni kërkesat e tilla, sepse më duken shumë absurde. Fillon seanca në mëngjes, ne jemi duke bërë si ajo batuta e malazezëve – zgjohemi të lodhur. Prandaj, dëshiroj që në të ardhmen ta përdorni autoritetin e juaj, kur është e nevojshme që të kursehet koha, unë konsideroj që ju keni autoritet të mjaftueshëm të të gjithë deputetët dhe do të keni mirëkuptimin e deputetëve. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Më fal, nenin 40 të Rregullores është mirë ta lexoni, pika 2, në fakt pika 3: “Diskutimi i deputetëve në mbledhje plenare zgjatë deri në 10 minuta nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe”. Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar deputeti dhe anëtar i Kryesisë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër, zoti zëvendëskryeministër, zotërinj ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Dola që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të shprehë vlerësim më të lartë për paraqitjen e ministrit të Jashtëm, Skender Hyseni, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit. Mendoj që kjo është një paraqitje, e cila ka mposhtur në një organizatë ndërkombëtare pretendimet serbe se pavarësia e Kosovës nuk e ka qetësuar rajonin. Kjo është teza themelore që është shtruar nga ana e fqinjit tanë verior, që ka pretenduar të argumentohet me ndodhitë në veri, për të cilat u fol edhe para meje.

Unë mendoj që duhet të mbështetet kjo politikë argumentimi me institucionet ndërkombëtare dhe të vetëmbështetet në kuptimin e organizimit të rrjetit më të fortë përfaqësues diplomatik dhe në mbështetje profesioniste gjithë kësaj veprimtare, e cila ka ndërmarrë aksione, unë do të thosha të rëndësisë së veçantë në muajt e fundit dhe pritet të ketë aksione të tjera të rëndësishme për mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës dhe për njohje të reja të pavarësisë së saj. Edhe një herë po them që kjo politikë do të sprovohet edhe në ditët dhe muajt e ardhshëm dhe kjo do ta ketë presionin, siç po pritet, në ditët kur do të shpallet opiniononi këshillëdhënës i Gjyqit Ndërkombëtar. Sido që të jetë, ne po shohim që presionet diplomatike që vinë nga fqinji i veriut janë të jashtëzakonshme dhe unë në këtë pikë e përgëzoj Ministrinë e Jashtme dhe Qeverinë e Kosovës në aksionin kundërvënës diplomatik dhe politik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Edhe unë dua të vazhdoj ta lavdëroj Qeverinë pak. Mendoj që është hera e parë që ndoshta kryeministri ka thënë diçka të mirë herën e kaluar, kur tha që nuk do të flitet për ndarje dhe mos të flasim, se sa më shumë flasim, është aq më keq. Mendoj që po ashtu është bërë një punë shumë e mirë me hapjen e Zyrës për regjistrimin civil në pjesën veriore të vendit, por sigurisht që do të ishte shumë më mirë po të kishim një strategji edhe më të mirë dhe po të kishte një qasje më të mirë në këtë drejtim, por me gjasë këtë kryeministri nuk e do. Problemi është që për ndarje, e keqe është që kanë folur dhe po flasin, kushtimisht ta quaj, njerëzit e kryeministrit. Për ndarjen e Kosovës vazhdimisht apo për trambe vazhdimisht flet kryetari i Kuvendit të Kosovës. Për trambe vazhdimisht flet ministri i Punëve të Brendshme, madje që në vitin 2007, kur doli në fushatën zgjedhore për kryetar të komunës, ai foli për herë të parë në Kosovë, e tha një zyrtar dhe, për çudi, i fitoi votat dhe u bë kryetar i komunës së Mitrovicës.

Unë mendoj që kryeministri Thaçi e ka një borxh të madh, përveç shumë borxheve të tjera qytetarëve të Kosovës, ka borxh t'ju tregojë se çka ka ndodhur në vitin 1999 në Mitrovicë, sepse atëbotë ai udhëhiqte të ashtuquajturën Qeveri të Përkohshme të Kosovës dhe ai atëbotë quhej drejtor politik i UÇK-së. Këtu është zanafilla e problemit dhe këtë ia ka borxh kryeministri aktual i Kosovës t'ua thotë qytetarëve të Kosovës. Është shumë e qartë që veriu është një gur i madh në qafë dhe pa e hequr atë gur, nuk do të ketë zhvillim të vendit.

Është po ashtu shumë e qartë se problemi nuk është në Mitrovicë, as në veri. Problemi është në Prishtinë, problemi është në Bruksel, problemi është në Uashington. Mitrovica mund të zgjidhet me bisedime, aq sa është zgjidhur me bisedime edhe çështja e Kosovës, megjithatë ka do ndryshime, se për zgjidhjen e problemit në Mitrovicë apo të problemeve nuk duhet as avion bombardues, nuk duhen as 78 ditë, mjaftoj vetëm 2 orë dhe atë pa dhunë.

Bisedimet që përflitet se i ka filluar Qeveria me Beogradin, mund të them që nuk ka bisedime dhe duhet ta dijë Qeveria se nuk ka bisedime me Beogradin pa shtrirjen e pushtetit në gjithë territorin e Kosovës. Përndryshe, çdo bisedë dhe çdo bisedim, përderisa nuk kemi shtrirje të pushtetit në tërë territorin e Kosovës, do të thotë bisedime për statusin, qoftë...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të jem pak më konkret, nuk do të ndalem për çështje shumë të mëdha, sepse konsideroj që edhe çështja e Mitrovicës dhe shumë çështje të tjera janë të nivelit shumë të lartë dhe besoj që nuk do të kemi mundësinë ndoshta sot këtu t'i zgjidhim.

Ju e dini që me Ligjin për deklarimin e pasurisë të gjithë zyrtarët janë obligativ që ta deklarojnë pasurinë dhe ne kemi një situatë ku vetëm zyrtarët e Agjencisë Antikorrupsion, për shkak të asaj që parashihet që Kuvendi i Kosovës të formojë një komision që do të mbikëqyrë punën e Agjencisë, nuk kanë pasur mundësi që deklarimin ta bëjnë më mënyrë publike. Prandaj, unë kërkoj që Kuvendi i Kosovës të autorizojë njërin nga komisionet parlamentare të përhershme që të jepet mundësia që zyrtarët e lartë të Agjencisë Antikorrupsion t'i mbushin formularët dhe t'i dorëzojnë në këtë komision. Nuk do të ishte shumë e mirë që Kuvendi i Kosovës të formojë komisione tjera parlamentare, sepse konsideroj edhe këto i kemi me shumicë. Prandaj, do të ishte mirë që Kuvendi sa më parë apo Kryesia e Kuvendit të marrë një vendim që të autorizojë njërin nga komisionet dhe t'ia japim mundësinë që edhe zyrtarët e Agjencisë Antikorrupsion ta deklarojnë pasurinë dhe ta bëjnë publike për qytetarë të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Unë, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës e shohim si shqetësim që stafi i ministrave, posaçërisht shoferët janë pasuruar marramendshëm, një pjesë e stafit por edhe shoferët kanë miliona euro gjatë këtij mandati. Kanë xhipa Q7, kanë xhipa X6 e turli farë xhipi. Prandaj, unë kërkoj nga prokurori i EULEX-it, unë kërkoj nga prokurori i Republikës së Kosovës që të hetohen këta njerëz, sepse këta njerëz në bazë të ligjit nuk kanë obligim për deklarim të pasurisë, nuk janë në pozicione të larta politike dhe meqë nuk janë në pozicione të larta politike, nuk hetohen as nga Agjencioni Antikorrupsion. Kërkoj, gjithashtu, edhe nga Agjencioni Antikorrupsion që kjo kategori e njerëzve të hetohet, kërkoj nga prokurori i EULEX-it që kjo kategori e njerëzve të hetohet sepse, zoti mos e bëftë, nëse e bëjnë ndonjë ndeshje, i humbë pasuria ministrit, prandaj kishte për të qenë e udhës që të gjithë këta njerëz të hetohen dhe pasuria e tyre që e kanë në emër të tyre, të dihet prejardhja. Ne të gjithë e dimë se këta njerëz, rroga e tyre është afërsisht 300 euro dhe me 300 euro për dy vjet e gjysmë t'i bëjnë 3 milionë euro pasuri, është diqysh interesant kjo punë. Prandaj, unë, nëse do dikush, unë ua bie edhe fotografitë, ua bie edhe punën që janë duke e bërë, për një seancë tjetër do t'ua bie, nëse dikush tash lajmërohet. Prandaj, kërkoj nga prokurori i EULEX-it që të merret me këtë kategori të njerëzve, sepse paratë e qytetarëve të Kosovës, një pjesë e madhe e tyre janë aty. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ora është 10:30, do të thotë koha është harxhuar. Fjalën e ka kërkuar kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

Deputetët që kanë mbetur, Rita Hajzeraj dhe Salë Shala flasin në seancën e ardhshme.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Realisht, këto ditë për Kosovën ka shënuar një kthesë në kuptimin më pozitiv të mundshëm, e përmendi edhe i nderuari deputeti Hamiti, me prezantimin e realitetit për Kosovën edhe në Këshillin e Sigurimit. Prandaj, ky prezantim i dinjitetshëm shtetëror ishte një sukses i përbashkët i të gjithëve dhe një afirmim për hapat e institucioneve të Republikës së Kosovës, përkatësisht të Qeverisë së Kosovës për vënien e ligjshmërisë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në kuadër të kësaj edhe për hapjen e Zyrës për shërbyes civilë, ku do të punojnë edhe autoritetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. E kam theksuar, ky është vetëm hapi i parë, do të vazhdohet me hapjen e gjykatës, pra funksionalizimin e gjykatave në veri dhe pastaj me ndërtimin e rendit demokratik, organizimin e zgjedhjeve të lira, formimin e komunave të reja dhe investime socio-ekonomike për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve.

U potencua këtu kush sa i ka borxh vendit. Secili nga ne, çdo herë i kemi pasur, i kemi dhe do t'i kemi borxh vendit tonë që të jemi në shërbim të tij. Mendoj se secili nga ne, duke vlerësuar unë personalisht rolin e secilit, kemi qenë në krye të obligimeve brenda mundësive por edhe, mund të them, guximit për të udhëhequr proceset, kështu që borxhin tim në këtë periudhë mendoj se e kam kryer me përgjegjësi të lartë kombëtare dhe politike dhe ndihem tepër mirë që kam qenë në përgjegjësinë që më ka takuar në periudhën e vitit '99 me largimin e ushtrisë, të policisë dhe të administratës së Serbisë nga territori i Republikës së Kosovës.

Dikush këtu e përmendi dhe është me të vërtetë tepër qesharake, janë shumë të ulëta, aspak të qëndrueshme deklaratimet se problemi për Kosovën është Brukseli dhe Uashingtoni. Përsëri e theksoj, nuk dëshiroj as unë, e askush në Kosovë, as ju, zërat e tillë të dëgjohen nga ky podium i shenjtë i Republikës së Kosovës, të shihet si problem Uashingtoni dhe Brukseli. Unë e theksoj se Prishtina, Brukseli dhe Uashingtoni kanë qenë, janë dhe do të mbesin përgjithmonë adresa të zgjidhjes së problemit apo të çështjes së Kosovës, kanë qenë edhe në luftën tonë për çlirim, kanë qenë edhe tranzicionin demokratik, që e kemi kaluar, kanë qenë edhe në procesin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, janë edhe sot në procesin e konsolidimit të shtetit tonë, e do të jenë edhe në procesin e integritetit të Republikës së Kosovës në NATO, në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Po ashtu, ftoj të gjithë që dalin mbi do interesa të ngushta grupore, individuale apo personale, apo partiake. Hapja e zyrës është në shërbim të shtetit të Kosovës dhe mos të ketë deklarime antishtetërore për motive të ulëta partiake, siç ndodhi me shefin e deputetes.

KRYETARI: Faleminderit!

Zëvendëskryeministër, a e do fjalën?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Desha vetëm të jap një përgjigje lidhur me shqetësimin që e ngriti deputeti Petroviq. Qeveria e Kosovës, Kuvendi dhe të gjitha institucionet e kanë dënuar atë akt, jo vetëm si sulm ndaj ndonjë deputeti të Kuvendit të Republikës, por edhe si sulm ndaj politikës integruese të serbëve në institucionet e Republikës së Kosovës. Sa u përket hetimeve, unë ju premtoj në emër të Qeverisë së Kosovës që do të bëjë çdo gjë që është e mundur që hetimet do të përfundojnë pa tjetër dhe në këtë drejtim do të ngrehim çështjen edhe me EULEX-in dhe me mekanizma tjerë ndërkombëtarë. Në Kosovë do të ketë rend dhe ligj, do të ketë drejtësi për çdo qytetarë të Republikës së Kosovës dhe do të ketë përballje me ligjin për gjithë ata të cilët e kanë shkelur apo e shkelin ligjin. Unë edhe nesër ju premtoj në takimin e radhës për sundimin e rendit dhe ligjit, me zotin Kermabo, një ndër pikat e rendit të ditës do ta ngrehim edhe këtë çështje. Unë jam i bindur që hetimet do të tregojnë që ai akt kriminal është kryer nga një kriminel, që në momente të caktuara mund të shohim që ka pasur politikë të dikujt tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kërkesë nga Qeveria nuk ka, kështu që e përfundojmë kohën për deklarime jashtë rendit të ditës. Vazhdojmë me rendin e ditës:

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 25 qershor 2010

Pyes, nëse ka vërejtje dikush në këtë procesverbal? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 25 qershor 2010.

Ju njoftoj se në sallë kemi 85 deputetë dhe njëkohësisht po kërkoj që Komisioni për Buxhet dhe Financa ta vazhdojë punën e vet, ne vazhdojmë me seancën. E kemi kuorumin, Komisioni e ka pasur të përcaktuar agjendën dhe le të punojë sipas agjendës, pasi në seancë mendoj që ka mjaftë deputetë. Kryetari i komisionit, a je dakord? Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Zoti kryetar, faleminderit!

Ju e dini që kemi pasur një agjendë të ngjeshur të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tash në fazën e rishikimit të buxhetit, që përveç rishikimit të buxhetit për vitin 2010, kemi pasur edhe 4 ligje të tjera, që janë pako të këtij rishikimi dhe është kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar që këto bashkërisht të shkojnë. Ne si komision kemi filluar punën me të marrë të atyre projektligjeve ose të ndryshimeve të ligjeve dhe të rishikimit të buxhetit për vitin 2010 dhe ne sot për orën 10:00 kemi pasur një agjendë tonën, sepse me ligjet kemi përfunduar fazën e amendamentimit dhe janë po thuaj se të gatshme që ato të procedohen në Kuvend, por duhet të shkojnë bashkë me rishikimin e buxhetit, prandaj është mirë që agjenda e Komisionit për Buxhet dhe Financa të vazhdojë sipas programit të vet që e ka pasur, andaj edhe unë i kisha lutur anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa që tash të dalim nga seanca dhe të vazhdojmë aty ku kemi mbetur dje. Po ju njoftoj se dje kemi përfunduar rishikimin e buxhetit për Gjykatën Kushtetuese, që është bërë një çështje ndoshta edhe mediale dhe ajo çështje ka përfunduar, vazhdojmë me kërkesat dhe shqyrtimin e kërkesave tjera të agjencioneve tjera. Kaq kisha për të thënë, bile së paku kërkoj që pjesa kryesore e komisionit, pjesa më e madhe e komisionit të jenë, gjithçka është e gatshme të fillojmë punën në sallën që e kemi ne për punë.

KRYETARI: Ne thamë, mund të shkoni dhe vazhdoni punën sipas agjendës! Pika e radhës është:

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta.

Vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministren Edita Tahiri. Ministrja s'është këtu, mund ta bëni pyetjen, deputet.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Kam kënaqësinë që është zotëri kryeministri këtu, që ta dëgjoj bile së paku këtë. Nuk është kjo e rastit që mungon tani ministrja, shpeshherë mungojnë ministrat. Unë e miratoj se në do raste të caktuara kanë edhe arsyeime për mungesë, mirëpo pasi që kjo është frekvente, vlerësoj që është mirë të trajtohet në Qeveri çështja e përgjigjes në pyetjet e deputetëve. Unë e konsideroj këtë si një instrument shumë të dobishëm edhe për informimin, edhe për komunikimin Kuvend – Qeveri dhe opinion, se këto janë çështje aktuale akute, të rëndësishme për trajtim. Prandaj, zoti kryeministër, ju

lutem që ta keni një konsideratë në një takim të Qeverisë që të konstatohet këtë defekt të disa ministrave. Ndoshta edhe qëllimisht u shmangen përgjigjeve, që kjo është çështje që ju do ta kishit konkluduar Faleminderit, shumë! Nuk po e shoh të rrugës tash ta paraqes pyetje, kur nuk është ajo këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Vazhdojmë. Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Deputete, e ke fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është me rëndësi të veçantë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh dhe duke pasur për qëllim rregullimin e ndërtimit në Kosovë, harmonizimin me standardet evropiane të ndërtimit, mbrojtjen e sigurisë dhe të mjedisit, sigurimin e procedurave ligjore për trajtimin e ndërtimeve pa leje, për ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor e bëjë këtë pyetje: Kur do t'i procedohet Kuvendit për miratim ky ligj? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër, të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Nerxhivane Dauti,

Së pari, t'ju falënderoj për pyetjen e juaj dhe desha t'ju njoftoj se Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është i paraparë në Strategjinë legislative të vitit 2010, për datën 31 korrik dhe i njëjti tashmë është proceduar për shqyrtim në Qeverinë e Kosovës, por dëshiroj të cekë se ligji në fjalë është një ligj shumë specifik, për të cilin duhet të debatohet ndoshta edhe me një seriozitet edhe më të madh edhe këtu në Parlament, por gjithashtu edhe me pushtetin lokal dhe me qytetarët. Dëshiroj të ritheksoj gjithashtu se është Ligji i ndërtimit në procedim, por ende nevojitet për Ligjin e ndërtimit të bëhet disa konsultime shtesë. Ne dje e patëm edhe një takim me drejtoreshën e USAID-it, kur duhet ta rishikojmë edhe Ligjin e ndërtimit, kështu që besoj se me harmonizimin e Ligjit të ndërtimit do të procedohet më tutje edhe Ligji i trajtimit të ndërtimeve pa leje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë?

NERXHIVANE DAUTI: Zoti ministër,

Me qenë se ky ligj është shumë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës, unë kërkoj që Ligji për ndërtimin dhe ky ligj, për të cilin e kam parashtruar pyetjen, të procedohen së bashku në Kuvendin e Republikës së Kosovës, prandaj ta keni parasysh këtë fakt. Ju faleminderit!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit!

Unë besoj që pas harmonizimit edhe me faktorin ndërkombëtar, sepse nga aspekti ose nga ana e Ministrisë së Mjedisit janë draftet, janë proceduar më tutje, por nevojiten edhe konsultime shtesë, edhe unë jam i mendimit se Ligji i ndërtimit duhet të shkojë në pako me Ligjin e trajtimit e ndërtimeve pa leje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Deputete, e ke fjalën.

TEUTA HADRI: ... tashmë ka kalua, nuk kisha dashtë ta përsëris, besoj se e ka dëgjua edhe ministri.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputete, ministri s'është këtu, mund ta bëni pyetjen.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryetar,

Unë ftoj kryeministrin të përgjigjet në pyetje me qenë se pyetja ime e drejtuar ministrit Hoxhaj i është referuar premtimit të kryeministrit dhe po e citoj ministrin çka ka thënë. Gjatë çdo takimi që ka pasur kryeministri Thaçi, ka premtuar se “do të ketë rritje të pagave për mësimdhënës, një gjë shumë e sigurt, gjatë këtij mandati qeverisës do të ketë rritje të fuqishme të pagave”.

Zoti kryeministër, kur dhe saktësisht sa do të rritet paga e mësimdhënësve? Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,

Deklarimet e ministrit, jo që janë deklarime, por janë zotime dhe shumë shpejt do të jenë edhe vendime të reja të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ju e dini se gjithë punëtorëve universitarë u është rritur rroga 100%, ndërsa punëtorëve të arsimit të mesëm dhe fillor u është rritur deri në 47% në bazë të gradimit. Ndërsa, është zotim i ri se edhe për punëtorët universitarë do të ketë rritje tjetër të pagave, edhe për punëtorët e shkollave të mesme dhe fillore, siç do të ketë rritje të pagave edhe për dikaster të tjerë, madje edhe për punëtorët e shëndetësisë dhe të dikastereve të tjera.

Gjithashtu, e di që po ngreni shpesh pyetje edhe për universitetet, do të ketë edhe hapje të universiteteve tjera, përpos në Prizren, duke përfshirë edhe Pejën, duke përfshirë edhe Gjakovën, edhe Mitrovicën, edhe Gjilanin. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

Regjia, fjalën deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryeministër,

Ju vazhdimisht keni një problem të përqendroheni dhe të përgjigjeni konkretisht në pyetje. Deklaratën e ka dhënë ministri më 28 qershor, ju folët për të kaluarën. Unë ju pyes prapë, sa do të jetë rritja e pagave dhe kur, apo ky është vetëm një nga premtimet e radhës për t'i joshur mësimdhënës të votojnë për ju dhe për Partinë Demokratike, apo po zhvillonin fushatë elektorale? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E di se shumë gjërat të cilat janë premtuar, keni pretenduar për t'i mohuar, por kanë ndodhur në realitet, kështu ka qenë edhe me autostradën, ju vazhdimisht thoshit se është një premtim, premtim por urdhëroni shkoni dhe vizitoni, punimet kanë filluar me intensitet të jashtëzakonshëm dhe siç ka filluar, do të përmbyllet me kohë.

Gjithashtu, keni theksuar vazhdimisht se është një premtim rritja e pagave për punëtorët universitarë, e potencova – ka ndodhur rritja 100% dhe do të ndodh rritja tjetër meritore për të gjithë punëtorët universitarë. Keni deklaruar vazhdimisht se është një premtim apo vetëm premtim rritja e pagave për

punëtorët e shkollave të mesme dhe fillore. Kjo rritje ka ndodhur deri në 47% në bazë të gradimit, nëse e kupton këtë procedurë, do të vazhdohet me rritje tjetër.

Në të njëjtën kohë, dua të theksoj se rritje tjetër e pagave do të ndodhë në momentin e duhur dhe do të jenë shumë meritore, do të jenë të fuqishme dhe në bazë, natyrisht, të analizave që do t'i bëjë Qeveria e Kosovës. Ato janë deklarime të ministrit të Arsimit, por janë vendime të mia. Faleminderit, shumë! Nëse ke pyetje për universitete, gjithashtu jam në dispozicion.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Deputetet, e ke fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Mjetet e informimit kanë alarmuar opinionin me informatën se nafta që importohet në Kosovë është 5 fish më e dobët, gjegjësisht përmban 5 fish më shumë sulfur diesel se sa nafta që përdoret në vendet e rajonit. Ekspertët shëndetësorë koncentrimin aq të lartë të sulfurit në naftë e konsiderojnë shumë të dëmshëm për shëndetin e njeriut. Zoti Ramadan Buzhala, kryesues i Këshillit për licencimin e naftës, që vepron në kuadër të Ministrisë që ju e drejtoni, më 22 qershor të vitit 2010 ka deklaruar në të përditshmen "Koha Ditore" se është bërë përpjekje të përgatitet një udhëzim administrativ, me të cili do të ndalohet importimi i naftës, e cila përmban më shumë se 10% sulfur, por një gjë e tillë ende nuk është bërë. Aktualisht, në Kosovë importohet naftë me 50 ppm sulfur diesel.

Zoti ministër, pse po zvarritet nxjerrja e Udhëzimit administrativë aq të nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e ambientit Dhe kur do të nxirret ky udhëzim, që po pritet të nxirret sa më parë.

KRYETARI: Zoti ministër, përgjigju!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar, kryetar,

Kryeministër, zëvendëskryeministra, kolegë,

I nderuar deputet, Kurteshi,

Më lejoni së pari t'ju falënderoj sinqerisht për këtë pyetje dhe ta shfrytëzoj këtë rast t'ju siguroj ju dhe opinion e gjerë se artikulli i shkruar, të cilit i referoheni, është i pavërtetë dhe tendencioz, pa paragjykuar qëllimet e artikullshkruesit se a kanë qenë të drejtuara për denigrim të punës së MTI-së, apo me qëllim që t'i krijohet favor ndonjë prodhuesi në regjion apo ndonjë tregtari në Kosovë. Ndaj këtij artikulli është bërë edhe reagim zyrtar për dezinformim nga ana e Zyrës për mbikëqyrje të sektorit të naftës, e cila vepron në kuadër të MTI-së. Sa i përket kualitetit të naftës, përpos me sasinë e sulfurit, ai përcaktohet edhe me më shumë tregues të tjerë, siç janë numri tetanik, densiteti, distilimi, sasia e ujit, filtrabiliteti, lubrifikshmëria e tjera, vlerat kufizuese të të cilëve janë përcaktuar me Udhëzimin administrativ 2008/21. Sa i përket sasisë së sulfurit, ai është i përcaktuar në vlerë prej 50 ppm apo 0,005% dhe është ndër më të ulëtat në rajon, apo të thënë ndryshe, sa i përket sasisë së sulfurit, vendi ynë është ndër më të avancuarit në rajon.

Në mbështetje të kësaj, do të citoj vlerat e këtij treguesi për vendet e rajonit nga publikimi i programit të Kombeve të Bashkuara për ambient, i njohur si UNEP, një kopje të raportit e kam sjellë për ju, i cili është botuar në prill të këtij viti. Maqedonia është me 10 ppm, Kosova 50 ppm, Bosnja e Hercegovina 350 ppm, Shqipëria 2000 ppm, Mali i Zi 2000 ppm, dhe Serbia e fundit me 10.000

ppm, si vlera kufizuese më të larta të aplikuara në këto vende. Në shtetet e BE-së kjo vlerë është 10 ppm, kurse vendet e rajonit parashihet të aplikojnë këtë kufizim ligjor tek në janarin e vitit 2012.

Në fund, më lejoni të theksoj se neni 9 i Ligjit për ndryshimin e Ligjit për tregti me naftë dhe derivate të naftës, i miratuar më 25 qershor 2009, përcakton qartë se Ministria gjatë shqyrtimit të standardeve për cilësi të naftës duhet të ketë çdo herë parasysh që aplikimi i tyre të mos shkaktojë çrregullime në furnizimin e tregut me naftë dhe derivate të saj apo favorizim të një prodhuesi apo vendi, si dhe ato të jenë në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Pikërisht kjo është dispozita e cila na obligon që të jemi shumë të kujdesshëm në miratimin e standardeve më të larta në këtë fushë, si dhe fakti se standardet tona po thuaj se përputhen me ato të Bashkimit Evropian, që shpie në përfundim se ne nuk po zvarrisim kurrfarë nxjerrje të ndonjë udhëzimi administrativ. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Deputet, ke pyetje shtesë? E ke fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Ministër, ju lutem, na thoni se a është e vërtetë deklarata e zoti Buzhala, e cila është dhënë në atë gazetë dhe punon në ministrinë tuaj dhe, nëse po, pse po zvarritet nxjerrja e udhëzimit administrativ në fjalë.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti deputet, unë e ceka që deklarata nuk është e saktë dhe ajo është dezinformatë, ne kemi bërë reagim zyrtar, fatkeqësisht nuk është botuar, përndryshe është bërë reagim zyrtar. Ne jemi në shqyrtim të standardeve po, siç e ceka, ne do të fillojmë të kalojmë në këto standarde që nga janari i vitit 2012. Ne aktualisht jemi të dytët në rajon, nuk dua të paragjykoj pse Maqedonia e ka 10 ppm, me Unionin evropian, por ne jemi ndër më të mirët në rajon.

KRYETARI: Faleminderit!

Ministrat mos të ngutem ta marrin fjalën, se fjalën e jep kryetari ose kryesuesi.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër, ndotja e ambientit aktualisht po e dëmton seriozisht shëndetin e qytetarëve të vendit tonë, kurse në të ardhmen do të jetë pengesë për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Kompanitë si Ferronikeli, KEK-u e tjera nuk kanë vendosur filtrat, edhe pse janë të obliguar. Në Kosovë importohet naftë me përqindje shumë më të lartë të sulfurit sesa është e lejuar. Në Kosovë, në mungesë të impianteve, ujërat e zeza derdhen në lumenj, kurse gurthyesit punojnë pa filtër.

Zoti ministër, cilët janë hapat konkret të ministrisë suaj në zbutjen të këtyre problemeve. Cilët janë 5 ndotësit më të mëdhenj të ambientit në Kosovë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Ismajl Kurteshi,

Lidhur me pyetjen tuaj që ka të bëjë me çështjen sa është angazhuar Ministria e Mjedisit në eliminimin apo zvogëlimin e nivelit të ndotjes CO₂, SO₂ e të tjerë nga operatorët e mëdhenj në Kosovë, ku në këtë rast është fjala sigurisht për KEK-un, Ferronikelin, Sharrcemin e të tjera, desha t'ju përgjigjem se problemi ndoshta më i madh është me KEK-un edhe me Termoelektranën, e cila as afërsisht nuk i plotëson standardet, kjo dihet, për shkak të teknologjisë të stërvjetruar. Por, ekziston projekti përmes Komisionit Evropian për dekomisionimin e Termocentralit A dhe besojmë që së shpejti do të kalojmë edhe në fazën e krijimeve të komisioneve edhe do të vazhdojmë me punën. Ndërsa, ndërkohë sigurisht do të bëjmë ato hapat që janë të mundshëm për ta zvogëluar ndotjen.

Lidhur me Ferronikelin, Ministria e Mjedisit ka bërë përcjellje permanente të ndikimit në mjedis me ç'rast e ka detyruar operatorin që të instalojë sistemin për pastrimin e gazrave në të dy furrat elektrike, që tani veprojnë dhe janë në fazën testuese tremujore, pas të cilës fazë presim që të kemi eliminimin ose zvogëlimin e ndotjes në kufij të vlerave maksimale të lejuara sipas ligjeve në fuqi.

E njëjta gjë vlen edhe për Sharrcemin, me ç'rast pas intervenimit të Inspektoratit të Ministrisë, kemi një situatë shumë të pozitive mjedisore, gjë që shihet edhe në terren. Vlen të theksohet se Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit vazhdimisht ka bërë presione në të gjithë operatorët në fjalë, ku ka bërë edhe denoncime gjyqësore. Ferronikeli është dënuar, kurse për operatorë të tjerë lëndët janë në procedurë. Ministria është duke realizuar projektin për rrjetin e stacioneve matëse për monitorimin e ndotjes së ajrit në nivelin e vendit. Sa i përket naftë, zoti ministër Zharku veç e ka dhënë përgjigjen, por unë dëshiroj të cekë, sepse ekzistojnë edhe kontrollime në doganat për cilësinë e naftës. Edhe me operatorë të tjerë, të cilët me veprimtarinë e vet kanë ndikim në ndotjen e ajrit, që ne e kemi në Data bazën tonë, qasja ndaj tyre është konform ligjit, duke i pajisur me pëlqimin...

KRYETARI: Faleminderit: Deputet, ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin apo zëvendëskryeministrin Kuçi. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit!

Me dëshirë do t'ia bëja kryeministrit këtë pyetje, me kusht që ai të më përgjigjet në pyetje, jo për Televizionin shtetëror - RTK-në, sepse redaktorët e RTK-së edhe ashtu do t'i nxjerrin sekuencat më të mira të sodit, zoti kryeministër, sepse për atë janë punësuar aty, për atë paguhen ata, të të qesin ty sa më mirë në televizor, ai është obligimi i tyre.

Çështja është kjo: Para 4 muajve Qeveria pati vendosur që zbatimin e strategjisë për veriun ta ndihmojë me themelimin e 6 grupeve punuese. Këto grupe do të përbëhen, ashtu siç patët thënë, nga ekspertë të profileve të ndryshme, të cilët do të merren me aspekte të caktuara të zbatimit të strategjisë. Pyetja është kjo, zoti kryeministër: A janë krijuar këto 6 grupe, nëse jo – pse jo dhe kur do të fillojnë punën 6 grupet punuese për zbatimin e strategjisë për veriun. Për t'ua rikujtuar, edhe strategjia keni pas premtuar se do të fillojë nga marsi për t'u zbatuar. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë do të dëshiroja fillimisht, zoti deputet Tali, ta sqaroni pyetjen, se ata 4 muajt s'i kuptova cilët ishin?

KRYETARI: Ke pyetje shtesë, deputet? Mirë, regjia fjalën deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Paska harruar zoti kryeministër, ashtu siç po i harron të gjitha premtimet në radhë. Më 8 mars, zoti kryeministër, patët premtuar për krijimin e 6 grupeve punuese, po matematikisht i bien para 4 muajve ajo. Po. Edhe para nja 6 apo 7 muajve patët premtuar ta filloni strategjinë në mars, kur erdhi marsi na premtuat për 6 grupet, a do të vazhdoni me premtimet, apo do të filloni më në fund të punoni diçka, kjo është pyetja ime. Përsëri më përgjigjeni në pyetje, ju lutem, jo për televizionin shtetëror. Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Tash e kuptova se ke folur për “muaj” e jo për “muajt” dhe nuk e dija se nga janë ata persona, ndërsa nuk e dija se po flet për muaj kalendarik. Faleminderit shumë për sqarime!

Ju e dini të gjithë, siç e dinë gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të gjithë partnerët ndërkombëtarë se veprimet dhe vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë qenë plotësisht në përputhshmëri me agjendën të cilën e kemi bërë bashkërisht, do të thotë, hapja e Zyrës, që foli edhe më herët, një vendim ky i munguar në 11 vitet e fundit për Kosovën apo nga institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare. Kjo zyrë tanimë është funksionale dhe është zyrë e Republikës së Kosovës, e shtetit të Kosovës që është në shërbim të të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie. Duhet secili ta kuptoj se pa ligjshmëri nuk ka demokraci në asnjë vend, e as në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Ligjshmëria nënkupton edhe fillimin e betejës së pandërprerë konkrete kundër veprimeve negative në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, edhe kundër njerëzve që janë të involvuar në kontrabandë, në krim të organizuar, në korrupsion e besa edhe të kriminelëve të luftës, që janë të strehuar aty. Në anën tjetër, në kuadër të reformave të cilat jemi duke i bërë, do të vazhdojmë me angazhime që i kemi edhe me zbatimin e plotë të dokumentit të presidentit Ahtisari, për hapjen edhe të zyrave të tjera, në të njëjtën kohë për formimin e komunës së re, organizimin e zgjedhjeve të lira në tri komuna të tjera dhe investimet e fuqishme të cilat do të vazhdojnë.

Dua të theksoj i nderuari deputet, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, të nderuar deputetë, se Qeveria që udhëheq unë, deri më tani ka investuar mbi 12 milionë euro në veri të Mitrovicës, ndërsa gjitha investimet deri në vitin 2008 kanë qenë, mund të them, as 100.000 euro nuk kanë qenë të investuara në veri të Mitrovicës, ndërsa tash i kemi mbi 12 milionë euro. Nëse të duhen shifra dhe fakte dhe realitete, të gjitha t’i prezantojmë, qoftë në infrastrukturën rrugore, në ndërtimin e shkollave, të ambulancave, apo edhe projekte tjera në ndërtimin e shtëpive, rrenvomin e tyre. Ndërsa, sa i përket vetë realitetit, ftoj që me një grup deputetësh mund të shkojmë ta vizitojmë dhe do të bindesh me realitetin.

Gjithashtu, këtu përmendën edhe gjërat, të cilat mendoj se çdo qytetarë tanimë i di dhe të gjithë njerëzit e politikës i dinë këto angazhime, nuk do të ndalen, përkundrazi vetëm sa do të rriten. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula.

(Reagime nga salla)

Nëse do ta marrësh fjalën, merre ose dilni jashtë!

NAIM RRUSTEMI: ...nuk mund të rristruket në pleqëri.

DRITON TALI: Zoti Jakup Krasniqi nuk është duke i respektuar rregullat e Parlamentit. Kjo kështu s’bën.

NAIM RRUSTEMI: Më fal!

KRYETARI: Regjia, ua mbyll mikrofonin të dyve! Vazhdojmë me rendin e ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjqësor të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Haki Demolli, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Me respekt të posaçëm, në emër të Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendit të Republikës së Kosovës po i paraqes për miratim Projektligjin për Këshillin Gjqësor të Republikës së Kosovës. Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e sistemit gjyqësor. Projektligji për Këshillin Gjqësor të Republikës së Kosovës siguron pavarësinë e gjyqësorit në kryerjen e funksioneve të tij, pastaj synon ndërtimin e një sistemi gjyqësor të integruar, të pavarur, profesional dhe të paanshëm për administrim në gjykata. Njëherësh, ky projektligj paraqet bazën juridike për qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët në Kosovë, si dhe garancinë që sistemi gjyqësor i Kosovës të jetë gjithëpërfshirës dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ligji i propozuar, ndër të tjera i shtjellon edhe këto çështje: kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Gjqësor, rekrutimin, nominimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve porotë, vlerësimin dhe transferimin e gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve porotë, administrimin e gjykatave, procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë, zyrën e komisionit disiplinor, trajnimin gjyqësor të gjyqtarëve dhe çështje të tjera. Vlen të theksohet se ky ligj i njeh të drejtën Këshillit Gjqësor që të miratojë rregulla dhe procedura për të realizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e tij. Ky projektligj paraqet një hallkë tejet të rëndësishme në procesin e reformimit të sistemit gjyqësor, në përgjithësi, dhe të gjykatave, në veçanti. Ndërsa, vetë reformimi i sistemit gjyqësor të Kosovës është një imperativ i kohës, i cili, ndër të tjera është potencuar si sfidë edhe në Raportin e progresit të Komisionit Evropian. Andaj, thellësisht jam i bindur se aprovimi i këtij projektligji nga Kuvendi i Kosovës do të kontribuojë me të madhe në tejkalimin e kësaj sfide.

Shikuar nga aspekti praktik, konsideroj se aprovimi, respektivisht zbatimi i këtij ligji është i një rëndësie të veçantë, sepse do të shtojë efikasitetin në punën e gjyqësorit, gjë e cila do të ndikonte në përforcimin e besimit tek qytetarët për punën e gjykatave në përgjithësi.

Për më tepër, ky projektligj do të zëvendësojë dhe shfuqizojë legjislacionin e UNMIK-ut, me të cilin është mbuluar kjo fushë deri më tani, i cili tanimë nuk është kompatibil me kushtet dhe rrethanat e reja të krijuara në Republikën e Kosovës.

Andaj, i nderuari zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Propozoj që ky projektligj të miratohet në parim në Kuvend dhe kështu të mundësohet procedimi i tij për aprovim në procedurë të mëtejme. Ju faleminderit për vëmendje!

Drejtimitin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim, në parim. Ftoj kryetarin ose raportuesin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, kryetar i komisionit.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht që unë nuk do të flas për rëndësinë, sepse ministri e theksoi mundësinë e Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka një rëndësi të veçantë sepse ne po dëshirojmë që gjatë këtij viti kalendarik së paku të përmbyllim të gjitha në paketë, legjislacionin që e rregullon organizimin e sistemit të drejtësisë.

Ne si komision e kemi shqyrtuar shumë me vëmendje projektligjin dhe, natyrisht, do të kishim pasur dëshirë që edhe ky projektligj të jetë i shkruar, së paku qysh e ka bërë zakon Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria e Kosovës, pak më mirë si është shkruar. Kemi pasur vërejtje dhe natyrisht që është njëri nga projektligjet që na ka ardhur jo i shkruar mirë. Mirëpo, megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë që e ka, duke pasur parasysh që kërkon edhe Komisioni Evropian që së shpejti ta kalojmë këtë projektligj dhe duke pasur parasysh që kemi në paketë edhe Projektligjin tjetër për Këshillin Prokurorial dhe Prokurinë e Shtetit, ne si komision kemi vendosur që të propozojmë të aprovohet, në parim. Mirëpo, megjithatë, konsideroj se duhet t'i kemi parasysh disa nga çështjet që do të ishte mirë që edhe nga deputetët, por edhe nga grupet parlamentare të marrin disa rekomandime të qarta që do ta ndihmojë, sepse do të kemi punë si komision në këtë projektligj.

Së pari, ju e dini që për shkak të asaj që nuk e kemi saktësuar mirë në ligjin aktual që e kemi për përbërjen e përkohshme, që nuk e kemi përcaktuar procedurën se kush t'i emërojnë apo kush t'i propozojë anëtarët tjerë që nuk janë gjyqtarë, ju e dini që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka vepruar mbi 7 muaj dhe kjo ka qenë pengesë serioze. Është interesant që edhe në projektligjin që e kemi para vetes, prapë nuk përcaktohet saktë kush duhet t'i propozojë anëtarët në përbërje të këshillit, cili institucion, edhe pse kjo është e përcaktuar në Kushtetutë për institucionet, për procedurën kush do t'i propozojë, se natyrisht që Kuvendi duhet t'i emërojnë këta që vinë nga pjesa civile, ekspertë të ndryshëm, profesorë të nderuar e kështu me radhë.

Është edhe një çështje tjetër, është çështja të mos përshtatshmëria e kandidatëve që do të jenë anëtarë të këshillit. Nëse e merrni dhe e lexoni me vëmendje nenin 11, keni përcaktuar në nenin 11, paragrafi 1, pika 5 se nuk mund të jenë edhe ata të cilët punojnë për Qeverinë, është krejt në rregull, për shoqatat është krejt në rregull, por keni deklaruar më vonë se nuk mund të punojë askush i cili është krijuar në bazë të legjislacionit dhe të Kushtetutës. Në bazë të kësaj del që kërkush s'mundet të themelohet, sepse edhe avokatët janë krijuar me ligjin bazik, për Ligjin për avokat, edhe institucionet tjera, prandaj kjo çështje duhet gjithsesi të ndryshohet.

Është edhe një çështje tjetër. Përveç gabimeve teknike, nuk do t'i flas, sepse ju e shihni që në projektligj janë shumë, shumë gabime, "ia transmeton buxhetin Ministrisë për Ekonomi dhe Financa", "ia flet anëtarët e këshillit duhet të jenë imunë", është fjala për imunitetin, thotë imun.

Gabimet teknike nuk do t'i përsëris. Mirëpo, çështja është paraparë në këtë projektligj edhe çështja e trajnimeve. Këshilli konsideroj që nuk e ka këtë të drejtë dhe nuk mund t'ia delegojë Institutit Gjyqësor të Kosovës, sepse Kuvendi i Kosovës me ligj e ka krijuar Institutin Gjyqësor të Kosovës pikërisht për t'i trajnuar gjyqtarët dhe prokurorët.

Është edhe një çështje. Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës preken shumë raste edhe nuk duhet të jetë prokurorë, s'ka më të bëjë Këshilli Gjyqësor me prokurorë. Ne do ta kemi sot pikërisht Projektligjin për Këshillin Prokurorial, janë ndarë çështjet, prandaj këto duhet të gjitha të eliminohen.

Çështjet tjetër. Është prekur situata që duhet këshilli t'i emërojë administratorët. Kjo bie ndesh me Ligjin e shërbimit civil. Administratorët i kemi lënë si shërbyes civilë dhe natyrisht që administratorët do të zgjidhen në bazë të shpalljes publike, ashtu siç është paraparë në këtë projektligj dhe nëse japim mundësinë që këshilli dhe kryetari i gjykatës të kenë atë fuqinë mbi zgjedhjen apo përzgjedhjen e administratorëve, atëherë faktikisht e humbim atë karakterin që ua kemi dhënë apo statusin që ua kemi dhënë me ligj, sepse drejtori i sekretariatit do të jetë ai niveli më i lartë që do të merret me çështjen e përzgjedhjes së administratorëve. Domethënë, po i shndërrojmë pa dashje të kenë njëfarë ndikimi në bazë të përgjegjësi që i kanë.

Çështje tjetër që do të përmend dhe krejt në fund, është paraparë edhe çështja e shfuqizimit të akteve dhe, për çudi, nuk është paraparë shfuqizimi pikërisht i Ligjit për përbërjen e përkohshme, por është paraparë shfuqizimi i Rregullores 2005/52, por gjithsesi do të duhej të parashihej Ligji për përbërjen e përkohshme, sepse aktualisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës vepron duke u bazuar në përbërjen apo në Ligjin aktual, që është për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Unë do të ftoj edhe ministrin e Drejtësisë, edhe të gjithë ata të interesuar që bashkërisht edhe një herë ta punojmë projektligjin, sepse së paku në çdo nen duhet të veprohet, jo ndoshta për çështje shumë përmbajtësore, por janë çështje teknike për të cilat duhet gjithsesi të bëjmë amendamente, pa i lënë anash edhe këto çështje përmbajtësore, përbërjen, mospërputhshmërinë, zgjedhjen e administratorëve, trajnimet që ju kanë lënë dhe duke i lënë anash edhe prokurorët e Kosovës.

Edhe një herë, Komisioni për Legjislacion ka kërkuar dhe kërkon nga deputetët që ta aprovonë, në parim, sepse bashkërisht do t'ia arrijmë që në kohën e caktuar t'i bëjmë amendamentet dhe ta sjellim për leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Vazhdojmë me diskutimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe duke pasur parasysh se Kosova tanimë ka filluar procesin e riorganizimit të sistemit gjyqësor dhe të sistemit të drejtësisë në tërësi, miratimi i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor është domosdoshmëri, pasi që legjislacioni i cili e ka rregulluar këtë fushë nuk është i përshtatshëm për nevojat dhe rrethanat e Kosovës dhe nuk është i standardizuar.

Ky projektligj e ka një sistematizim të ri edhe krijon një infrastrukturë ligjore më të avancuar. Nga fushëveprimi i projektligjit shihet se me këtë projektligj cenohet një kornizë ligjore adekuate që ka të

bëjë me Këshillin Gjyqësor si institucion i pavarur dhe përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizimit të gjyqësisë, i cili organ bën administrimin e gjykatave, përcaktimin e politikave dhe procedurat e gjykatave, si dhe vlerësimin dhe avancimin në detyrë të gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve porotë, gjë që është edhe risi në sistemin gjyqësor.

Por, nëse analizojmë strukturën hartuese të projektligjit, gjejmë se është i hartuar dobët me plotë gabime dhe lëshime gjuhësore dhe teknike, e shpesh edhe me formulime joprofesionale dhe këtë po thuaj se e gjejmë në çdo nen dhe në çdo paragraf të projektligjit. Të gjitha këto mund të jenë ndoshta edhe si pasojë e përkthimit joprofessional dhe joadekuat.

Këtë mund ta ilustrojmë me disa shembuj. Për shembull, neni 6, paragrafi 7, thuhet: “Gjatë shërbimit të tyre në zyrë, kryesuesi dhe nënkryesuesi...” dhe vazhdohet, mendoj se nuk është një formulim profesional dhe do të duhej të jetë: “Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, kryesuesi dhe nënkryesuesi...” dhe të vazhdohet. Ose neni 9, titulli i nenit është gabim dhe aty flitet për komisione që i formon këshilli, sepse parashihet që këshilli të punojë me disa komisione, kurse në titull thuhet “Komisionet dhe këshilli”. Neni 11 është i formuluar në mënyrë shumë konfuze dhe të paqartë, ta zëmë, neni 12, paragrafi 2, ku thuhet: “Anëtarët e këshillit mund të shkarkohen nga zyra, nëse kanë kryer shkelje të vullnetshme të ligjit” e tjera, mendoj se është jo në rregull, sepse nëse kanë kryer shkelje të ligjit në mënyrë të vullnetshme, ata jo që mund të shkarkohen, po do të duhet të shkarkohen dhe jo nga zyra, por nga funksioni të cilin e kanë, sepse janë anëtarë të këshillit.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah votimin në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional gjatë procedimit të mëtutjeshëm. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Është për t'u vlerësuar përkushtimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Qeverisë për fuqizimin e shtetbërjes, konkretisht formimi Gjyqësorit sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se me këtë projektligj do të vendoset një kornizë adekuate ligjore që ka të bëjë me reformën e Gjyqësorit, konkretisht krijimi i Këshillit Gjyqësor, si organ i pavarur dhe përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizimit të gjyqësisë.

Deri më tani kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregulloren të UNMIK-ut dhe tani e tutje me këtë projektligj do të rregullohen funksionet e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, duke përfshirë që nga procedura e emërimit, riemërimit, transferimit, disiplinimit dhe shkarkimeve të gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve porotë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së, duke e shqyrtuar përmbajtjen, i jep përkrahje në parim, ndërsa çështjet teknike do të rregullohen në komisionin funksional, sigurisht në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe ekspertët e kësaj lëmie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi ynë e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Gjyqësor dhe ndajmë po ashtu edhe ne pak a shumë të njëjtat opinione që u dëgjuan këtu prej parafolësve. Projektligji nuk është i shkruar më së mirë, nuk e mbërrin madje as standardin e projektligjeve të proceduara deri tash, madje as të disa projektligjeve që janë pjesë e kësaj pakos të projektligjeve të Gjyqësorit dhe të Prokurorisë. Por, duke pasur parasysh dy fakte se projektligji është pjesë e pakos së Projektligjit edhe për Prokurorinë e shtetit, edhe për Këshillin Prokurorial, ky është një fakt dhe fakti i dytë, duke pasur parasysh se problemet e shkrimit janë më tepër jo të natyrës përmbajtjesore, po të natyrave tjera sintaksore, të përkthimit, ligjërimore e tjera, e tjera. Ne mendojmë që ta votojmë, në parim, këtë projektligj edhe pastaj komisionit i del punë shumë e madhe. Mund të ketë shumë amendamente pastaj në leximin e dytë, por ta kalojmë që mos e stopojmë, se po e stopuam këtë projektligj, duhet t'i stopojmë edhe dy të tjerët. Prandaj, të ecim përpara që ta përpunojmë në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka shefi i grupit, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Parafolësit paraqitën një mori vërejtjesh të cilat i ka ky projektligj, të cilat pretendohet se mund të përmirësohen në leximet e mëtutjeshme, në punën e mëtutjeshme të komisioneve. Unë do të shfrytëzoj rastin që të kërkoj prej ministrit të Drejtësisë që draftligjet të cilat po i sponzorizon kjo ministri, të jenë në përputhje me standardet edhe me nevojat e vendit.

Gjyqësia në Kosovë vazhdon të mbetet një prej pikave më të dobëta, prandaj shtrohet domosdoshmëria e ndërmarrjes së veprimeve me të cilat do të kemi shtim të efikasitetit të drejtësisë dhe kthimin e besueshmërisë së qytetarëve në drejtësi në vend.

Sa i përket projektligjit, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet, në parim, këtë projektligj, me pretendimet se mund të ketë përmirësime të mëtutjeshme. Unë po jap vetëm një vërejtje këtu, sepse ky projektligj është i ndërlidhur edhe me disa ligje të tjera që i takojnë kësaj fushe, në veçanti edhe me Ligjin për gjykatat në vend. Po përmend vetëm edhe te çështja e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, ku thuhet, ta zëmë, në nenin 5 pika 2.2, “një gjyqtar i Gjykatës së Apelit i zgjedhur nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit...”. Ne të gjithë e dimë që Ligji për gjykatat hyn në zbatim disa vjet pas, diku më 2013, nëse nuk gaboj, ndërkaq deri atëherë shtrohet çështja se cila prej gjykatave, sepse kemi tash disa gjykata të qarkut, e zëvendëson këtë çështje.

Besoj që ky ligj mund të përmirësohet në punën e mëtutjeshme të komisionit dhe, natyrisht, ne do të japim mbështetje për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe duke pasur parasysh që Kosova është në fazën fillestare të reformave në gjyqësi, këto reforma i duhen më së tepërmi Kosovës. Ne do ta mbështesim në parim këtë projektligj, edhe pse ky ligj nuk i plotëson as kushtet minimale për të ardhur në Kuvend.

Ky ligj shihet qartë se është përkthyer, është përkthyer keq dhe si duket përkthyesit nuk kanë mundur t'i gjejnë fjalët adekuate që në gjuhën shqipe do t'i shkonin për shtati këtij ligji.

Unë kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si sponzorues i ligjeve, t'i gjej disa përkthyes që e njohin terminologjinë juridike të gjuhës shqipe dhe kur t'i përkthejnë ligjet nga ndonjë gjuhë e huaj, të paktën t'i përkthejnë mirë. Duke pasur parasysh se Kosova nuk mund të inkuadrohet në integrimet evropiane pa këto ligje, ne në komision kemi marrë edhe një vendim që të formojmë një komision, një grup punues për të punuar nga fillimi këtij ligj, nen për nen, sepse ky ligj, edhe parafolësit e thanë, është i punuar keq.

Vërejtjet tona ne do t'i japim me kohë gjatë amendamentimit të këtij ligji dhe ne e përkrahim në parim këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", fjalën e ka deputetja Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim,

Kosova Cumhuriyeti Yargı Konseyi Yasa Tasarısı, açıklama memorandumu ve tasarının içeriği itibarıyla Kosova Meclisi başta olmak üzere kurumlarımızın adalet sorununun net bir şekilde düzenlenmesi, önceki kurallarla düzen içine alınmayan bazı konuların kapsanması, gerçek ile uyumlaştırılması ve bu malzemede mevzuatın, Avrupa mevzuat standartlarıyla yakınlaşması ya da uyumlaştırılması için sürekli çabada bulunduğunu göstermektedir. 3. maddede değişik esaslara göre ayrımcılığa karşı garanti verilmektedir. Dolayısıyla Anayasa ve insan haklarıyla ile cinsiyet eşitliğine ait uluslararası açıdan tanınan prensiplerle uyumlu olarak, Kosova Cumhuriyetinin multi-etnik özelliği korunduğundan söz edilmektedir. Bu sırada "insan hakları" kelimesinden sonra "topluluk hakları" kelimeleri de ilave edilmesi gerektiğine inanmaktayız. 4. maddenin 1. fıkrasının 2. noktasında aynı zamanda çoğunlukta olmayan topluluklardan yargıç için aday ayrımcılığına garanti verilmektedir. Bunun yanı sıra 1. maddenin 3. noktasında etnik oluşum, Kosova Cumhuriyeti Anayasasının 104. maddesine ve Kosova Statüsünün Çözümüne ait Geniş Kapsamlı Önerinin 4. İlavesinin 2.2 fıkrasına bağlıdır. Demek oluyor ki çoğunlukta olmayan topluluklara garanti verilmiştir. Ayrımcılığa karşı yasa, aynı zamanda bu maddenin kurallarının uygulanması için doğrudan garanti mekanizması olarak da geçebilir.

Bu Yasa Tasarısının genelde kabul edilir olduğunu görüşüyoruz, fakat 17. maddenin 3. paragrafındaki ayrımcılığın, potansiyel kaynaklarından kaçınılmalıdır, yani yasal açıdan da bu düzeltelerin yapılması gerekmektedir. Aynı zamanda dil hatalarından kaynaklanan anlamsızlıklar da düzeltilmelidir. Onun dışında 7+ Parlamento Grubu olarak, bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul ediyoruz, ikinci okunuşuna kadar, fonksiyonel komisyonlarda katkımızı sunacağız. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk kemi të paraqitur. Më falni, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, ndërkohë është paraqitur deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna Grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i smatra da je prihvatljiv i mi ćemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Naravno, svoj doprinos ćemo dati u radu u komisijama. Naravno,

postoje tu neke nejasnoće, opet prigovaram ono što se tiče teksta, odnosno samog načina pisanja, ali u svakom slučaju mi ćemo to pokušati da ispravimo u radu parlamentarne komisije. Još jednom, hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Povodom ovog Nacrta zakona o sudskom savetu Kosova, mi kao grupa pažljivo smo razmatrali ovaj nacrt zakona i analizirali smo pojedine članove, kao što hoću da kažem da mi je milo da je prethodna Grupa „7+“ jako dobro obradila i obratila pažnju ovde svima nama na član 3. i član 4. što neću da ponavljam kada je u pitanju multietnički karakter ovog saveta.

Ali to što hoću ka kažem, kao grupa znamo da je Nacrt zakona jako važan zato što je deo paketa zakona o regulisanju reforme sudstva radi poboljšanja tužilačke funkcije i radi pospešivanja sfere pravde na Kosovu, zajedno sa Nacrtom zakon o sudovima, koji je osnovni zakon ovog paketa.

To što hoću kao grupa da ukažem, jeste član 5, kada je u pitanju sastav i izbor članova saveta. Znamo da se na osnovu člana 108. Ustava dva člana, ovaj savet ima znači 13. članova, da se dva člana biraju u sudskom savetu u skladu sa članom 108 Ustava i to po sledećem, kaže: Dva člana iz reda sudija Vrhovnog suda, što u potpunosti podržavamo od strane sudija Vrhovnog suda, gde je centralni karakter sudstva u pitanju, zatim jedan sudija iz Apelacionog suda, što opet po nekoj hijerarhijskoj liniji sasvim ima logiku i zakon. I čitam član 2,3. dva člana iz reda sudija Osnovnog suda, znači dolazi do lokalnog karaktera, da se opet biraju dva člana iz lokalne olatforme. Međutim, kada su u pitanju ostali članovi, što znači 5, plus 8, trinaest člana. Ovde nije dobro definisano u tački 3. kaže da članovi saveta koji nisu sudije ili tužioci, moraju biti izvanredni penzionisani pravnici, univerzitetski profesori i dobro poštovani profesionalisti, sa najmanje 10. godina relevantnog iskustva.

Mi imamo konkretnu primedbu na ovo 10. godina, gde bi trebalo da postoji 20. godina, jer znamo da su sudije mlade, da imaju posleratno iskustvo od 10. godina, koje praktično nije veliko iskustvo, po tražimo da to bude najmanje 20. godina da dođemo do pravih sudija, do pravih poznavalaca u ovoj sferi, jer znamo koje su sve oblasti i koja su kršenja kada je u pitanju sudstvo i pravo građana koji na jako, jako težak način ostvaruju svoja prava pred sudovima, uz veliko čekanje i, normalno, uz malu angažovanost sudstva.

Smatramo da će sudski savet da poboljša kada je u pitanju zakonska nadležna i izvršna funkcija u sferi sudstva i mislimo da je preko potreban ovaj savet jer ima koordinacionu funkciju u sudstvu, nadgleda, pravi program imenovanja, biranja, razrešenja sudija, zatim pravi normalno ekonomsku platformu budžeta, odgovoran je Skupštini i ministarstvima, Ministarstvu pravde i Ministarstvu finansija, gde pravi budžetsku godinu za svoje troškove i mislimo da je jedan ovakav organ preko potreban na Kosovu radi regulisanja, rekla sam, svega toga što je na terenu kada je u pitanju sudstvo. Jako bitno je da će ovaj sud, ovaj savet konačno napraviti raspored, raspored predmeta koji će pripasti sudijama za rešenje i verujemo da će sa ovim biti pospešena platforma kada je u pitanju slika pravosuđa na Kosovu.

To što hoću da se vratim ponovo članu 5. sastavu izbora članova saveta, jeste opet član 3. gde moraju ovih 8 članova da imaju pored profesionalnih karakteristika, moraju i ovo, kako da kažem, profesionalne karakteristike i iskustva, moraju da imaju i nacionalni sastav radi ispoštovanja ili ne

kršenja člana 108. Ustava, gde mora da bude i karakter, sastav kada je u pitanju etnički sastav ovih članova, kako bi bile zastupljene i ostale zajednice, ne da to bude mrtvo slovo na papiru, nego da se pređe sa reči na dela i da poštujemo Ustav Kosova, koji smo ovde usvojili. Hvala, toliko od naše grupe, mi ćemo ostale primedbe da damo pismeno funkcionalnoj komisiji i naročito funkcionalna komisija zamolila bi da malo analizira sve zakone u regiji i da ima u vidu kada su u pitanju osnovni sudovi ili opštinski sudovi, sastav sudija i ostalo kada je u pitanju sudski savet. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Vazhdojmë me radhën e deputetëve të paraqitur për diskutim. Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet deputeti Naim Rustemi.

TEUTA HADRI: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

I nderuar ministër dhe të nderuar deputetë,

Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës është një projektligj që bazohet në nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e që miratimi i tij mundëson shfuqizimin e rregullativës të UNMIK-ut 205/52, e cila si rregullore ka qenë shumë e mangët dhe nuk e ka plotësuar në tërësi këtë fushëveprimi. Sot kjo rregullore nuk iu përshtatet nevojave të kohës sipas standardeve ndërkombëtare dhe për këtë është paraqitur nevoja të zëvendësohet me një ligj të ri më gjithëpërfshirës, ku si qëllim kryesor është të krijojë pavarësi të plotë për një sistem të integruar, të pavarur, sistem të profesionalizuar, me qasje të drejtë në sistemin e drejtësisë.

Të nderuar deputetë,

Gjatë leximit të ligjit kam hasur në shumë gabime teknike të shkrimit të fjalëve, të cilat për shkak se janë shkruar gabim, e kanë humbur edhe kuptimin e nenit. Unë do të ndalem në vërejtjet e mia që kam hasur në disa nene ku janë ngjitur lidhëza me fjalën bashkë apo parafjalët janë ngjitur me fjalët dhe kështu e kanë humbur kuptimin dhe mendoj se ligji më parë është dashur të kontrollohet te sponzoruesi, pastaj të silllet në Kuvend.

Shih te neni 3, fjala “qartshëm”, e pakuptimtë, pastaj neni 4 paragrafi 2.2 “ky kt nëshilli” çka do të thotë kjo. Me siguri e ka kuptimin “e këtij këshilli”. Këto gabime teknike mendoj se duhet të korrigjohen në shqyrtimin e dytë dhe të evitohen gabimet teknike që i përcjellin edhe nenet tjera, që nuk dua as ta humbas kohë dhe t’ju lodhi duke i treguar. Përveç vërejtjes time teknike, kam vërejtje substanciale në ligjin, se as te neni 5, përbërja e përgjegjësitë e anëtarëve, dhe as te neni 11 nuk është paraparë një paragraf apo edhe një nen i vetëm rreth përbërjes dhe përgjegjësisë, si kriter për anëtarët apo personat që kanë qenë të inkriminuar në organet e drejtësisë të ish sistemit si gjyqtarë, porotë apo prokurorë dhe kanë punuar me besnikëri verbale ndaj sistemit, duke dënuar, sakatuar jetë dhe njerëz të pafajshëm. Kanë dënuar me dokumentacion false me vite të tëra, jo vetëm të dënuarit, por edhe familjarët e tyre, ku kanë shkatërruar jetën e të dënuarit, kanë shkatërruar familjen, trashëgiminë familjare, e sot i kanë lënë të paaftë për jetë, pa siguri dhe bile po e pengojnë edhe Ligjin e të burgosurve politikë, e pse? Veç se kanë kërkuar lirinë e vendit dhe demokracinë që sot e gëzojnë. Ata sot të jenë porotë tanë, gjyqtarë apo prokurorë. Ne ata i falëm, nuk i dënuam, heshtëm për hir të familjeve dhe fëmijëve të tyre, por ata ne nuk po na falin. Ende edhe sot me lirinë që ua sollëm, ata kanë marrë llupa zmadhuese duke e përcjellë një qime floku për ta njolllosur pjesën më të ndershme të këtij populli, që ky popull t’i ketë sytë tek ata si të mençurit e pushtetit e jo te ata që dhanë pjesë trupi e gjaku për lirinë e vendit. Nuk dua të flas me emra se çka i kanë bërë këtij populli, kush janë ata, se kam konsideratë për fëmijët e tyre. Janë dosjet me mija faqe...

KRYESUESI: E nderuara deputete, lidhur me projektligjin.

TEUTA HADRI: Në ligj jam, qe e kam edhe amendamentin, jam në ligj. Me vite, vite, e që vetë drejtësia kosovare apo vetë fëmijët e tyre do t'i dënojnë në të ardhmen.

Të nderuar deputetë,

Më vjen shumë keq t'ju tregoj dhe tërë jetën do të më rrijë në kokë sikur mos të tregoj një insert të shkurtër, një ngjarje nga burgu gjatë torturave monstruoze. Në burg, një hetues më tha: "Ju luftoni dhe me luftën tuaj do të fitoni, por ne edhe atëherë do t'ua marrim pushtetin, do të marrim edhe 'palicën' dhe përsëri do t'ju rrahim dhe do t'ju burgosim".

Të nderuar deputetë, më vjen shumë keq për tregimin, por më rrinë në kokë ato fjalë ende kur e shoh ligjin e përgatitur, se nuk ka asnjë nen apo paragraf ... për ata persona për t'i penguar, por marshojnë me njerëz të UNMIK-ut, duke mos u lënë vende gjeneratave të reja, të pastra, me duar të papërlyera, gjëja në emër të përvojës së tyre.

Prandaj, deputetë të nderuar, më ndihmoni që në shqyrtimin e dytë të ligjit ta përgatisim një amendament, e ju të na përkrahni që personat që kanë punuar në këto organe të drejtësisë dhe kanë marrë pjesë në dënimet politike si gjyqtarë, prokurorë për dënimin e rinisë, të studentëve që nga viti 81 deri më 91, duke i dënuar ata ne emër të lirisë e demokracisë për mos shkatërrimin e ish Jugosllavisë, të mos pranohen si gjyqtarë - porotë apo prokurorë, pasi që ata gjatë punës së tyre kanë qenë të paafte për të menaxhuar, kanë treguar dështim dhe paafte në procese gjyqësore, bile janë inkriminuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, le të përgatitet deputetja Sanije Aliaj.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë, si parafolësja do të ndalem në nenin 5, Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të këshillit. Kisha për t'iu sugjeruar atyre që e kanë përpiluar ligjin ose komisionit që gjatë marrjes parasysh të kërkesave tona këtu gjatë leximit të parë, të ketë parasysh, të jetë shumë më i saktë rreth nenit 150.1 të Kushtetutës së Kosovës, sepse tash ne po vijmë në një situatë paradoksale. Në njërën anë, e kemi pranuar kushtetutën, e kemi shpall kushtetutën, e kemi përpiluar, e kemi votuar dhe tash, në anën tjetër, me fjalime patetike e sulmojmë me përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse në Kushtetutën e Kosovës, me nenin 150, amendamenti 1, nuk po e lexoj krejt, po veç po e vazhdoj prej një presje "... deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, do të vazhdojë të bëhet në pajtim me Urdhëresën administrative 2008/2 dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut ose nga hyrja në fuqi e kësaj kushtetute". Me fjalë të tjera, përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës veç se është përcaktuar dhe mirë kishte qenë që të bëhet më e qartë, të tjerët mos të manovrojnë rreth termave të llojllojshëm, që të jenë në harmoni me Kushtetutën dhe me Urdhëresën administrative. Kishte për të qenë më e qartë, se po më duket se gjoja ne po i ikim, se kemi diçka kundër asaj urdhërese. Po më duket se i kemi ikur asaj fjale, sepse kushdo që kish qenë me Urdhëresën 2008/02, ata janë pak sa .. patriot, ata janë kah UNMIK-u, po vetë ata janë mbledhur në një rreth, në Bibliotekën e Kosovës dhe kemi duartrokitur, kemi thënë ekspertët më të mirë të Kosovës. Ata e kanë ditë çka po bëjnë me këtë rast. Në rast se ne e gjykojmë përzgjedhjen dhe tentojmë t'i ikim kësaj urdhëresës administrative, jemi diqysh si të pamoralshëm.

Po dua të jemi të drejtpërdrejtë, sepse ajo çka ndodhi sot në Kuvendin e Kosovës, kur kryetari i Kuvendit në mënyrë shumë diktatoriale ma ndërpreu fjalën, ndoshta e ka ditur që do ta ngrejë çështjen e sinkronizimit të veprimeve ...

KRYESUESI: Kolegë, lidhur me projektligjin...

NAIM RRUSTEMI: ...në projektligj jam. E ka ditur që do të flasim për sinkronizimin e veprimeve në veri të Kosovës, siç ka ndodhur me “Elektroprivreda” Srbije, që prej tetorit është duke funksionuar atje. Ndoshta edhe zyrat që janë hapur, ndoshta, ndoshta, se nuk e kemi pritur që do të hapen në korrik, kur janë pritur arrestimet, apo para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, apo me cilin shkak....

KRYESUESI: Sërish po ta tërheq vërejtjen, për ligjin, mundësisht për projektligjin.

NAIM RRUSTEMI: ...në rregull, isha i obliguar, moralisht i obliguar sepse pa asnjë të drejtë ma ndërpreu fjalën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj, le të përgatitet deputeti Arsim Bajrami.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Të respektuar deputetë,

Kaherë ka qenë e nevojshme që funksionimi i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës të rregullohet me ligj, i cili i plotëson standardet ndërkombëtare, që është në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian dhe në harmoni me pakon e Ahtisarit, në mënyrë që Këshilli Gjyqësor dhe gjykatat të funksionojnë si organe të pavarura, që deri më tani nuk ishte në praktikë sepse këto institucione ishin me të madhe nën ndikimin e politikës. Prandaj, me këtë rast falënderoj Ministrinë e Drejtësisë që me këtë projektligj tenton të rregullojë këtë fushë, duke i plotësuar standardet ndërkombëtare dhe duke mundur që Gjyqësori dhe Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës vërtet të funksionojë ashtu siç duhet të funksionojë dhe të jetë në nivel të detyrave dhe përgjegjësi.

Projektligji ka për qëllim të rregullojë sistemin e drejtësisë së pavarur, të paanshëm dhe profesional, i cili ofron qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët. Rëndësia e Projektligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës është e madhe, sepse përveç që rregull pavarësinë dhe paanshmërinë e funksionimit të këtij sistemi të drejtësisë, me këtë projektligj rregullohet mundësia e auditimit të Gjyqësorit, që unë konsideroj eviton praktikën e korrupsionit që me të madhe shfaqet në mediat, edhe elektronike, edhe të shkruara. Njëherësh vlerëson punën e gjykatave dhe i mundëson Këshillit Gjyqësor zbatimin e politikave për një reformim për funksionim të administrimit të gjykatave.

Neni 4 i projektligjit rregullon kompetencat dhe përgjegjësitë të Këshillit Gjyqësor. Me këtë projektligj nuk definohet se kush e bën propozimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, prandaj propozoj që me një nen të veçantë të rregullohet kjo çështje se cilët mekanizma institucional bëjnë propozimin e Këshillit Gjyqësor, i cili duhet të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në paragrafin 1.9, të nenit 4, Këshilli Gjyqësor bën vlerësimet e rregullta periodike mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave që të sigurohet funksionimi efikas i tyre. Me këtë rast do të potencoj se pse deri më tani Këshilli Gjyqësor e lejonte të presin lëndët me vite të tëra në sirtarët e gjykatave? Pra, edhe Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës duhet të kontrollohet që të jetë në nivel të përgjegjësi për të pasur mundësi të kërkojë përgjegjësi nga të tjerët.

Paragrafi 1.25 i nenit 4, obligon Këshillin Gjyqësor që t'i raportojë Kuvendit, presidentit dhe publikut mbi punën e Këshillit Gjyqësor në përgjithësi. Ky paragraf është i mirë, por pse deri më tani Këshilli Gjyqësor nuk e kreu këtë obligim kushtetutar, sepse për të kërkuar përgjegjësi nga të tjerët, në radhë të parë duhet të jesh në nivel të përgjegjësie.

Kreu V, Administrimi i gjykatave, Këshilli Gjyqësor me nenin 21 përcakton politikat dhe strategjitë për funksionimin efikas të gjykatave.

Në nenin 22 dhe nenin 23 të këtij kreu, Këshilli Gjyqësor emëron dhe shkarkon, në konsultim me gjyqtarët e gjykatave përkatëse, ku përparësi do t'i jepet trajnimit dhe specializimit për të qenë menaxher të mirë. Me këtë rast, do të potencojë se cili është mekanizmi kryesor në kuadër të gjykatave, me të cilët konsultohet Këshilli Gjyqësor për emërimin e kryetarëve të gjykatave, në mënyrë që të mos të vijin kryetar të gjykatave njerëzit me një të kaluar jo të ndritur për të udhëhequr institucionet tona, që secilin qytetarë e irriton në qoftë se është në ballë të një gjykate e cila tenton për të jetësuar drejtësinë.

Në paragrafin 5 të nenit 22, kryetarët e gjykatave emërohen me mandat 4 vjeçar, me mundësi të riemërimit, dhe me po këtë nen i mundësohet kryetarit të gjykatës të kthehet në vendin e njëjtë, ku ka punuar edhe më parë. Ky është një privilegj i madh për kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët tjerë, sepse në institucionet tjera nuk ekziston kjo mundësi apo ky standard. Konkretisht, do ta potencojë, deputeti ka mandatin e tij, por nuk ka mundësi që të kthehet në qoftë se ndërprente kontratën në nivel të detyrave që i ka pasur më parë. Pse ky privilegj për kryetarët e gjykatave?

Neni 23 rregullon shkarkimin e kryetarëve të gjykatave dhe të gjyqtarëve mbikëqyrës, ku nuk janë në nivel të përgjegjësie dhe të detyrave. Me këtë rast do të potencojë dhe deri më tani Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës ka funksionuar me disa dokumente dhe deri më tani asnjë kryetar gjykate dhe asnjë gjyqtarë nuk është shkarkuar, edhe pse në raportin e Agjencionit Kundër Korrupsionit kemi mbi 1/3 e gjyqtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë e tyre, që e kanë obligim kushtetutar dhe ligjor, por njëherësh edhe shumë lëndë në mënyrë të padrejtë janë zgjidhur ose prolongohen për t'u zgjidhur. Pse Këshilli Gjyqësor nuk ka qenë dhe nuk kontrollon në këtë drejtim?

Projektligjin e përkrah në parim, se përmbyll pakon e infrastrukturës ligjore për funksionimin e mirëfilltë të Këshillit Gjyqësor dhe të gjykatave, por edhe me një rëndësi tjetër, sepse eviton tërë rregullativën me të cilën kanë funksionuar deri më tani këto institucione.

Mbes me shpresë që projektligji në komisionet funksionale do të amendmentohet dhe do të bëhet më lehtë i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Pa dyshim që ky projektligj është një nga projektligjet kyçe në sistemin e gjyqësisë dhe është një nga ligjet në pakon e ligjeve me të cilat po punohet në reformimin e sistemit gjyqësor, do të thosha është ligji kyç bashkë me Ligjin për Këshillin Prokural, që do të mundësojë një zgjedhje, emërim, gradim të paanshëm të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Gjithashtu, është një nga ligjet sensitive edhe sa i

përket Raportit të progresit sepse, siç e dimë, është kërkuar që të kompletohet korniza ligjore që do të mundësojë një sistem të gjyqësisë së pavarur. Nuk dua të flas më tepër për rëndësinë e këtij ligji, por do të japë 5 vërejtje parimore, pa hyrë në vërejtje konkrete, sepse komisioni funksional është ai që do të adresojë vërejtjet konkrete. Por, unë do të jap 5 vërejtje, që aspak nuk e dëmtojnë konceptin e këtij ligji që përgjithësisht është një ligj i mirë.

E para, nuk duhet pasur pretendim që ky ligj do të garantojë dhe sigurojë pavarësinë e gjyqësorit, sepse pavarësia e gjyqësorit garantohet dhe sigurohet drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Kosovës dhe atë në dispozitat themelore, ku përcaktohet parimi i ndarjes së pushtetit, por ky ligj garanton dhe siguron pavarësinë e punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, që është autoriteti kryesor në zgjedhjen, shkarkimin, disiplinimin, rekrutimin e gjyqtarëve, që pa dyshim është momenti kyç në sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në parandalimin e çfarëdo ndërhyrjeje politike apo ndërhyrje të pushteteve tjera në procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve. Vërejtja ime e parë do të thotë është kjo, ky ligj nuk është ligji kyç që siguron edhe garanton pavarësinë e gjyqësorit, sepse këtë e bën Kushtetuta, por është një nga ligjet që e mundëson reformën e sistemit gjyqësor, bashkë edhe me ligjet për gjykatat e rregullta, që kohë më parë janë miratuar nga ky Kuvend.

Çështja e dytë është një sëmundje kronike e teknikës legjislative që po na përcjell jo vetëm te ky ligj, por çdo ligj që po vjen në Kuvend të Kosovës, nenin 2 e ka të rezervuar për përkufizime, për terma, për terminologji, që nuk është materie tipike normative. Zakonisht, terminologjia nuk i nënshtrohet normimit, por është diçka si shtojca pa aneks. Jo vetëm në këtë ligj, por në shumë ligje përkufizohen apo sqarohen edhe terma botërisht të njohura, që nuk ka nevojë. Për shembull, thuhet kushtetutë, jepet sqarimi se është fjala për Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mendoj që janë gjëra që po e ngarkojnë ligjin dhe janë gjëra që ne duhet t'i diskutojmë seriozisht, sidomos në nivel të standardizimit të ligjeve, të marrin një metodë tjetër që kjo pjesë të jetë në fund, ku jepen sqarime, por jo ta ngarkojë nenin kryesor. Mbas nenit 1, ku caktohet misioni i ligjit, menjëherë neni 2 - përkufizimet dhe në qoftë se duhet të ndërrohet ligji, tash duhet të preket edhe ai nen, kështu që ne duhet të merremi vesh, sidomos Njësia për Standardizimin e Ligjeve, por janë edhe dy komisione në nivel të Qeverisë, Komisioni për evitimin e kolizionit të ligjeve dhe Komisioni për unifikimin e ligjeve, që të kemi një metodologji që përkufizimet dhe nocionet mos t'i ngarkojnë ligjet sepse do të mund të jetë 3 faqe ky nen, sepse te ligjet organike, për shembull, tash po përgatitet Ligji për detyrimet, që i ka 800 nene, nëse i shtimë përkufizimet, ky nen do të na dalë me 20 faqe, sepse të gjitha termat që janë të panjohura, do të futen në atë nen.

Çështje tjetër që u cek, do të thotë, edhe teknika juridike, përpos gabimeve gjyqësore për të cilat nuk ia vlen në Kuvend të harxhohet kohë dhe kisha sugjeruar deputetët që mos harxhojnë kohë në diskutime për gabime gjuhësore, por gjithmonë të kërkojnë që këto të zgjidhen në nivel teknik të Kuvendit dhe teknika nuk është fort koherente, do të thotë nuk është fort koherente dhe aty këtu ka mundësi që ligji në leximin e dytë të jetë më koherent, sepse ky është ligj shumë me rëndësi që duhet të jetë prefekt në aspektin e teknikës ligjore.

Një çështje tjetër që u cek edhe nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, është një çështje që duhet të diskutohet. Është e kuptueshme që Këshilli Gjyqësor ka autoritet të plotë në zgjedhjen, në shkarkimin, avancimin e gjyqtarëve, të personelit gjyqësor, ashtu siç është te Këshilli Prokural të prokurorëve, por në këtë ligj flitet edhe për personalin që punon në Zyrën e Gjyqësorit, do të thotë personalin administrativ, filluar nga sekretari i gjykatës, nga administratorët, nga referentët e ndryshëm. Thuhet se të gjithë ata do të zgjedhen, rekrutohen nga ky këshill gjyqësor. Kjo bie drejtpërdrejt me Ligjin për shërbimin civil, ku administrata e gjyqësorit mbetet edhe më tutje në pozicionin e shërbyesve civilë, kështu që ndoshta është mirë që mos të krijojmë konflikt midis

ligjeve, ligjet të mos jenë mospajtim, sepse çfarëdo procedure apo kërkesë të Gjykata Kushtetuese, mund të shpall jo kushtetuese pjesë të caktuar të ligjit, të ligjeve që janë mes vete të kundërshtueshme. Ndoshta gjatë leximit të dytë e kisha sugjeruar edhe sponzoruesin, profesorin që ta shikojë Ligjin për shërbimin civil dhe eventualisht t'i rekomandojë komisionit që pjesa administrative e Gjyqësorit mos të rekrutohet përmes Këshillit Gjyqësor, po le t'i nënshtrohet procesit të rregullt të shërbimit publik përmes konkursit publik, ku ofrohen mundësi të gjasave të barabarta.

Dhe, sugjerimi i fundit, i katërt, gjatë leximit të ligjit kam vërejtur shumë detale teknike dhe procedurale. Mos të harrojmë, ky është një ligj organik që do të mundësojë punën e pavarur të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Këshilli Gjyqësor do të ketë edhe rregullore të punës, do të ketë edhe udhëzime tjera dhe të mendojmë se disa çështje teknike, organizative që nuk janë të karakterit ligjor, edhe për shkak të fleksibilitetit procedural t'i lihen vetë Këshilli Gjyqësor që me rregullore të punës t'i rregullojë vetë, sepse te rregullat e procedurës dhe të punës duhet të vlejë parimi i fleksibilitetit, ato rregulla duhet të ndryshohen pak më shpejtë dhe ato do të ndryshohen në qoftë se nuk normohen me ligj, por me një akt tjetër nënligjor.

Përfundimisht, mendoj se ky ligj është shumë i rëndësishëm, bashkë me ligjin për Këshillin Prokural dhe Ligjin për Prokurorinë e shtetit. Me sa e di, ne po e kompletojmë kornizën ligjore për reformën e sistemit gjyqësor dhe unë shpresoj që këto ligje të miratohen para muajit shtator ose gjatë muajit shtator, në mënyrë që ato të kenë një impakt të drejtpërdrejtë në Raportin e progresit, i cili do të përmbyllet në muajin tetor. Edhe këto ditë kemi takuar zotin Mirel dhe e kemi parë se çfarë rëndësie ai iu kushton pikërisht këtyre ligjeve, pikërisht këtyre ligjeve që do të mundësojnë një kornizë stabile evropiane, që vërtet në Kosovë të ndërtohet një sistem i gjyqësisë së pavarur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet për kontributin!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Fillimisht, them se diskutimi i kolegut Bajrami më inspiroi, sepse ishte substancial, për dallim prej disave që angazhohen për tema që nuk hynë fare në këtë temë, bie fjala, kush do të zgjedh, kush ka bërë këtë, kush ka bërë atë. Jam kundër atyre që kanë keqbërë. Unë personalisht, mos të bëhet që e mbroj askënd, ani pse nga viti 1970 kam pasur provimin për avokat e për gjykatës, kurrë nuk më kanë zgjedhur as avokat, as gjykatës për shkak të insuficiencës së premisë ideo - politike të kohës. Mirëpo, në parim them, këtu nuk është fjala për kush do të zgjedh e të tjera, një.

Dy, në preambulë do të duhej të bëhej referenca në nenin 108, sepse kjo është dispozita referente, e cila e përcakton statusin kushtetutar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa 65-shi është jurisdikcioni i Kuvendit për ta miratuar aktin ligjor.

Te nocionet, ndoshta do të ishte mirë të miratohej një qëndrim parimor vetëm për institutet juridike, që janë specifike për aktin ligjor të caktuar, e jo ashtu siç e tha profesor Bajrami, për kushtetutën të japim definicion, sepse është nocion, koncepton notor, që dihet fare mirë, madje, madje jepet më mirë diku tjetër se sa këtu apo në cilindo akt ligjor.

Lëshohem edhe në nivelin e definimeve apo të specifikimeve kuptimore të disa..., bie fjala, Këshilli i Përkohshëm, thuhet: "nënkupton Këshillin themelor me anë të ligjit", për përbërjen e përkohshme të

Këshillit Gjyqësor, që nuk është apelacion i drejtë, se ky nuk është ligji i tillë, po ky është, që ku e kam këtë ligj, Ligji 03/L-123 për përbërjen e përkohshme, nuk është Ligji i përkohshëm, po Ligji për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kështu që ata që bëjnë akte, do të duhej të jenë korrekt, shumë të përgjegjshëm, sepse juridika dallohet, e ka gjuhën më të mirë të mundshme nga të gjitha shkencat. Pse? Synon të jetë precize, koncize dhe e qartë e konsistente.

Ju lutem kolegë, po e zëmë, neni 4, këto janë rekomandime parimore që besoj do të shkojnë në funksion të punës në etapën e dytë. Neni 4, paragrafi 1, alineja 1, ja çka thotë: “Regrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërimin dhe riemërimin e Zyrës së Gjyqësorit”, po zyra nuk emërohet, as nuk riemërohet, zyra a, “përfshirë edhe kandidatët nga komunitetet që nuk janë shumicë”. Kjo është, ju lutem, formulacion politik që nuk hyn as nuk duhet të hyjë në ligj, se i kem atje parimet themelore, ku garantohet, ju lutem, statusi i barabartë dhe atë nuk duhet ta përsërisim në çdo akt ligjor, se i del boja dhe bëhet anti-efektive për synimin apo për aspiratën e caktuar.

Ju lutem, ja si është formuluar, po e zëmë, neni 4, paragrafi 1, alineja 3: “Në mënyrë që të sigurohet se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të jurisdikcionit në përputhje me nenin 104 të Kushtetutës...”, më pastaj thotë: “dhe shtojcës 4, neni 2.2, propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit...” e tjera e tjera, që nëse do të duhej nisur nga kjo, do të duhej të merrej burimi akt. Propozimi nuk është, siç e tha dikush prej kolegëve këtu, pakoja. Çfarë pakoje, ai nuk e ka quajtur pako, se ka quajtur package, po e ka quajtur proposal, propozim, bile kjo ka dallim substancial, ju lutem, dhe nëse do të duhej të thirr, atëherë do duhej fillimisht në atë se ai dokument paraqet burim akt për kushtetutën, hierarkia, pra.

Në kushtetutë, komisioni redaktues e ka përcaktuar termin jo “parashihet”, se moti parashihet, ligji nuk parasheh kurrëgjë, po përcakton. Prandaj, angazhohem që kudo, jo në këtë dokument, po në të gjitha dokumentet ligjore – përcaktohet, jo parashihet.

Bie fjala, te paragrafi 1, alineja 5, thotë: “bën shpalljen e rregulloreve për transferimin edhe procedurën disiplinore”. Shpalljen e bën teknika, e bën administrata, ajo është teknikë, po e bën miratim, ky është funksioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Prandaj, kjo përsëritet në shumë vende dhe duhet medoemos të ndërrohet.

Po asi soji, thotë, ose rekomandimet, kjo është edhe në kushtetutë, po është funksioni i butë, i ulët, që të bëjë rekomandimin. Do të duhej të ishte: “Këshilli Gjyqësor bën propozimin, ndërsa Kuvendi miraton”, bie fjala, eventualisht “nuk miraton”.

Është neni, po zëmë, 5, paragrafi 3, shumë i gjatë, domethënë nuk është në harmoni me onomoteknikën, plus është fushë e Ligjit për Gjyqësorin, ku thuhet – kryetari i Gjykatës Themelore e ka këtë autoritet. Me Ligjin për Gjyqësorin do ta caktojmë në mënyrë enumerative, taksative, precize funksionin e kryetarit të Gjykatës Themelore, e me këtë nuk caktohet statusi i kryetarit të Gjykatës Themelore, as të Apelit, po Këshilli Gjyqësor, prandaj do të isha angazhuar të koncentrohemi vetëm në Këshillin Gjyqësor dhe në atë mënyrë ta heqim një numër të konsideruar të këtyre dispozitave që dalin prej kornizës.

Po kështu është edhe te neni 32, Komisioni Administrativ i Gjykatës, madje rregullon paragrafi 2 materie që është e nivelit të rregullores për punën, për organizimin e brendshëm, punën edhe funksionimin e Komisionit Administrativ të Gjykatës Themelore. Nuk është tematikë ligjore, pra.

Te neni 42, do të duhej të plotësonim disi se, bie fjala, nëse Këshilli Gjyqësor e refuzon ankesën e gjykatësit të caktuar, bie fjala, atëherë çka më tutje, a do të ketë farë të drejte të shkojmë më tutje, ta precizojmë se a thua eventualisht a në procedurë administrative apo eventualisht në procedurën gjyqësore. Gjithsesi, duhet të precizohet kjo pjesë.

Një formulim, e ka këso formulimesh shumë, që nuk është, si të them, konsistent. Neni 47, paragrafi 1, alineja 2, thotë: “Drejtori i Zyrës së Prokurimit, prokurori disiplinor duhet të diplomë të vlefshme universitare të juridikut”, në vend që të thuhet të jetë juristë ose të jetë me diplomën master program e tjera. Ose thotë të administrimit policor, hajde kjo deri diku, mirëpo kur thotë:”Apo të një fushe të ngjashme në përputhje me ligjet e Kosovës”. Kjo është me të vërtetë shumë e lezetshme të merret e të fshihet, delete, sepse kurrfarë kuptimi s’ka dhe disi e bën edhe qesharake, domethënë një diplomë, çfarëdo diplome me ligjet e Kosovës.

Përfundimisht, në parim, ju lutem, me këtë dokument ani pse konsumohen dispozitat e Ligjit numër 123/03, nuk thuhet se ai shfuqizohet, po shfuqizohet një Rregullore e UNMIK-ut e do të duhej të thuhej se shfuqizohet Ligji numër 03/L-123, sepse këto dispozita i kam analizuar, janë të absolvuara, janë të përpunuara me këtë dokument dhe, kesi sojit e bëjmë, mos të na mbeten ligje që nuk aplikohen. Do të ishte një shembull i keq që do të mbetej një akt ligjor, i cili nuk është shfuqizuar në mënyrë shprehimore eksplicite, implicite po, mirëpo do të delte se është i aplikueshëm.

Përfundimisht, pikëpamja ime është se t’i shprehim konsiderata Ministrisë së Drejtësisë, ministrit të nderuar Demolli për punën e bërë, për intencën që ta rregullojmë këtë sferë shumë të rëndësishme, të funksionalizohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës, sepse është sfera apo është 1/3 e të gjitha pushteteve e cila ka shumë defekte, supozohet se janë mbi 250.000 lëndë gjyqësore të paprekura, nuk dihet sa janë që nuk përmbahen, që është edhe më e keqja e më të këqijave, kemi aktgjykime të cilat nuk përmbahen, ajo që ...(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Rexhep Hoti.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ngase u thanë shumë gjëra këtu, nga se po flasim për Këshillin Gjyqësor, që është njëri nga institucionet më të rëndësishme të shtetit të Kosovës, siç e dimë, desha të ndalem vetëm në një pikë dhe kjo ka të bëjë me Urdhëresën administrative 2008/2, që është po ashtu pjesë e Kushtetutës së Kosovës dhe me një fakt që Gjyqësorin nga paslufta është kah e mundon shumë, siç e dimë, sipas shumë raporteve del se kjo sferë është nga më të korruptuarat në shtetin e Kosovës. Andaj, unë propozoj që te neni 17 po mundet edhe te neni 18, po te neni 17 ta fusim pikën 6, të kërkohej pastërtia e figurës së gjyqtarit, gjithmonë them konform kërkesave që Urdhëresa administrative 2008/2 veç i parasheh, pika 2.11, ku thuhet: “të gjithë kandidatët, pa përjashtim, duhet të kalojnë kodin relevant të etikës” dhe ata të cilët e përcjellin këtë sferë të rëndësishme, po them, të shtetit të Kosovës, e dinë se jo larg para disa muajve ndodhi një skandal, ku disa gjyqtarë, në realitet 2 gjyqtarë, të cilët nuk e kaluan testin e etikës, andaj edhe Këshilli Gjyqësor nuk mundi t’i propozojë për kandidatë. Fjala është për gjyqtarët Meleqe Bexheti e Avdi Dinaj dhe prokurorin Vesel Jashari, por pastaj shfat e mëdhenj ndërhyjnë, ashtu siç është bërë zakon tash për gjithçka të ndërhyjnë dhe ata u emëruan, kështu edhe u dha ky lajm nëpër mediat e Kosovës. Domethënë, është një shkelje e dispozitës kushtetuese dhe është kërkesë, po them, gjithnjë po i referohem Urdhëresës administrative 2008/2, që testi i etikës dhe pastërtia e figurës së gjyqtarëve është obligim kushtetues dhe kjo pastaj do t’i ndihmonte gjyqësorit të pastrohet nga shumë elemente, nga shumë kontaminime që janë bërë, që ne i dimë. Po ashtu, konform kësaj desha të them edhe apo të protestoj ndaj skandalit që

e bëri zoti Jakup Krasniqi, kur i shkeli me dy këmbët rregullat e Kuvendit, tamam është një rast se si e ka shndërruar...

IBRAHIM GASHI: Deputet, lidhur me projektligjin, të lutem!

DRITON TALI:... Kuvendin në çfarë niveli, në çfarë derexhe, tamam si në kohën e Stalinit edhe të Enver Hoxhës, të idolëve të tij, me një përjashtim është se nuk po na çon në kampe të përqendrimit, po ai qysh është duke shkuar...

KRYESUESI: Zoti deputet, kjo s'ka të bëjë me projektligjin, vërejtja e fundit. Kthehu në temë!

DRITON TALI: ... s'dihet edhe atje na çon, jo kjo është skandal i llojit të vet. Kjo tregon, Jakup Krasniqi në çfarë niveli e ka sjellë Parlamentin, ma merr fjalën, i shkel të gjitha rregulluat, që është pjesë edhe e Kushtetutës, kjo është skandali i llojit të vet...

KRYESUESI: Tani më vjen shumë keq, por unë detyrohem që t'ua marrë fjalën, sepse flet diçka që nuk ka të bëjë me pikën...

DRITON TALI: Edhe atë plotësisht mund ta vazhdoni, se këtë stil të menaxhimit....

KRYESUESI: Vazhdojmë. Diskutuesi i radhës, deputeti Rexhep Hoti, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni- Kaloshi.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Me Projektligjin për Këshillin Gjyqësor, dhe me Projektligjin për Këshillin Prokurorial dhe me Projektligjin për Prokurorinë e shtetit, bëhet reformë e madhe në drejtësi, një prioritet jashtëzakonisht i madh për institucionet e Kosovës dhe një kërkesë dhe prioritet gjithashtu i madh për standardet e Bashkimit Evropian, për të cilin ne edhe dëshirojmë të shkojmë atje. Unë zoti ministër, do t'i paraqes tri vërejtjeje, tri sugjerime, por për të tria projektligje, sepse janë të inkorporuar dhe besoj do të keni mirëkuptim.

Sugjerimi i parë është, do të është mirë që të kishte Zyra e Prokurimit Disiplinor këshill gjyqësor të veçantë dhe këshill prokurorial të veçantë, pasi që këto dy mekanizma janë të ndara edhe me bazë kushtetuese. Me Ligjin për Këshillin Prokurorial, neni 33, parashihet që në kuadër të Këshillit Gjyqësor të funksionojë edhe prokurori disiplinor edhe për prokurorin. Kjo nuk mendoj se është në rregull, pasi që Këshilli Gjyqësor duhet të vendosë për disiplinën e gjykatësve, ndërsa Këshilli Prokurorial duhet të vendosë për disiplinën e prokurorëve.

Sugjerimi i dytë të Projektligji për prokuroritë i është lënë Zyrës së kryeprokurorit të shtetit, që të ofrojë mbështetje administrative për Këshillin Prokurorial, dhe nuk parasheh që Këshilli të ketë sekretarinë e vet, ashtu siç e ka Këshilli Gjyqësor. Mendoj se të kjo do të duhej që të shkohet ngjashëm sikurse edhe me Këshillin Gjyqësor, pasi që nuk do të kishte as implikime të mëdha buxhetore dhe do të ishte një pavarësi më e madhe e Këshillit Prokurorial dhe organeve të tij në raport me prokurorin e shtetit.

Dhe 3, askund në këto projektligje nuk është trajtuar çështja e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe e praktikantëve, qoftë të atyre gjyqësorë edhe atyre prokurorial. Bashkëpunëtorët profesionalë e

kanë rolin e këshilltarit kur përgatisin shumë lëndë për gjyqtarin apo për prokurorin, varësisht se për cilin institucion bëhet fjalë, andaj, do të duhej të zënë vend në këto projektligje.

Mendoj se do të duhet që për dy prokurorë të jetë një bashkëpunëtor profesional, ngjashëm sikur edhe te Gjykata Kushtetuese dhe të ekzekutivi. Ju falënderoj shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni- Kaloshi, le të përgatiti deputeti Naser Rugova.

HYDAJET HYSENI -KALOSHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke iu përshëndetur juve, të përshëndes ministrin dhe zëvendëskryeministrin, të përshëndes ligjin që na e kanë sjellë, një ligj i cili siç e dini është punuar me vite. Kam qenë pjesë e ndonjë grupi punues në fillim dhe mund të konstatoj, pa u druajtur se gaboj se ka pasur variante më të mira të këtij ligji, dhe përshtypja ime është se është përzier shumë politika dhe për pasojë është ngatërruar. Është ngatërruar, madje çështja edhe në vetë Kushtetutën dhe tash ne jemi në vështirësi, sepse e dimë që me ligj s' mund t'i ndryshojmë defektet e Kushtetutës, kurse ato që është e vërteta shpesh derivohen prej Kushtetutës dhe dokumentit që i ka paraprirë Kushtetutës.

Megjithatë, një gjë është e evidente, është një hap drejt kosovarizimit të legjislationit në këtë fushë, të cilin natyrisht e përshëndes. Në ligj është thënë se ky ligj sjell sistematizim të ri dhe ndryshime përmbajtjesore dhe unë dëshiroj që të ishte kështu, por dua të jem i sqartë, nuk jam bindur se është bërë kjo. Përshtypja ime është se ky sistematizim i ri, do të thotë, strukturim i ri i gjyqësorit, mbetet të bëhet më vonë.

Ky ligj është punuar nga Ministria e Drejtësisë dhe është e pritshme që të ishte model i hartimit të ligjeve. Nuk është për fat të keq dhe unë s' mund ta fajësoj për këtë ministrin aktual se e di që ky draft ka qenë i përgatitur më herët dhe nuk ka pasur mundësi të ndryshohet, por megjithatë ndoshta së paku disa defekte të natyrës teknike e tjera, kanë mundur të korrigjohen. Kalimthi, vetëm po them, për shembull nëse në memorandumën përcjellës përdoren forma të këtilla, numri romak IX, që lexohet i nëntë, dhe është krerë, është dashur të thuhet që Ligji ka nëntë kapituj, nëntë krerë, por është thënë i nëntë krerë, s' ka asnjë kuptim, ose formula të tilla, siç ceket në Kushtetutë. Në të folmen tonë në Kosovë, shumë cekët kjo fjala: "ceket, ceket, ceket", por në ligje nuk shkon, ju lutem. Ose gjykatësi pranon pagë, në gjuhën serbe është: "prima platu", që tingëllon natyrshëm, por në gjuhën shqipe "pranon rrogë" s' ka, po ashtu, asnjë kuptim. Ose shprehje që ne i kemi theksuar këtu në vazhdimësi, por çuditërisht në mënyrë këmbëngulëse ligjet na sillen me këtë të famshmen të përkufizimet shprehja "nënkupton", kurse për të qenë më e çuditshme në anglisht është mirë, min, që do të thotë ka kuptimin, do të thotë ose në serbisht është: "znači" që përsëri është sakt, por në shqip është vetëm nënkupton dhe profesori e ka sqaruar sa e sa herë që në gjuhën shqipe nënkupton nuk e ka kuptimin, ka kuptimin, do të thotë, që duhet të jetë. Nënkupton është kuptimi i dytë, i tretë i një fjale.

Për më tepër, në këtë nenin e përkufizimeve, kjo nënkupton përsëritet në shumicën e shprehjeve, kur vjen çështja te gjyqësori atje më nuk është "nënkupton", por është "përfshin gjykatësit e tjera" dhe formula kthehet jo në përkufizim, por në dispozitë.

Mund edhe të mos insistohet këtu sikur të mos jetë fakti që po na përsëriten vazhdimisht. Megjithatë, unë dua të tërheq vërejtjen edhe një herë te çështja që po ashtu është përsëritur këtu dhe më lejoni si digresion të bëj një vërejtje të përgjithshme për ligjvënien te ne. Kur theksohet një

vërejtje parimore që mbështet nga Kuvendi, është e pritshme që kolegët që punojnë në atë komision ta marrin atë përsipër dhe pastaj ta kthejnë në amendament, që të mos bëjnë të gjithë amendamente. Është tërhequr vërejtja për formulën të kushtet e të qenit këtu anëtar i Këshillit Gjyqësor edhe gjykatës, me përjashtim, do të thotë, të atyre që janë dënuar për vepër penale dhe vini re duke përjashtuar të dënuarit për vepër kundërvajtës. Do të thotë, është futur sistemi i përjashtimit, por përsëri në mënyrë sistematike lihet e paprekur ajo çështja e të dënuarve të pafajshëm, janë shumë, zonja e zotërinj.

Shtrohet dilema, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu, po ia përmendur emrin, ai s' ka të drejtë në replikë këtu, se s' është këtu a është i ligjshëm në Gjykatën Kushtetuese? Me ligjet tona jo, ose ndoshta edhe ndonjë tjetër. Pse atëherë e lëmë këtë anomali, ose duhet ta rregullojmë në parim me një akt të veçantë ose siç është propozuar të jetë në të gjitha rastet, duke i përjashtuar, po e zëmë, veprat penale që nuk janë më në fuqi në Kosovë? Edhe kjo i përjashton pastaj të gjitha veprat për veprimtari armiqësore, propagandë armiqësore, delikt verbal e sa e sa të tjera. Dhe dua ta mbështes po ashtu vërejtjen që u bë në nenin 12, që imunitet u garanton anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, vini re, për shkelje që s' janë të vullnetshme të ligjit.

Në Kushtetutë është një marifet i tillë, një xhevahir i tillë. Në shkelje të qëllimshme të ligjit, do të thotë. Edhe ajo është për mendimin e pakuptueshme, por ama të lihet kjo, se nëse është shkelja e pavullnetshme, atëherë ai ka imunitet, vërtet nuk ke si e gëlltit, sepse shtrohet çështja në shumë raste gjykatësit tanë, për fat të keq ose për fat të mirë s' kanë vullnetin të bëjnë shkelje, por po bëjnë bukur shumë shkelje, jo pse kanë vullnetin, por pse po i detyron ose dikush me urdhër politik, ose dikush me një instrument tjetër shtrëngimi a kërcënimi a joshje, a tjera dhe po na ndodhin në ligjet të Ministrisë së Drejtësisë, nuk duhet të lejohen precedentë të tillë, sepse shtrohet puna si mund atëherë dikush të ndajë drejtësinë siç duhet nëse niset në parametrat e tillë, shkelje e vullnetshme ose e pa vullnetshme e ligjit. Shkelja është shkelje dhe është e pafalshme sido që të jetë, mund të jetë eventualisht rrethanë lehtësuese, gjykatësit e dinë më mirë se unë.

Dhe një çështje të fundit që desha ta shtroj, me lejen e juaj te ajo sistematizimi i ri, do të thotë, strukturimi i ri i gjyqësorit, që unë uroj të bëhen në të ardhmen dhe eventualisht këtu mund të thuhet se është një përpjekje për ta nënvizuar, për ta sforcuar atë përsëri të famshmen, pavarësi e plotë. Sa herë të bisedojmë me gjyqësorin, është ky insistim në pavarësi dhe ne gjithmonë e mbështesim ndarjen e pushteteve dhe nevojën e funksionimit të pavarur të gjyqësorit. Por, thonë mënyra më e mirë për të diskredituar diçka të drejtë është ta qosh në absurd dhe të insistosh që pavarësia e gjyqësorit të jetë e plotë në gjithçka, mund të kuptohet si një përpjekje për të krijuar një ombrellë nga shoqëria, për një pavarësi nga shoqëria, nga ligji, nga qytetarët dhe kjo mendoj që është diçka për të cilën duhet të ndalemi dhe të reflektojmë.

Të gjitha pushtetet burojnë nga qytetari. Fjalja fillestare e Kushtetutës tonë është: Ne populli i Kosovës, diku qytetarët e Kosovës, varësisht nga përkthimet, por burimi është nga poshtë. Prandaj edhe pushtetet ndërtohen nga poshtë dhe përfaqësuesit e zgjedhur janë ata që e përcjellin këtë pushtet dhe ua delegojnë pastaj të tjerëve. Për mua është e pakuptueshme dhe e rrezikshme tendenca për ta përjashtuar krejtësisht legjislativin nga procesi, si të thuash, i ndërtimit, strukturimit edhe të pushteteve të tjera. Po sjell si shembull vetëm, se në Kroaci dhe në ndryshimet aktuale kushtetuese, dy deputetë janë anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Pse të mos jetë kjo edhe në Kosovë? Çfarë të keqe ka nëse ka një ndërlidhje midis pushteteve? Modeli më i verifikuar dhe i dëshmuar si i suksesshëm, është modeli check and balace, midis pushteteve, do të thotë e ndërvartjes, e mëvetësisë, por edhe e kontrollit të ndërsjellë të pushteteve. Mendoj që i duhet kjo edhe sistemit tonë, veçanërisht në realitetin tonë kur dihet kemi një gjyqësi të pareformuar, respekt

përjashtimeve, respekt atyre që kanë punuar dhe ne jemi dëshmuar se jemi për vazhdimësinë, por megjithatë fakti është i vërtetë se vijmë nga një sistem i dëshmuar si i padrejtë, nga një sistem që e ka instrumentalizuar gjyqësorin, dhe e ka instrumentalizuar me forma shumë problematike dhe të shantazhimit që vazhdojnë të mbeten dhe tani...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet Hyseni!

Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Rrustem Mustafa.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Po e shqyrtojmë sot një projektligj jashtëzakonisht të rëndësishëm për funksionimin, por edhe funksionalizmin e sistemit gjyqësor në Kosovë, i cili sipas të gjitha rekomandimeve që i kemi edhe ne vetë si qytetarë edhe si përfaqësues të popullit, por edhe miqtë ndërkombëtarë që vërtet është një nga vrimat e zeza të funksionimit të shtetit të Kosovës, sidomos në këto etapa të rëndësishme të shtetndërtimit.

Zoti ministër,

Duke e ditur përgjegjësinë, por edhe rëndësinë e kësaj pakoje ligjore për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Republikës së Kosovës, por edhe Ligji për prokurorin e shtetit, por edhe Ligji për gjykata, vërtet është një materie e cila nga ky Kuvend duhet ta marrë miratimin, por të jetë ligje vërtet cilësore, përmbajtjesore që funksionalizojnë, krijojnë ambient të favorshëm për reformën në tërësi dhe në plotësi, por edhe reformë cilësore të Gjyqësorit në Kosovë, edhe pse jemi të vetëdijshëm që kjo kërkon mund, kohë, por edhe mbështetje financiare.

Ky projektligj vërtet nuk është i shkruar konform rëndësisë që e ka, adresa e sponzorizuesit, duke e ditur që Ministria e Drejtësisë, duhet të ishte shembull për të mirë për përgatitjen e ligjeve, qoftë në aspektin përmbajtjesor, qoftë të teknikave juridike. Formulimet abstrakte dhe jo profesionale nganjëherë japin paqartësi edhe në përcaktimin e paragrafëve dhe alineve të caktuara të neneve të këtij ligji, që nganjëherë mund të shkaktojnë edhe konfuzion edhe në zbatim, por edhe në interpretim. Po flasim për një institucion shumë të rëndësishëm për një kategori kushtetuese që mbase do të jetë ajo zanafilla kryesore e fillimit të reformimit, të funksionalizimit dhe të një pavarësie optimale të gjyqësorit në Republikën e Kosovës, që është një nga parakushtet themelore të sundimit të rendit, të ligjit, që është kërkesë permanente e objektivave politike nga mekanizmat e Bashkimit Evropian.

Unë nuk do të ndalem në nenet konkrete të këtij projektligji, por është e nevojshme që ne si deputetë, duke e ditur rëndësinë e kësaj pakoje ligjore, të saktësojmë, precizojmë dhe të qartësojmë punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Gjithashtu të analizojmë dhe të përcaktojmë si duhet përshtatshmërinë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse, duke e parë ndikimin e politikës në gjyqësor apo edhe imponimet tjera, ndikimet nga jashtë edhe në këtë situatë që jemi, duke e ditur brishtësinë dhe fragjilitetin e gjyqësorit në Kosovë, për shkak të periudhave të tranzicionit që po i kalojmë, vërtet na nevojiten ligjet cilësore, konkrete, pragmatike, në mënyrë që legjislativi t'i krijojë komoditet pavarësisë optimale dhe ambient zhvillimit të gjyqësorit, kurse ekzekutivi i ka punët e veta të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi.

Duhet të përcaktohet në projektligj, kush e bën propozimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor? Kjo duhet të definohet mirë, të saktësohet, duke e ruajtur gjithnjë pavarësinë e këtij institucioni tejet të rëndësishëm. Andaj, në reformën e gjyqësorit, duhet të jemi të kujdesshëm si Kuvend, sepse këto ligje e marrin miratimin e deputetëve, e të zgjedhurve të qytetarëve të Kosovës. Unë e ftoj edhe Komisionin funksional, por, në radhë të parë, ministrin si profesionist i kësaj lëmie dhe ekspertët e tjerë, që vërtet të japin kontributin e tyre në hartimin e këtyre projektligjeve që janë shumë të rëndësishme, sepse po na imponohet pas një apo dy vjetëve, që për një amendament apo nen të caktuar, të bëjmë plotësime e ndryshime të ligjeve se s' paskan qenë në konkordancë të plotë me *acquis -communautaire* apo me direktivat e caktuara të BE-së dhe, në njëfarë forme të fillojmë të fillojmë ta ndërtojmë atë fundamentin e reformës të mirëfilltë të sistemit gjyqësor në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Lus deputetët që janë jashtë që të kthehen në sallë për të votuar projektligjin në parim, ndërkaq fjalën e ka diskutuesi i fundit, deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Unë jam i kënaqur me projektligjin që e kemi përpara. Projektligji për Këshillin Gjyqësor i Republikës së Kosovës, pavarësisht problemet që ka me çështje teknike, gjuhësore dhe terminologjike, i plotëson kushtet për ecjen përpara, mendoj ofron infrastrukturë të mirë për të shkuar më tutje dhe bën ndarjen nga praktikatat e vjetra, duke shkuar tek praktikatat e reja, është e punë që këtë e shohim me siguri të lartë. Është për të na ardhur mirë se të gjithë deputetët po angazhohen në lexim të parë shumë për këtë ligj, por edhe ligjet tjera kanë filluar. Unë kisha dashur që të gjithë deputetët dhe unë, të angazhohemi më shumë në komisione, sepse komisionet janë ato që merren me projektligjin. Unë vetë e udhëheq njërin prej komisioneve, por në komisione, të jeni të sigurt, zoti kryesues, edhe duhet ta përcillni te Kryesia e Kuvendit dhe duhet të marrim diçka, praktika të reja se asnjë koment nuk vjen nga deputetët nëpër komisione. Prandaj unë i kisha lutur që deputetët, përveç angazhimit që marrin sot, në seancë për të folur ku pak send thuhet për esencën, për substancën e ligjit, por vetëm për çështje teknike, që të vijnë në Komision dhe ta bëjnë punën e tyre.

Gjithashtu, për Kryesinë e punës kam një lutje që të ngarkojnë sekretarinë e Kuvendit, që të punësojnë, t'iu ofrojnë mundësi potenciale burimet financiare që t'iu mundësojnë ta bëjnë një ekip që do të merren me çështje teknike, gjuhësore dhe terminologjike edhe të mos marrim kohën kot, ngase substanca e këtij ligji, unë jam i sigurt që është substancë e punuar mirë, është substancë që garanton rregullsi në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe koha krejt sikur po e zbeh substancën e ligjit të çështjeve për të cilat folëm. E di që me përkthime nuk mund të merremi të gjithë, por edhe e di që është deputet. As ministri nuk duhet të merret me çështje terminologjike, çështje teknike dhe çështjen e përkthimit. Unë ndihem mirë se po bëhet rumbullakësimi i infrastrukturës ligjore në gjyqësi dhe shpresoj që kontributin tim personal, por edhe deputetët e tjerë që folëm për të gjitha këto vërejtje, ta japin në Komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Deputetët e kanë shfrytëzuar nga një herë fjalën për çka është? Pra si reagim. Okej.

Fjala deputetes Aliaj, replikë një minutë.

SANIJE ALIAJ: Edhe pse nuk mu ka përmendur emri, nuk kam asgjë kundër, është çështje e prononcimit të tij, por nuk pajtohem me deklarinimin se deputetët, angazhimin kryesor për të bërë ligje më funksionale dhe më lehtë të zbatuara në praktikë nga institucionet të cilat i dedikohen,

deputetët nuk janë në nivelin e duhur për të propozuar amendamente kryesore, thelbësore dhe në komisionet funksionale të shkojnë dhe të japin propozimet e tyre.

Po e them këtë, me një përgjegjësi, sepse Bordi i grave deputete, shumë komisioneve funksionale iu dërgon amendamente për ligjet konkrete në bashkëpunim të ndërsjellë me ekspertët. Prandaj mos të jetë ky një prononcim për opinionin se deputetët nuk kanë angazhim aspak ...

KRYESUESI: Ju faleminderit! E kuptuam reagimin tuaj.
Kundër replikë, deputeti Mustafa

RRUSTEM MUSTAFA: Me respektin më të madh, unë e shoh që ajo nuk më ka kuptuar mua. Unë thashë që angazhimi i deputetëve duhet të shihet sikur këtu edhe në komisione. Nuk pata kurrgjë me atë çka e tha zonja. Unë e di që deputetët thashë janë për substancën e ligjeve dhe janë duke punuar, mirëpo krejt tjetër pune kam thënë unë, e tjetër qysh më ka kuptuar. Më falë zonjë se e keni ndier veten keq, por unë nuk kam pasur kurrgjë me atë çka folët ju. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ndërkaq në fund ministri nuk e ka kërkuar fjalën... Tash kemi 60 sipas regjistrimit dhe kemi problem. Duhet të kalojmë, domethënë, në pikën e radhës dhe votimin ta lëmë kur të jemi komplet.

Atëherë, kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zoti Haki Demolli, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Pas Projektligjit mbi Këshillin Gjyqësor, Kuvendit të Kosovës, në emër të Ministrisë së Drejtësisë, do t'ia paraqes për miratim Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj paraqet njërën prej pjesëve tejet të rëndësishme në kompletimin e infrastrukturës ligjore në rrafshin e sistemit të drejtësisë kosovare. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, parashihet që me ligj të posaçëm të rregullohet përbërja, struktura organizative, procedura e themelimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Pikërisht ky draftligj e përcakton Këshillin Prokurorial si një institucion i cili menaxhon me çështjet administrative, financiare dhe buxhetore të prokurorisë. Po ashtu, ky draftligj përcakton që Këshilli Prokurorial të bëjë administrimin e prokurorive, pastaj t'i zhvillojë politikën, strategjitë dhe procedurat funksionale të prokurorive, përfshirë këtu edhe propozimin për emërimin, vlerësimin, avancimin në detyrë të prokurorëve të Kosovës, si dhe transferimin dhe disiplinimin e tyre deri te rekomandimi për shkarkim.

Me këtë projektligj, do të vendoset një kornizë adekuate ligjore që do ta fuqizojë Këshillin Prokurorial të Kosovës, në një institucion të pavarur, të paanshëm dhe profesional që do të ndihmojë, mbikëqyrë dhe vlerësojë punën e prokurorisë. Ligji i propozuar i trajton çështjet e rëndësishme për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Prokurorisë, kualifikimet dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, rolin administrativ të Zyrës së Prokurorit të

Shtetit, regrutimin, propozimin dhe emërimin e prokurorëve, vlerësimin dhe transferimin e tyre, administratën e sistemit të prokurorisë, procedurat disiplinore ndaj prokurorëve, zyrën e përbashkët të prokurorëve disiplinorë, trajnimin e prokurorëve dhe çështje të tjera.

Aprovimi dhe zbatimi i këtij projektligji, në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në shtimin e efikasitetit në punën e prokurorisë në përgjithësi dhe zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale në veçanti. Ngritja e efikasitetit në rrafshin e zbulimit dhe luftimit të krimit, gjithsesi do të ndikojë edhe në përforcimin e besimit të qytetarëve të Kosovës në organet e judikaturës në përgjithësi, përfshirë këtu edhe institucionin e Prokurorisë shtetërore.

Ky projektligj do të ketë rëndësi të posaçme në ndërtimin e një sistemi prokurorial unik dhe funksional, konform Kushtetutës të Republikës së Kosovës, ligjeve dhe akteve vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Me këtë rast, do të theksoja se Ministria e Drejtësisë për përpilimin e këtij projektligji, ka angazhuar, përveç ekspertëve vendorë edhe ekspertë ligjorë ndërkombëtarë.

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Aprovimi i këtij projektligji, do të jetë në funksion edhe të kompletimit të infrastrukturës ligjore, konform kërkesave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian. Andaj propozoj që ky projektligj të miratohet në parim në Kuvend dhe kështu të mundësohet procedimi i tij për aprovim në procedurë të mëtejme. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri ministër!

Shkojmë më tutje. Në emër të Komisionit funksional, fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar, zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e respektojmë gatishmërinë edhe të ministrit edhe të Qeverisë, që brenda afatit të paraparë ligjor kanë sjellë edhe një projektligj shumë të rëndësishëm për funksionalizimin e institucioneve në Kosovë, duke marrë parasysh që deri me tani Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka vepruar duke pasur në kuadër të Këshillit edhe prokurorë, gjë e cila ndoshta nganjëherë nuk ka sjellë edhe situata shumë të lakmueshme sa i përket prokurorëve që të veprojnë të pavarur nga organet e gjyqësisë apo gjyqtarët.

Unë do të fokusohem vetëm në disa nga çështjet, pa i përmendur ato çështjet teknike, sepse do të mbetet që t'i bisedojmë detalisht gjatë leximit të dytë edhe pse konsideroj që për këto projektligje do të organizojmë edhe dëgjim publik, por do të ndalem te, meqë për herë të parë po e krijojmë Këshillin Prokurorial të Kosovës, që është paraparë me Kushtetutë, nëse e marrim, edhe në Komision e kemi pasur këtë vështirësi, nuk qartësohen saktë kompetencat që do t'i ketë Këshilli Prokurorial i Kosovës, si organ i cili do të menaxhojë me emërimin, shkarkimin, masat disiplinore dhe shumë çështje tjera për prokurorët dhe në anën tjetër të prokurorit të shtetit.

Nëse lexohet me vëmendje, më tepër në projektligj është fokusuar sponzorizuesi te kryeprokurori si individ e jo te Prokuroria e shtetit si institucion, ndoshta këtë duhet gjithsesi ta qartësojmë. Natyrisht, që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka parë edhe njërin organ edhe tjetrin si organe plotësisht të pavarura dhe kjo do të sjellë në një situatë që athua do të ketë mundësi që Këshilli

Prokurorial i Kosovës ta kryejë funksionin apo përgjegjësitë që i takojnë me Kushtetutë? Vetvetiu, duke marrë parasysh që në krye të Këshillit Prokurorial të Kosovës do të jetë kryeprokurori i shtetit. Domethënë, është çështje që duhet ta diskutojmë dhe t'ia japim, natyrisht kompetencat dhe përgjegjësitë Këshillit Prokurorial, sepse është organ i cili do të vendosë për menaxhimin, pa i përjashtuar edhe të drejtat dhe kompetencat të cilat i takojnë kryeprokurorit të shtetit.

Çështja e dytë dhe shumë me interes, a duhet që anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës të jenë me mandat, siç e keni paraparë, gjithsesi mandati po 5 vjeçar, por a duhet të jenë me mandat të përhershëm apo të përkohshëm? Përderisa, anëtarët e Këshillit Gjyqësor janë të përhershëm, edhe kryesuesi dhe disa nga anëtarët, zëvendëskryesuesi, këtu është paraparë që vetëm në takime të caktuara dhe jo të përhershme. Dhe tash shtrohet dilema: a do të ketë mundësi që Këshilli Prokurorial i Kosovës, i cili do të ketë 100 prokurorë, përafërsisht, ta kryejë mandatin vetëm në takime të përkohshme? Kjo është dilemë në vete, që është shqetësim edhe i bashkësisë ndërkombëtare, në takimet që i kemi pasur, por edhe i yni, sepse për herë të parë po e themelojmë këshillin, dhe po e themelojmë vetëm në takimet të përkohshme. Bile është edhe një çështje shumë me interes, përderisa Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka komplet sekretariatit, me një numër shumë të madh të punonjësve që punojnë, udhëheqin edhe buxhetin edhe menaxhojnë me administratorët, menaxhojnë me punët e gjykatave, Këshilli Prokurorial do të ketë mbështetje Zyren e Prokurorit. Këtu duhet ata mendojmë, a do të jetë efikas, si mundet Zyra e Prokurorit ta mbështetë një këshill, i cili për çdo ditë do të merret me masat disiplinore, me shkarkime, emërimë, shpallje publike, me buxhetin e Këshillit dhe buxhetin për të gjithë prokurorët që do të angazhohen, a do të ketë mundësi të mbështetet nga një zyre e prokurorit. Mbetet çështje shumë që duhet diskutuar.

Dhe, mandej vetëm në fund, pa u ndalur te disa nene përkatëse që ndoshta do të duhej shikuar më me kujdes. Kush menaxhon me buxhetin? Përderisa për Këshillin Gjyqësor e kanë sekretariatit, i cili e ka Departamentin e Buxhetit, kush do të menaxhojë me buxhetin, nuk është shumë e qartë? Zyra e Prokurorit ndoshta është e pamundur të menaxhojë me buxhetin, sepse fundi i fundit, në Prokurorinë e shtetit nuk ka ekspertë të cilët janë të punësuar të punojnë për Departamentin e Prokurimit, të Financave e kështu me radhë.

Tani do të ndalem vetëm te disa nene përkatëse, për shembull pa nevojë po i ngarkojmë ligjet, nuk kemi nevojë. Unë me qëllim po i them që ndoshta të tjerët mos t'i përsërisin. Për shembull, paragrafi 1,2 flet për qëllimin dhe për transparencën që duhet ta kenë anëtarët e Këshillit Prokurorial, por më vonë neni 3 e përsërit, për shembull pavarësia e Këshillit. Është komplet përsëritje, është panevojshme.

Po ndalem me qëllim te neni 5.3 ku flet te kompetencat apo përbërja dhe këtu është për ndryshim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, këtu përbërja ka shkuar shumë me rregull, sepse është përcaktuar cili institucion do t'i dërgojë njerëzit dhe si kanë për të ardhur deri te propozimi? Por për çudi, nëse e shihni, në paragrafin 3.3, thotë: një përfaqësues nga shoqëria civile, që merret me çështje të drejtave të viktimave dhe mandej në neni 6, nëse e lexoni në paragrafin 1.5, thotë: Personi që mban post apo ushtron çfarëdo detyre në ndonjë parti politike apo në ndonjë shoqatë apo fondacion që është e lidhur me cilindo parti politike, me përjashtim të ministrit të Drejtësisë, nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë. Kjo po bie ndesh, së pari është shumë e paqartë kush, cili përfaqësues nga Shoqëria Civile, që ka të bëjë me çështjen e viktimave dhe neni 6, mandej ia ndalon të jetë në shoqatë, në fondacion e kështu me radhë.

Mandej neni 12, në paragrafin 3.2, që flet për transparencën. Nuk desha me e përmendur te Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Më së tepërmi organet e drejtësisë po atakohen për jo transparencë.

Këtu me njëfarë mënyre jepet mundësia, thotë: të gjitha takimet e Këshillit janë të hapura për publikun, përjashtimisht thotë në rastet kur diskutohet një sekret shtetëror zyrtar, zbulimi i të cilës do të përbente shkelje të ligjit. Është krejt në rregull, por mandej vazhdohet me 3.2, 3.3, 3.4 që nuk ka kuptim më. Thotë: çështjet e personelit që kanë të bëjnë me prokurori, me prokurorin apo punonjësin, përveç takimit të Këshillit kur merret ndonjë vendim përfundimtar disiplinor. Pse të mos bëhet publike, kur pikërisht kjo duhet bërë publike për çka po shkarkohet prokurori? Apo, mandej vlerësimi i performancës të prokurorëve, pse të jetë sekret? Pra, duhet të jetë shumë publike për qytetarët e Kosovës, çfarë performancë po vlerëson Këshilli me rastin e vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe nuk e konsideroj, nëse këto duhej ekzistuar, atëherë çka po bëjnë transparente për punën e Prokurorisë?

Dhe krejt në fund, dilema e fundit është, duhet ta mendojmë qartë, a mundet Zyra e Prokurorit publik ta mbështetë komplet sekretarinë e Këshillit Prokurorial, duke pasur parasysh që situatën aktuale që e kemi në Prokurorinë e shtetit, ne e dimë që shumica e prokurorëve, por edhe e kryeprokurorëve nuk kanë as asistente administrative për t'iu ndihmuar, ndoshta vetëm për t'i protokolluar çështjet. Për këtë ndoshta Ministria e Drejtësisë në të ardhmen duhet të mendojë edhe për buxhetin, sepse ne mund ta parashohim tani, ndoshta kështu si është, por së shpejti, në vitin 2011, projektligji duhet të hyjë në fuqi, me të gjitha nenet dhe nuk e besoj që ne do të jemi shumë të gatshëm që me 2011 të krijojmë gjithë sekretariatin. Më mirë ndoshta është të mendojmë se Këshilli apo sekretariati i Këshillit Gjyqësor, për një kohë të caktuar ta mbështetë edhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, sepse ka njerëz të mjaftueshëm në të njëjtin vend, nga të njëjtit njerëz, pastaj derisa të krijohen rrethanat që të krijohet një sekretariat i pavarur për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Këto do të ishin disa nga vërejtjet, unë besoj që në Komision funksional edhe me ndihmën e debatit që do të dalë nga kjo seancë plenare....

KRYESUESI: Ju faleminderit zoti deputet! Këtu po e ndërpresim për shkak se Kryesia e Kuvendit ka një mbledhje në orën 13:00 dhe vazhdojmë pastaj me shefat e grupeve parlamentare, ndërkaq deri në orën 14:30 ka pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

(Mungon incizimi elektronik i një fajli)

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Adem Hajdaraj e ka fjalën.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryesues,

Deputetë të nderuar,

Edhe grupi ynë parlamentar, domethënë LDK-ja, e ka shqyrtuar këtë projektligj, Projektligjin, domethënë, për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe grupi ynë parlamentar mendon se është ndër ligjet e mira të punuara deri më sot. Domethënë, në grupin e këtyre ligjeve, duke pasur parasysh edhe prokurorin e shtetit se e kemi lexuar, por tjetërkush do ta ketë fjalën.

Ky projektligj është ndër projektligjet e mira dhe, edhe në grupin, në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, anëtar i të cilit jam edhe unë, e kemi shqyrtuar dhe kemi konstatuar se është ligj i mirë dhe duhet të procedohet më tej. Ligji është strukturuar mirë, domethënë, të gjitha pjesët, ka ndonjë lëshim teknik aty-këtu që nuk ka nevojë, tash se për arsye se do t'i shohim edhe në komision edhe në shqyrtimet e mëtejme, ku do të japim kontributin tonë edhe ne si Lidhje Demokratike e Kosovës. Ne mendojmë se të gjitha pjesët strukturore në 14 nene, janë dhënë drejt dhe pjesët, dispozitat e

përgjithshme, përkufizimet për të cilat mendojmë se duhet të jenë në pjesën e fundit, atje, jo gjithmonë në fillim dhe ndonjëherë të tepruara...këshill e tjera e tjera, që i thanë edhe deputetët e mëparshëm e rëndojnë, përndryshe detyrat, kompetencat dhe përkufizimet e Këshillit, janë dhënë mirë dhe ne mendojmë se ky projektligj i ka plotësuar kushtet që në leximin e parë të kalojë dhe ne do ta përkrahim, por si thashë edhe më parë, e kemi të drejtën që më tej të japim kontributin tonë, qoftë nëpërmes komisioneve, qoftë në forma tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi ynë e ka lexuar projektligjin dhe fillimisht dua të them se e mirëpresim formimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Është një punë e mirë që po bëhet me formimin e këtij këshilli dhe do të ndihmojë cilësinë e punës që do të bëhet nëpër prokurori, duke bërë një përzgjedhje të mirë në këtë drejtim.

Çështja e dytë që duhet të theksoj, është që projektligji ka disa mangësi serioze, mund të them, por të cilat mund të rregullohen në punën e Komisionit. Po përmend shkarazi nenet: 5, 6, 11, 12 e tjera, kur duhet të ndërhyjmë me amendamentim. Po ashtu, bashkë me dy projektligjet tjera që po i shqyrtojmë sot, Komisioni besoj se do të organizojë debat publik, diskutim publik dhe do të marrim edhe opinionin e ekspertëve të fushave të ndryshme në procesin e amendamentimit. Ne do ta përkrahim në parim dhe deputetët tanë do të angazhohen në komisione. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Zotëri zëvendëskryeministër,

Ministër i nderuar, Demolli,

Deputetë të nderuar,

Grupi Kuvendor i AKR-së e miraton këtë dokument, madje e quan më mirë të përgatitur se sa atë të mëparshmin që i referohej Këshilli Gjyqësor të Kosovës. Do të thotë, e ka tekstin më cilësor, kështu në shikimin e parë ishte dashur disa rekomandime, disa referenca parimore. Bie fjala në preambulë që të apelohej edhe në nenin 110 të Kushtetutës, sepse me të përcaktohet bazamenti edhe koncepti i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ne nenin 3, konsiderojmë se është e pavend kjo fjala tërësisht, ku thuhet: “Këshilli është një institucion tërësisht i pavarur, kur çdokush e di edhe vëmë në degë se nuk mund të jetë tërësisht i pavarur, jo këshilli, por ky Kuvend që është organi më i lartë i një shteti. Do të thotë, mjafton të themi i pavarur, bile pikëpyetje e madhe sa do të jetë i pavarur sot, nesër, edhe dje edhe pasnesër, jo vetëm në vendin tonë, por kudo qoftë se janë pleonazma disi, domethënë, kanë konotacion edhe irritues. Ka shumë këso vërejtjesh, por vetëm një e jep, te neni 4. E bëj një komparacion në tri gjuhët. Këtu thuhet në gjuhën shqipe: “detyrat” që nuk janë detyrat, por këto janë “detyrimet”, kompetencat dhe kufizimet e Këshillit. Nuk është në paralele kuptimi i njëjtë. Në anglisht nuk thuhet “competencies” por thuhet: “jurisdiction”, kjo është ose në serbisht “dužnosti i odgovornosti” këtu jo “odgovornosti” por “ovlašćenja”. Teksti në tri gjuhët nuk është në koherencë, ka shumë këso divergjenca materiale, jo formale.

Te neni 4, këto janë vërejtje parimore, ju lutem se nuk është konsistenca. Kur jepet po e zëmë definicioni për planin e Ahtisarit, thuhet Propozimi, ndërsa te neni 4, paragrafi 1, alineja 3 e quan Marrëveshja Gjithëpërfshirëse, do të thotë, nuk ka koherencë edhe nuk ka konsistencë. Herë përdoret propozim, herë plan, herë marrëveshje. Gjithsesi duhet të quhet propozim se propozim ishte edhe ka ngelur.

Te neni 5, paragrafi 2, alineja 1, këtu thuhet kryeprokurori i shtetit, ama neni 110, paragrafi i parë i Kushtetutës nuk e njih kryeprokurorin e shtetit, por e njih prokurorin e shtetit. Tash ta meditojmë pak në fazën e mëtejshme, a thua a ta fabrikojmë këtë emërtim apo ta lëmë? Unë konsideroj që mjafton të themi ashtu siç është në Kushtetutë: prokurori i shtetit. Natyrisht ai është kryeprokurori i shtetit, por prokurori i shtetit. Jo, jo prokurori i shtetit është, neni 5, paragrafi 2, alineja 1, thotë: “kryeprokurori i shtetit”.

Te paragrafi 3, alineja 2, ia çka thotë: “Këshilli përbëhet nga një profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës, sipas propozimit të Departamentit për Arsim të Lartë. Ku është ky departament i arsimit të lartë apo i arsimimit të lartë, a ekziston? Do të thotë, a paska athua departamenti far autorizimi që ta bëjë këtë propozim? Eventualisht Universiteti ose Ministria, kështu, apo bile thotë: “apo autoritet relevant që lidhet me arsim të lartë”. Qysh atëherë po i bie kjo punë, kush është ajo autoritet relevant që lidhet me arsimimin e lartë? T’u shmangemi këtyre shprehjeve se në praktikë mund të paraqiten probleme, më pastaj mund të thotë ndonjë koleg universitar, ne jemi autoriteti relevant dhe ta propozon dike, pastaj bie në hall, ec e refuzo, ec e pranoje.

Te neni 10, paragrafi 2, anëtarët e Këshillit nuk gëzojnë imunitet nga paragrafi i dhe munden të shkarkohen nga detyra nëse këta kanë kryer shkelje të vullnetshme të ligjit. E tha një koleg më parë me vend, më së pari nuk duhet të jetë, kudo teksti duhet të jetë në njëjës e jo në shumës se, nëse themi këta, atëherë për individin nuk vlen, a nëse themi kur nisem nga njëjës edhe është praktikë se nisem nga njëjës. Ligji mund të shkelet edhe me veprimet doloze edhe me culpoze, culpa, culpa levis, culpa levisimo, dollus, mollus, dollus, metus, domethënë, me dashje, pa dashje se mund ta vrasë primusi sekundesin e thotë jo, jo, unë me vullnet s’ e kam vra, eh mirë atëherë lirohesh, e ke imunitet. Domethënë, këto janë defekte elementare të njohurive të Fillesë të së Drejtës të atyre që e kanë hartuar këtë dispozitë.

Te neni 25, ka këso shprehje të rënda që s’ ka nevojë, inicimi i procedurës, nisja e procedurës ose te neni 27, paragrafi 2, Komisioni disiplinor shqipton. Nuk shqipton, shqiptimi është, bëhet në shkollën fillore, kështu shqipto, mos e shqipto kështu, aksenti, theksi këtu, atje. Këtu është fjala, “cakton”, ju lutem e jo “shqipton”.

Edhe përfundimisht te neni 31, ju lutem: Bazuar në veprimet e Komisionit disiplinor, Këshilli shqyrton dhe vendos cilëndo ankesë brenda tre muajsh nga data e parashtrimit të ankesës. Është rregull që ankesat si mjete juridike të rregullta, të instancës së parë, të shqyrtohen sa më parë që është e mundur, e është mundur kurdoherë brenda 15 ditëve. Vetëm në gjendje lufte mund të ndodhë që nuk është e mundur se në gjendjen e rregullt të funksionimit të këtij këshilli apo cilido institucion, mundet edhe brenda 8 ditëve e jo brenda 3 muaj ditëve se pastaj jep komoditete që e shtyhen edhe tre muaj tjera edhe të paraqiten probleme në praktikë, probleme konkrete.

Edhe përfundimisht, neni 42, përbërja fillestare e Këshillit. Asgjë s’ ka përfundimtare. Nuk ka nevojë të thuhet përbërja fillestare, përbërja e Këshillit. Përdërisa do të ekzistojë ky ligj që do ta

miratojmë dikur, për aq do të jetë kjo përbërje, kur ndryshohet ligji, natyrisht se do të mund të ndryshojë edhe struktura e Këshillit.

Te neni 43, kjo shprehje është përdorur varg e vi dhe nuk përkon me natyrën e akteve juridike. Me themelimin Këshillit Prokurorial të Kosovës, siç ceket me këtë ligj, por në mënyrë ne përcaktuar me këtë ligj apo ndryshe ama kurrësi siç ceket. Këto janë disa vërejtje të karakterit parimor dhe ne e mbështesim në këtë etapë, do të përpiqemi që në vazhdimin e procedimit të japim kontribut pak a shumë më konkret. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh se deri me tani kjo fushë e veprimit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ka qenë e rregulluar me Rregulloren të UNMIK-ut, ka qenë e domosdoshme që të bëhet një ligj, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Unë mendoj që kjo është dashur të bëhet më herët, por më mirë vonë se kurrë. Nëse dikush e lexon këtë ligj dhe ne e kemi lexuar, shihet se ky ligj është i punuar më mirë se Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e mbështet në parim këtë projektligj. Ne vërejtjet tona do t'i japim me kohë gjatë amendamentit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, unë e kam të paraqitur deputetin Enis Kervan, por fjalën e ka Mufera Shinik.

Müfera Şinik,

Teşekkür ederim,

Kosova Cumhuriyeti Savcılık Konseyi'ne ait Yasa Tasarısı, özetinden de anlaşıldığına göre bu Yasa Tasarısının da hedefi, Kosova Savcılık Yasamasının bütünleşmesi, savcılık ile ilgili konuların daha ayan olarak düzenlenmesine yönelik çabaların sarfedilmesi, önceki düzenlemelerle planlaştırılmamış bazı konuların ele alınması, bunların gerçek duruma uyarlanması ve bu yasa sayesinde Avrupa yasaları standartları ile uyumlaştırılmasıdır. Yargı Konseyine ait Yasa Tasarısı dahil olmak üzere bu tasarı açısından da genellikle tümümüz aynı veya benzer olduklarını görmekteyiz.

Birinci maddenin 3. fıkrasında ayrımcılığa karşı bir çeşit garantinin sağlanmış olduğu görülüyor, çünkü devlet savcısının Kosovanın multietnik özelliğini yansıtmakta olduğunu ifade ediyor, ancak bu fıkra devlet savcısı mı yoksa savcılık konseyinden mi söz edildiğinden pek ayan değildir. Bunun ayan bir şekilde belirtilmesi gerektiğini görmekteyiz. 17. maddenin 3. fıkrasında adayların seçimi, savcılık dairesinin yetkileri, geçerli olan alanlarda etnik yapının oluşumunu yansıtmaları gerektiğini belli eden geniş bir hüküm yer almaktadır. Ancak işyerlerinin kalitesi açısından bir garantinin varlığı belirtilmemiştir. Örneğin, çoğunlukta olmayan toplulukların gerçekten kaliteli kadro olarak mı takdim edileceklerini, yoksa sadece yardımcı eleman olarak mı yer alacaklarını belirtilmemiştir. Çünkü pratikte çoğunlukta olmayan topluluklara mensup kişilerin bulundukları işyerlerinin çeşitliliği önemsenmeden, sadece temsile edildikleri yüzdeliğe önem verilmektedir. Bu hüküm ayrımcılıktan koruma mekanizmasının özelliğini yansıtmayacak kadar geniş ve uzun bir şekilde tanımlanmıştır.

Bütün bu uyarılarla birlikte 7+ Parlamenter Grubu bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul etmektedir ve ikinci okunuşuna kadar katkılarımızı komisyonlarda sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, fjalën e ka deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Gospodo ministri,

Gospodine zamenice premijera,

Dame i gospodo,

Parlamentarna grupa SLS se pridružuje svima onima koji su u načelu, i koji će u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Smatramo da je sveobuhvatan i sa zadovoljstvom možemo da konstatujemo da postoji napredak u pisanju teksta samog, jer je mnogo precizniji i jasniji. Naravno, mi ćemo dati svoj doprinos u radu parlamentarnih komisija u smislu poboljšanja u nekim elementima koji se tiču zaštite manjinskih zajednica, naročito se slažemo sa stavom Parlamentarne grupe „7+“. Još jednom, hvala! Mi ćemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa ponovo na datu reč!

Kada je u pitanju Zakon o tužilačkom savetu Kosova, mi se isto slažemo sa prethodnim govornicima. Imamo jednu primedbu, nećemo da ponavljamo članove koje podržala grupa „7+“ i SLS, za koje smo isto veliko interesovanje pokazali mi sami, ali kada je u pitanju sastav ovog Tužilačkog gaveta, multi etnički sastav, mi imamo jednu, pošto se ovaj zakon donosi na osnovu člana 65. Ustava Republike Kosova, i u ovom članu 65. normalno traži se sastav multietničkog karaktera shih, da kažem, institucija na Kosovu, a mi znamo da se ovim zakonima koji danas imamo pred sobom, u stvari formiraju najveći institucionalni subjekti u državi Kosova. Hoćemo konkretno, imamo predlog na član 5. kao što smo prethodno imali isto tako, Kada je sastav i izbor članova Saveta tužilaštva, gde savet ima 9 članova, koji su, kaže, državljani Republike Kosovo, od kojih 5. moraju biti tužioci, opet neću da zamaram kolege, da su to članovi na Saveznom nivou, da su to 1 član Apelacionog suda, i da je 1 tužilac iz Kancelarije, ustvari dva tužioca iz osnovnog tužilaštva, znači iz lokalnog suda, a od 5 kandidata, imamo 9, znači ne samo 9 članova, gde su 5 sudije, gde tražimo, imaćemo predlog kao grupa da to bude jedan od sudija iz..., tužioci iz manjinskih zajednica i da u stavu 4. gde je 9. članova, isto bude jedan predstavnik zajednica. Zašto kažem oho? Zato što je Srpska zajednica i ostale zajednice uvek moraju da imaju po jednog člana. Znači, od 9. minus 2, koji bi bili članovi iz zajednica, iz Srpske i ostale zajednice.

Moram da se vratim na član 4. dužnosti i odgovornosti i ograničenja saveta, neću da čitam konkretno sve, ali kada je u pitanju stav 1. i 2. regrutovanje i predlaganje, predsedniku, znači, kandidata za imenovanje i ponovni izbor za Kancelariju tužilaštva, uključuju se i kandidati iz redova zajednica, koje ne čine većinu na Kosovu. Posebnu pažnju hoću da dam funkcionalnoj komisiji, gde ćemo da damo i konkretan predlog, kada su u pitanju opštine, kao posebna pažnja da se vodi kada su u pitanju opštine Prizren i Dragaš, gde je govorno područje, da kažem, više jezika, kao što je: turski, srpski, bošnjački i tako dalje i da tužioci budu pristupačni i na govornom području u sudovima gde je velika prisutnost pripadnika manjinskih zajednica, koji dobijaju, ja moramo da kažem, žao mi je, presude i tužbe i sve na albanskom jeziku, tako da su ljudi ograničeni u

razumevanju, da su prinudeni na prevode, da se izlažu troškovima, tako da po Ustavu znamo da je obaveza na albanskom i srpskom i da se to po sudovima poštuje, i od 100 kandidata za izbor ovih tužilaštva, u tužilaštva pripadnika saveta za tužilaštvo, obavezno da najmanje 10. - 15. kandidata budu iz ostalih zajednica. Toliko od naše grupe. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Vazhdojmë me deputetët e paraqitur për diskutim. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni- Kaloshi.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për Këshillin Prokurorial është gjithashtu një pjesë e reformës së sistemit të drejtësisë dhe si të tillë e konsideroj shumë të rëndësishëm që të shqyrtohet me seriozitet të mjaftueshëm. Nevoja, pra, për një projektligj të tillë është evidente. Po ashtu, është e rëndësishme që rolin kryesor të cilin e luan në këtë projektligj, pra Këshilli Prokurorial, të jetë po aq funksional dhe efektiv dhe të funksionojë në mënyrë të paanshme dhe profesionale dhe i pavarur në atë mënyrë që të sigurojë edhe vetë funksionimin efikas të udhëheqjes së pushtetit prokurorial.

Rregullorja aktuale e UNMIK-ut, 2005/52, nuk i plotëson nevojat e tanishme të Kosovës, prandaj edhe ndërtimi i një baze ligjore ose infrastrukture ligjore, e cila do të ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare, është e nevojshme. Me këtë projektligj përcaktohen edhe procedurat e rekrutimit: përbërja, struktura, organizimi, emërimi, riemërimet, transferimet dhe disiplinimi i prokurorëve. Me qenë se Këshilli Prokurorial ka një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e sistemit prokurorial, atëherë është me rëndësi dhe kisha dashur nga ministri të dëgjoj pse është ofruar një zgjidhje e tij, sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me nenin 4 dhe 5 kur nuk ka një ndarje të qartë të kompetencave që kanë të bëjnë me prokurorin e shtetit dhe Këshillin Prokurorial. Prandaj propozimi im është lidhur me vërejtjen e projektligjit që kjo të qartësohet mirë. Dhe një çështje tjetër që kisha dashur ta shtroj është, zoti ministër, sa i përket menaxhimit të buxhetit. Sipas këtij projektligji, thuhet se buxhetin vjetor e bëjnë që të dy edhe këshilli edhe kryeprokurori i shtetit edhe në aspektin e vet planifikimit të tij, por edhe mbikëqyrjes, shpenzimeve të alokimit dhe të kryerjes së auditiveve financiare.

Sipas mendimit tim për ta ruajtur pavarësinë e vet, sidomos Këshilli Prokurorial, duhet vetë ta menaxhojë buxhetin dhe të mos ketë në këtë mënyrë një përzjerje të kryeprokurorit të shtetit. Një risi në këtë projektligj që gjithashtu e konsideroj të rëndësishme është se krijohet Njësia e Inspeksionit dhe Auditimit Prokurorial, që është përgjegjëse për hetimin dhe vlerësimin e sjelljeve të pahijshme të prokurorëve në Republikën e Kosovës. Sa i përket, një vërejtje të fundit e kam lidhur me nenin 4. pika 1.11, që ka të bëjë me raportimin te Kuvendi i Kosovës.

Konsideroj se duhet të definohet se kur duhet të bëhet ky raportim dhe propozoj që raportimi të kryhet në Kuvend ose në komisionin përkatës parlamentar, siç është Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, së paku një herë në gjashtë muaj ose sa herë që të kërkojë komisioni. Duhet definuar se çka duhet të përmbajë ky raportin, pra duhet të përmbajë të dhëna dhe sqarime për numrin, llojin, intensitetin, format e kriminalitetit, drejtimit dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit, kurse raporti nuk duhet të ketë të dhëna për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara në vendim të Kuvendit.

Prokurori i shtetit, në këtë aspekt gjithashtu, gjegjësisht Këshilli Prokurorial bashkëpunon me Komisionin për hetimin parlamentar sipas Ligjit për hetimin parlamentar. Për shkak të rëndësisë që kanë reformat në sistemin e drejtësisë dhe të vetë të këtij projektligji, në parim e përkrah.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete.

Fjalën e ka deputeti i fundit, i paraqitur për diskutim, Hydajet Hyseni- Kaloshi.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

E përshëndes edhe këtë projektligj dhe e konsideroj si hap pozitiv që ai sillet dhe besoj se edhe do të miratohet. Por, besoj se edhe në procedurën e mëtejshme do të përmirësohet dhe unë dua në mënyrë të përgjithësuar të theksoj se vërejtjet që u bënë në projektligjin e mëparshëm në masën më të madhe mund t'i bëhen edhe këtij projektligji dhe për të kursyer edhe kohën e deputetëve, unë do t'i kalojë ato. Megjithatë, nuk mund të mos ndalem në nenin 6 të këtij ligji dhe në nenin 19 të ligjit tjetër për prokurorin e shtetit, të cilat kanë dispozita për mua problematike dhe përjashtuese edhe për kategori të tjera, siç është për shembull ajo për zyrtarët e administratës, për deputetët e tjerë, por kësaj radhe dua ta vë tekstin përsëri të çështja e të dënuarve në mënyrë të përgjithësuar, duke përjashtuar vetëm ata që janë dënuar për kundërvajtje dhe nuk do të kërkoj falje që e përsëris këtë dhe do ta përsëris derisa të korrigjohet kjo praktikë në legjislacionin tonë.

Edhe ky ligj përjashton në një mënyrë masën e madhe të veprimtarëve politikë të dënuar në të kaluarën me vepra të qena ose të paqena, por që nuk kanë qenë dhe nuk janë të dënueshme. Është koha që kjo çështje të korrigjohet, veçanërisht në fushën e prokurorisë dhe për të evituar situata si ajo që unë e kam theksuar këtu dhe përsëri dua ta përsëris.

Zijadin Spahiu, një i dënuar në vitin 1974, për vepër penale të paqenë, pa asnjë fakt, propagandë armiqësore dhe bashkim për veprimtari armiqësore, me nja dhjetëra të tjerë për vepra që nuk i ka kryer, siç është dëshmuar më vonë, nga prokurorë e gjykatës që kanë qenë të informuar se e vërteta është se ata po dënoheshin pa fakte dhe për të cilat ata i kanë mbajtur shumë vite burg. Më vonë, të njëjtët prokurorë e gjykatës kanë dënuar një grup tjetër veprimtarësh për të njëjta vepra dhe për të qenë ironia më e madhe, kanë qenë krejt indiferent ndaj fatit të grupit të mëparshëm të dënuar për të njëjtën vepër, dhe së paku kaq do të duhej të dinte edhe gjykatësi i sistemeve më totalitare që për një vepër s' mund të dënoheshin dy grupe veprimtarësh. Dhe të njëjtit pas luftës e pamundësojnë atë dhe shumë të tjerë si ai që të bëhet pjesë e prokurorisë edhe pse i plotëson të gjitha kushtet formale-juridike, në pretekstin ke qenë i dënuar, në biografinë tënde ka vepër penale, dhe në pyetjen e tij, por ju më keni dënuar dhe më keni dënuar pa të drejtë, përgjigja e drejtuesit të atëhershëm të Këshillit Gjyqësor ishte: e dimë, e vërtetë është, e dhimbshme, por ka qenë koha. Po thotë: prapë më dënoni ju me këtë. Edhe kjo e vërtetë po s'varet prej nesh. Atëherë edhe mund të kuptohet, a mund të kuptohet, zonja e zotërinj edhe sot ky formulim, vërtet absurd? Hiqeni këtë dispozitë, ju lutem, hiqeni dhe gjeni në formën që e keni propozuar disa herë.

Për shembull, duke përjashtuar veprat penale, politike të periudhës të represionit e tjera, duke përjashtuar veprat që nuk janë të dënueshme me legjislacionin tonë sot, sepse ka edhe vepra që në vendet diktatoriale sot janë të dënueshme dhe dikush mund të dënohet pse e ka pirë një gotë raki diku, por nuk është e dënueshme në legjislacionin tonë, prandaj edhe nuk mund një dispozitë e tillë kështu siç është.

Çështja e dytë është, që dua ta ngre, është edhe çështja e riemërimit që është theksuar këtu dhe lidhet kjo edhe me fenomenin që e thashë pak më parë. Kosovës i duhet vazhdimësia dhe është mirë që shfrytëzohet potenciali dhe i mëparshëm, por, Kosovës i duhet edhe transformimi edhe reforma,

i duhet edhe ndërrimi i mendësisë dhe është zor të sigurohet kjo, duke restauruar strukturën e mëparshme në sistemin e drejtësisë. Prandaj, mendoj që do të duhej rishikuar edhe një herë atë procesin e riemërimit, verifikimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë dhe të evitohet ajo që ndodhi në sistemin tonë. Fillimisht kundërshtoj me të gjitha forcat, më vonë nisi të bëhet sa për sy e faqe që njeri ta pastrojë tjetrin dhe mendoj kjo duhet ta nënvizoj nuk mund të bëhet pa marrë parasysh edhe mendimin e viktimave të ish sistemit të padrejtë juridik, pa i parë edhe dëshmitë e tyre.

Natyrisht, unë jam i bindur se kjo nuk do të thotë ndjekje shtrigash as nuk do të thotë përjashtim e pamundësim të kuadrove që janë të dobishëm. Nuk do të thotë që të mos merren parasysh edhe kontributi i tyre në ndërkohë e tjera dhe këtë e kanë dëshmuar njerëzit tanë, por restaurimi i plotë pothuajse i ish- nomenklaturës në këtë sistem edhe përjashtimi i viktimave të tyre, përjashtimi di disidentëve edhe në fushën e gjyqësisë, siç ka ndodhur edhe për fat të keq, ndodhi edhe në procesin e emërimit. Gjyqtarët që kanë qenë shembullor dhe të dëshmuar në të gjitha kohët për qëndresë dhe dinjitet e profesionalizëm, tani mbeten jashtë procesit të regrutimit. Kolegu ynë e theksoi edhe një shembull se si është përjashtuar vetëm pse i ka takuar, si të thuash brezit të 68-ës dhe ju e dini sa janë juristë të tillë që sot enden rrugëve me një kapital të pallogaritshëm politik e profesional juridik, por pa mundësi që të gjejnë vendi në sistemin e drejtësisë. Është koha që ta korrigjojmë edhe këtë.

Dhe vërejtja e fundit, dispozitat kalimtare më dalin të ngatërruara kështu siç janë. Janë dy-tri dispozita që hynë në fuqi sipas Kushtetutës, nenit 80 atje, pika 6 dhe që kanë të bëjnë me këto ndryshime që janë bërë në Raportin Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial dhe kanë të bëjnë me pagat e tjera, por pjesa më e madhe e ligjeve hyn në fuqi siç mund ta vëren i tek në vitin 2013. Nuk di sa do të harmonizohet, sepse ligji që do ta kemi në shqyrtim më vonë, i referohet këtij ligji dhe më del pak edhe si një lojë që bëhet.

Zonja e zotërinj,

Ne duhet ta shtrojmë më në fund edhe raportin e sistemit tonë të drejtësisë me misionin ndërkombëtar të Eulex-it në Kosovë. Ai mision nuk është në Kosovë për t'i zëvendësuar institucionet tona dhe sidomos jo për t'i përjashtuar ato, por siç është thënë, për t'i observuar, për t'i monitoruar, për t'i mbështetur, por jo edhe për t'i përjashtuar, jo për t'i zëvendësuar, kurse në fakt në sistemin tonë të drejtësisë, kjo farë gjendje me dy kokë po e pengon sundimin e të drejtës dhe të ligjit.

Prandaj, mendoj që do të duhej shtruar kjo çështje edhe për të evituar situata absurde si ajo që e kishim para sa kohësh me lojën me Albin Kurtin dhe lojën pastaj edhe me aktakuzat dhe heqjen e aktakuzave sipas nevojës së ditës dhe në fund kurdisjen, që pikërisht në ditën kur ata vendosnin të dalin në skenën legale politike, t'i hiqen si thuash akuzat që e fajësonin dhe t'i mbetet një vetëm për pengim personit zyrtar dhe kjo të mjaftojë pastaj për ta legjitimuar një dënim absurd përpara dhe për ta dënuar për mospjesëmarrjen në skenën politike, që është një absurd që nuk i bën nderë sistemit tonë të drejtësisë, as miqve tanë, të cilët i gomojmë, i falënderojmë, por nuk na e sjellin në këtë mënyrë modelin që na duhet, modelin e funksionimit evropian, modern në fushën e drejtësisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka kërkuar ministri, e keni fjalën, zoti ministër!

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar, zotëri kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Përkundër shqetësimeve tuaja, deputetë të nderuar, lidhur me çështjet teknike, gramatikore, gjuhësore dhe vërejtjet tjera që ishin edhe të natyrës përmbajtjesore, siç ishin ato të koleges Gjylnaze, e të cilat besoj se do të kenë mundësi të evitohen gjatë punës në procedurën e mëtutjeshme, unë, duke pasur parasysh se ky projektligj është një hap vendimtar në themelimin e sistemit të Prokurorisë të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial në përgjithësi, një hap vendimtar në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të drejtësisë përmes koordinimit, sigurimit të udhëheqjes, të drejtimit shumë të nevojshëm për sistemin e Prokurorisë, zbatimit të modernizimit të nevojshëm, krijimit të një kornize të shëndoshë për regrutimin, përzgjedhjen dhe disiplinimin e prokurorëve dhe krijimin e një sistemi efektiv administrativ dhe mbikëqyrës për sistemin e Prokurorisë, kërkoj prej jush që ta aprovoni në parim këtë projektligj, në mënyrë që të procedohet më tutje për aprovim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Meqë nuk kemi më diskutime, ju ftoj që të kalojmë në fazën e votimit në parim të dy projektligjeve: Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Në sallë janë prezentë 73 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, thashë, të Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Votojmë, tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 4 abstenime dhe 2 “kundër”, aprovohet në parim Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë me votimin e Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, 5 abstenime, Kuvendi e miratoi, në parim, Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorin e shtetit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores të Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zoti Haki Demolli, që në emër të Qeverisë, ta prezantoj projektligjin.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar, zoti kryesues i Kuvendit,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas dy projektligjeve paraprake, sot Kuvendit të Republikës së Kosovës, në emër të Ministrisë së Drejtësisë do t'ia paraqes për miratimin edhe Projektligjin për prokurorinë e shtetit. Me këtë projektligj, në një formë do të rrumbullakohet apo më mirë të them kompletohet infrastruktura ligjore mbi sistemin gjyqësor të Kosovës. Me këtë projektligj, në radhë të parë do të bëhet riorganizimi i sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe do të përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë për secilin nivel të prokurorive.

Përpilimi, respektivisht aprovimi i këtij projektligji, është më se i domosdoshëm, sepse sistemi prokurorial i Kosovës, aktualisht është i rregulluar me një ligj i cili i përket një sistemi dhe organizimi tani më të kaluar. Aprovimi i këtij projektligji, është edhe më i arsyeshëm për faktin se me do të bëhet një ndërhyrje e fuqishme në përmirësimin e gjendjes ekzistuese të sistemit prokurorial, që do të ndikojë në shtimin e efikasitetit, në punën e Prokurorisë së shtetit, në përgjithësi, si dhe në ndjekjen e kryerësve të veprave penale.

Po ashtu, ky projektligj do të mundësojë funksionimin e koordinuar të prokurorive të gjitha niveleve në punën e tyre në zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit në Kosovë. Draftligji që i propozohet Kuvendit të Kosovës për aprovim i shtjellon, ndër të tjera edhe këto çështje:

- Pavarësinë e Prokurorit të shtetit dhe funksionit prokurorial,
- detyrat dhe kompetencat e prokurorëve,
- autorizimet dhe përgjegjësitë e kryeprokurorit të shtetit,
- autorizimet dhe përgjegjësitë e kryeprokurorëve dhe zyrave të prokurorisë,
- strukturën e Prokurorisë së shtetit dhe kompetencën tokësore dhe lëndore të zyrave të Prokurorisë së shtetit,
- kualifikimet dhe të drejtat e prokurorëve,
- kompensimin e prokurorëve,
- trajnimin dhe sjelljen e prokurorëve, si dhe çështje të tjera.

Të nderuar deputetë,

Ky Projektligj e riafirmon parimin për përbërjen shumë etnike dhe parimin e barazisë gjinore të Prokurorisë së shtetit, siç përcaktohet me nenin 109, pika 4 dhe neni 110, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Andaj aprovimi i këtij ligji mundëson zbatimin praktik të këtyre politikave, në përputhje me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë. Aprovimi i këtij projektligji, garanton ushtrimin e pushtetit prokurorial në Republikën e Kosovës nga prokuroritë e pavarura dhe të paanshme, që do të punojnë konform dispozitave të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera normative të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Sikurse edhe dy projektligjet e paraqitura më parë sot këtij Kuvendi, edhe ky projektligj është rezultat i punës së përbashkët të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të angazhuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim.

I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe me këtë rast do t'u rikujtoj se aprovimi i këtij projektligji, përveç tjerave, është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë, konform kërkesave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian. Andaj, propozoj që ky projektligj të miratohet në parim në Kuvend dhe kështu të mundësohet procedimi i tij për aprovim në procedurë të mëtejme.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Në emër të Komisionit funksional, fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni dhe kryetar i Komisionit.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, ka shqyrtuar me vëmendje dhe Ligjin për Prokurorinë e shtetit dhe natyrisht është e domosdoshme që pasi kemi përfunduar, tani jemi në fazën përfundimtare të Ligjit për gjykatat, i cili pritet vetëm në leximin e dytë ta kemi në Kuvend, i cili parasheh një organizim plotësisht të ri të sistemit të drejtësisë. Ka qenë e domosdoshme që së shpejti të veprojmë që ta kemi edhe Ligjin për Prokurorinë e shtetit, i cili do të organizohet në bazë të Ligjit mbi gjykatat, duke marrë parasysh që do të kemi gjykata themelore, Gjykatën e Apelit e kështu me radhë.

Natyrisht, që Komisioni jemi pajtuar dhe konsiderojmë që Projektligji për prokurorinë e shtetit shumë dallon nga projektligjet që i lexuam më parë, domethënë është i hartuar jashtëzakonisht mirë, nuk ka vërejtje as në aspektin teknik, e as në aspektin përmbajtësor dhe për çudi është që nuk përsëriten edhe ato gabime teknike dhe gjuhësore të cilat, dhe kjo po tregon që këtu kanë qenë më të involvuar zyrtarët vendorë që ta shkruajnë, sepse do ta kemi edhe ne më lehtë ta punojmë. Megjithatë, unë po përmend një dy-tre çështje të cilat do të ishte mirë për t'i bërë dallimet. Domethënë, esenca po bisedojmë për Prokurorinë e shtetit dhe jo vetëm për një çështje individuale për kryeprokurorin apo një prokuror të një gjykate aktuale. Edhe pse është harruar një e pa zë atje, por është fjala për prokurorinë e shtetit si institucion, i cili do të organizohet nëpër strukturat të ndryshme, duke filluar nga gjykatat, nga prokuroria themelore e deri te ajo e shtetit për të cilën po bisedojmë, do me thënë kjo është esenca.

Një çështje tjetër, është mirë ta përmirësojmë, sepse në nenin 13, në paragrafin 2 thotë: "secili kryeprokuror, është kreu i administrativ i Prokurorisë". Unë mendoj që nuk e di si e kanë menduar, mirëpo kryeprokurori kurrësi nuk duhet të jetë kreu administrativ, sepse edhe prokuroritë do të kenë administratorë të cilët do të menaxhojnë me çështjet administrative brenda institucioneve përkatëse dhe kurrësi nuk do të lejohet që kryeprokurori i cili do të duhej të bëjë, domethënë i ka përgjegjësitë shumë të nivelit të lartë për të ndjekur veprat penale, mandej të akuzuarit, e për shumë çështje tjera, sidomos Prokurori i shtetit për ankesat në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe domethënë për mjetet e jashtëzakonshme juridike, të merret tash edhe me çështje administrative. Ne e kuptojmë që ai duhet të ketë rol menaxhues për institucionin përkatës, por sa i përket stafit të prokurorëve të cilët punojnë, por jo ndoshta të lëshohet edhe atë nivelin administrativ. Dhe çështje tjetër, është, ne po diskutojmë edhe në këtë situatë kur po bëhet riemërimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve për institucionet në Kosovë, padyshim kanë mbetur jashtë gjykatave dhe

prokurorëve një numër i madh i njerëzve të cilët meritojnë të punojnë për institucionet në Kosovë dhe sidomos për Prokurorinë.

Nga kriteret të cilat i kemi paraparë në projektligj, do ta kemi vështirë edhe në të ardhmen që dikush nga juristët e dalluar, dikush nga ata të cilët kanë provuar, kanë përfunduar edhe provimin për gjyqtar dhe prokuror edhe provimin e jurisprudencës, të inkuadrohen për të punuar si prokurorë në të ardhmen. Po e lexoj vetëm nenin 20, paragrafin 1.1, ku kërkohet apo kur bisedohet për kriteret e veçanta për prokurorët e caktuar të shtetit. Për të shërbyer thotë si prokurorë, në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore, domethënë, janë prokurorët e shkallës së parë se nuk ka, më poshtë nuk ka ku shkon, janë do me thënë prokurorët në instancën e parë, duhet thotë kandidati të ketë së paku 3 vite përvojë juridike si prokurorë apo gjyqtar. Nëse duhet të ketë përvojë si prokuror dhe gjyqtar, nuk ka nevojë me shkrua atë juridike më dhe konsideroj që kjo nuk i jep mundësi asnjë juristi që tash i ka përfunduar provimin për gjyqtar dhe prokuror, provimin e judikaturës, qasjet me punuar në institucionet e prokurorisë. Nëse kërkohet të jetë paraprakisht për tre vite si prokuror dhe gjyqtar. Por, unë mendoj që kjo do të duhej të ishte, me tri vjet përvojë juridike, së paku ta bëjë atë nismën e parë, përndryshe nuk do t'u lejonim njerëzve të rinj që të inkuadrohen.

Unë besoj se edhe aktualisht tash e kanë këtë mundësi edhe pse është kërkuar një përvojë pak më e madhe 7 vjeçare në çështjet juridike të jetë dhe të ketë mundësinë për të punuar në prokurori.

Ne si Komision e përkrahim në parim, natyrisht që do t'i marrim edhe të gjitha rekomandimet që dalin nga seanca plenare dhe rekomandimet që vijnë në formë të amendamenteve nga deputetët dhe brenda afatit të paraparë ligjor, do të përgatisim projektligjin për leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Nga diskutimi i juaj edhe më herët i ministrit, u krijua njëfarë dileme që, lidhur me përkufizimin, neni 1 i këtij projektligji thotë se bëhet fjalë për prokurorin e shtetit dhe jo për Prokurorinë dhe është mirë që të na sqarohet kjo, sepse edhe Kushtetuta e njeh termin Prokurori i shtetit neni 109 dhe ligji i atribuohet Prokurorit të shtetit, sepse edhe në shqip neni 1 edhe në serbisht edhe në anglisht, flet për prokurorin dhe jo për prokurorinë. Prandaj, është mirë që të sqarohet, zotëri ministër, nëse e sheh të nevojshme ose... po, po.

Regjia, fjalën deputetit Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Unë e thashë që është me të vërtetë një dilemë që na ka vendosur edhe ne në situatë që mos ta kuptojmë qartë, por po i referohem nenit 34, shfuqizimi i ligjeve tjera dhe, nëse e lexoni me hyrje në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen ligjet në vijim: Ligji mbi prokurorinë publike të Krahinës, domethënë shfuqizohet Ligji mbi prokurorinë publike, që Prokuroria Publike nënkupton Prokurorinë aktuale që është për Gjykatën Themelore, për Gjykatën Komunale, Gjykatën e Qyrkut dhe Gjykatën Supreme. Asnjëherë nuk kemi mundësi si institucion tash të flasim vetëm për një prokuror, se edhe këtu kur po flasim, nëse e merrni, e shihni që organizimi i sistemit të prokurorit është i organizuar në të gjitha gjykatat, në të gjitha prokuroritë, e merrni në 7 qendrat, në Prokurorinë Themelore për shembull në Ferizaj, do të ketë, në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë dhe në Prokurorinë e shtetit. Prandaj, nuk mund të flasim për individin, por po flasim për një institucion. Unë nuk e di pse kjo, por është mirë ndoshta të na jepni sqarime. Mirëpo, nëse duhet ta shfuqizojmë Ligjin për Prokurorinë publike, atëherë po pyes unë çka bëjmë, nëse nuk duhet të mbështetemi tash në ligjet tjera, nëse është vetëm për çështje individuale për ta rregulluar. Por, unë konsideroj që e rregullon komplet strukturën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë jam i prirë t' i dëgjojë ekspertët dhe për fat të mirë, në sallë kemi shumë ekspertë. Ministri e ka fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: Ndonëse ajo çka po thotë kolegu Bahri, vërtet ka logjikë, mirëpo draftuesi i ligjit sigurisht është bazuar me rastin e draftimit në Kushtetutë. Kurse Kushtetuta në nenin 109 thotë: “Prokurori i shtetit”. Prokurori i Shtetit, është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi, çka do të thotë kalon prej individit atje në institucion, e pikërisht këtë e ka pasur për bazë me rastin e sajimit të këtij draftligji edhe pse neni në pikën e 7 atje e ka edhe kryeprokurori i Shtetit, atë që e përmendi më parë kolegu Riza. Prandaj ne duhet ta respektojmë Kushtetutën dhe ligjet e tjera të jenë në pajtim apo në harmoni me aktin kushtetues. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tash kalojmë te grupet parlamentare dhe prapë në radhë kemi një ekspert. Në emër të Grupit të PDK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Më së pari po kyçem në këtë debatin rreth emërimit të ligjit dhe mendoj se emërtimi është korrekt dhe i saktë, sepse kur themi prokurori i shtetit, nuk mendojmë në individin, por në institucionin dhe kur është shkruar Kushtetuta, është menduar që prokurori i shtetit është institucion, organ, jo individ dhe kjo nuk është vetëm një ndryshim formal, por është ndryshim konceptual i rolit të prokurorit të shtetit, për shkak se me Kodin e Procedurës Penale, prokurori ka marrë një rol krejtësisht të ri dhe do të thosha ky është një model amerikan i prokurorisë, ku prokurori nuk i ka vetëm funksionin e ndjekjes penale, por e ka komplet nën juridiksion edhe hetuesinë, që me legjislacionin e vjetër ka qenë pjesë e gjyqësorit apo e gjykatave.

Tani më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të jap një mbështetje parimore këtij ligji dhe padyshim që me këtë ligj rregullohet segmenti i dytë i Gjyqësorit, pra Prokuroria Publike, dhe është shumë i rëndësishëm që kemi një ligj, sepse ne kemi ndërruar rolin e prokurorit publike dhe pa këtë ligj, me fillimin e implementimit të Kodit të Procedurës Penale ku prokurori i shtetit, ka marrë kompetenca të reja.

Ky ligj është në pajtim me dy ligjet tjera, me të cilat është i varur. E para, me Ligjin për gjykatat e rregullta, e tha edhe ministri në prezantimin e këtij ligji, që kompetenca e Prokurorit i është përshtatur kompetencës tokësore të gjykatave dhe kemi organizimin e Prokurorisë së shtetit në tri instanca, në instancën e prokurorit themelor, atij të Apelit dhe Kryeprokurorit të shtetit dhe është shumë i rëndësishëm që të evitojnë çfarëdo kolizioni midis ligjit për gjykatat e rregullta dhe Ligjit për prokurorin e shtetit.

Megjithatë, në leximin e dytë me siguri që do të ketë nevojë për t' i sqaruar disa pozicione edhe pse ky ligj është shumë më korrekt se sa dy ligjet tjera. E para, ky ligj nuk themelon Prokurorinë e shtetit. Prokuroria e shtetit ka ekzistuar edhe pa këtë ligj, përkundrazi krijon bazën ligjore për funksionimin e prokurorit të shtetit. E dyta, në nenin 5, përdoret një nëntitull: shumëllojshmëria e Zyrës së prokurorit. Kjo na është përsëritur edhe në disa ligje dhe ka të bëjë me përfaqësimi etnik në Prokurorinë e shtetit, mendoj se nuk duhet të përdoret termi: “shumëllojshmëria e Zyrës së prokurorit”, por duhet ta ndërrojmë me termin: “përfaqësimi etnik në Zyrën e prokurorit”. I njëjti

term është përdorur edhe në disa ligje tjera dhe mendoj se ka gjuhë ndërkombëtare. Megjithatë, gjuha ligjore, gjuha juridike, duhet të jetë gjuhë vendore. Unë e kuptoj shpeshherë involvimin e ekspertëve ndërkombëtarë në hartimin e ligjit, por assesi produkti final i ligjit nuk duhet të jetë gjuhë ndërkombëtare juridike, por duhet të jetë një gjuhë vendore, sepse ky ligj do të zbatohet në Kosovë dhe komuniteti i juristëve është mirë që ta kuptojnë terminologjinë vendore, juridike.

Ligi mund të diskutohet edhe në disa segmente tjera. Për shembull, është një kaptin ku flet për trajnimin e prokurorëve. Paramendoni, kryeprokurorin e shtetit ta dërgosh në trajnim. A ka kohë ai të, unë e ti që ata duhet gjatë gjithë karrierës të aftësohen, por kryesisht trajnimi duhet të vlejë për stafin administrativ në Prokurori, për stafin tjetër, nuk duhet të jetë diçka e rregullt që të kuptohet që gjithmonë prokurorët duhet të kalojnë në trajnime. Unë e kuptoj nevojën e vazhdueshme të freskimit të njohurive, por në momentin kur dikush zgjidhet kryeprokuror i shtetit apo prokuror i Apelit apo i nivelit themelor, ata supozohet se janë të përgatitur, janë juristë ekselentë, sepse edhe kriteret shitesë për zgjedhjen e tyre janë mjaftë rigorozë dhe kërkojnë një përvojë të lartë profesionale.

Përfundimisht, grupi parlamentar e mbështet dhe angazhohet që në leximin e dytë, përmes procesit të amendamentimit ky ligj të plotësohet dhe të ndryshohet në mënyrë adekuate. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

I nderuar ministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj për Prokurorinë e shtetit dhe ne sa i përket përmbajtjes dhe esencës të ligjeve është shumë e qartë shumë e kuptueshme dhe shumë e nevojshme, sepse rregullimi i sistemit prokurorial në Republikën e Kosovës është nevojë e domosdoshme, si nevojë për rregullimi në sistemit të ri juridik në Republikën e Kosovës, si dhe plotësim i kushteve për integrimet evropiane. Prandaj, duke marrë parasysh se ne i votuam edhe ligjet paraprake dhe kemi gati në përfundim e sipër Ligjin për gjykatat e rregulla, ne japim mbështetje në parim dhe kontributin tonë si të domosdoshëm, do ta japim edhe në Komisionin funksional. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër, i vetmi ministër këtu,

Dëshiroj të theksoj se sa shumë është Qeveria e interesuar për sundimin e ligjit, thotë: reformat dhe pakoja e këtyre reformave të sistemit të drejtësisë, duhet patjetër të bëhet prioritet për Qeverinë dhe unë ftoj kolegët tuaj të jenë prezentë këtu kur flasin deputetët.

Tjetra është, zoti ministër, ju thatë se hartuesi, draftuesi i projektligjit. Dëshiroj t'ju kujtoj juve personalisht se ju jeni hartuesi dhe jeni sponzorizues i ligjit dhe dilemat presin që ju t'i sqaroni si sponzorizues dhe hartues i ligjit. Po kthehem në vetë shqyrtimin e Projektligjit për Prokurorin e shtetit. Sigurisht që edhe ky projektligj është një nga hallkat e rëndësishme si pjesë e reformës të sistemit të drejtësisë. Ndërtimi i një sistemi efikas prokurorial është nevojë imediate, ashtu që të sigurohet sundimi i ligjit në shtetin tonë, që është gjithashtu një nevojë imediate, por që është e rëndësishme edhe për ofrimin tonë me Bashkimin Evropian në kuptimin e përmbushjes së

kritereve për liberalizimin e vizave dhe kriteret tjera për integrimin në Bashkimin Evropian. Kjo është më se e nevojshme, sidomos duke marrë parasysh situatën aktuale në të cilën gjendet Prokuroria ose sistemi prokurorial i Kosovës, pasi që funksionon me kapacitet të kufizuar dhe këtu po i referohemi vetë raportit për vitin 2009 të kryeprokurorit të shtetit, zotit Ismet Kabashi, i cili thotë se ka numër të vogël të prokurorëve dhe në qoftë se më kujtohet mirë, janë vetëm 77 prokurorë.

Arsyeja tjetër është se ekziston hezitimi nga komuniteti serb për t'u përfshirë në vetë proces, është një bashkëpunim i kufizuar në mes prokurorëve dhe policisë dhe po ashtu në veri kemi një numër të kufizuar të prokurorëve të EULEX-it. Të gjitha këto janë rrethana shqetësuese të cilat kërkojnë që, jo vetëm të bëhet hartimi i këtij projektligji, por siç tha edhe zoti Bajrami, të mbështetet në një koncept të ri, i cili është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sidomos ato të legjislacionit të BE-së.

Do të citoj vetë raportin e progresit të BE-së, lidhur me këtë që thotë se raportin e progresit për vitin 2009, i cili thotë se sistemi i drejtësisë mbetet i dobët, i cenueshëm nga intervenimi politik dhe joefikas. Problemet strukturore të shërbimeve të prokurorive të Kosovës, duhet të adresohen. Besoj se kjo është shumë e rëndësishme. Nga ana tjetër, nevoja dhe domosdoshmëria për luftimin e krimit dhe korrupsionit, kërkon gjithashtu fuqizimin e sistemit prokurorial. Deri me tani kjo fushë ka qenë e rregulluar me legjislacionin e vjetër, si ligji mbi Zyrën e prokurorit publik të KSA të Kosovës.

Mirëpresim si grup parlamentar hartimin e këtij projektligji dhe konsideroj se projektligji është i hartuar mirë, i qartë dhe është i lehtë për t'u kuptuar. Synohet që sistemi prokurorial të funksionojë si një institucion i përvarur profesional dhe i paanshëm. Ligji bazohet në parimet e rëndësishme, ato ndërkombëtare siç janë të mos diskriminimit, të drejtave të njeriut dhe liritë themelore dhe merr parasysh gjithashtu edhe barazinë gjinore dhe të funksioni kryesor, që ka prokurori i shtetit për ndjekjen e personave që kanë kryer vepra penale dhe veprat tjera, bëhet edhe lidhur me mënyrën se si bëhet organizimi i vetë prokurorit të shtetit, do të thotë kryesisht në katër nivele, ato themelore, prokurorinë e apelit, speciale dhe Zyrën e kryeprokurorit të shtetit.

Përveç këtyre, mund të krijohen edhe njësi të reja, sipas këtij projektligji. Projektligji gjithashtu definon detyrat dhe kompetencat e prokurorëve, mënyrën e ushtrimit të funksioneve, sjelljen profesionale, duke u bazuar në ligjet e zbatueshme dhe kodin e etikës profesionale. Gjithashtu është respektuar parimi i transparencës, lidhur me punën e Prokurorit të shtetit pasi që ai informon publikun për aktivitetet e këtij institucioni, por natyrisht që kjo është e kufizuar deri në masën që mos të dëmtojë vetë hetimet ose zhvillimin e procedurës penale. Janë përcaktuar kriteret ose kushtet për emërimin e prokurorëve që janë kualifikimet minimale por edhe ato të veçanta. Një çështje me rëndësi që definon ky projektligj, patjetër është garantimi i përhershmerisë prokurorëve në ushtrimin e funksionit të tyre. Pagat bazë janë të caktuara, por edhe kompensimet shtesë. Ndërsa projektligji parasheh edhe marrjen e masave të veçanta në rastet kur rrezikohen vetë prokurorët për shkak të veprimtarisë së tyre ose familjet e tyre dhe besoj se kjo do të ketë një kosto buxhetore. Gjithashtu ekziston dispozita për parandalimin e keqpërdorimeve apo interesat personale të prokurorëve, duke përdorë funksionin e tyre.

E veçanta e këtij projektligji, është zbatimi se kur do të fillojë zbatimi i tij, sepse sipas projektligjit shihet se këto reforma do të përfshijnë periudhën së paku deri në fillim të vitit 2013, pasi që janë paraparë dy faza. Faza e planifikimit dhe zbatimit. Ndërsa sa i përket lëndëve të cilat në këtë kohë mundet të grumbullohen ato, natyrisht do të barten në nivelin përkatës, gjegjësisht në prokurorinë

gjegjëse me një fjalë, pjesa më e madhe e ligjit do të futet, do të hyjë në fuqi në 1 janar të vitit 2013.

Vërejtjet e veçanta të grupit parlamentar, janë se projektligji duhet të përmbajë dispozitat përkufizimin e pushtetit, prokurorit të shtetit dhe prokurorëve të lartë dhe po i definoj më qartë. Propozimi ynë është që të definohet se ku do të bëhet refuzimi i përmbushjes së urdhrave ose të udhëzimit që është në kundërshtim me ligjin dhe atë në formë të shkruar si dhe të kufizohet, të definohet e drejta e prokurorit më të lartë për t'i marrë masat e plota lidhur me veprimet e prokurorit?

Vërejtja e dytë është definimi më i qartë i shmangies së konfliktit të interesit. Në fund, një çështje të cilën e konsideroj shumë të rëndësishme, është zbatimi i vetë ligjit. Duke marrë parasysh se me rishikimin e buxhetit, kemi një shumë më të vogël të buxhetit, do të thotë me rishikimin e buxhetit Qeveria ka propozuar që Prokuroria dhe Administrata të kenë 2.895.000. Në fillim, kur është propozuar buxheti për vitin 2010, është propozuar 3.268.000 dhe kjo është bërë në zvogëlimin e shpenzimeve kapitale diku për 350.000.

Zoti ministër, ne shprehim shqetësimin se si do të zbatohen dispozitat ligjore në qoftë se nuk ekziston buxheti, do me thënë në vend që Qeveria të rris buxhetin për shkak se reformat do të kërkojnë mjete të caktuara financiare ose buxhet të shtuar, përkundrazi me propozimin e rishikimit, është bërë rishikimi i këtij buxheti.

Grupi Parlamentar kërkon nga ju ta sqaroni se si do të sigurohet buxheti për zbatimin e këtij ligji kaq të rëndësishëm. Në parim, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet. Ju faleminderit!

KRYEUSESI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti Riza Smaka

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti kryesues!

Ministër Yagcilar,

Deputetë të nderuar,

AKR-ja e mbështet këtë dokument. Vlerëson se miratimi i tij është i dobishëm edhe natyrisht me disa përmirësime kështu eventualisht edhe konceptuale. Po e zëmë nis nga neni 109 edhe i Kushtetutës, ndoshta do të duhej që ta quajmë prokurorin ashtu si e ka quajtur Kushtetuta, aty nuk kemi diskutim, prokurori shtetëror, institucion, kryeprokurori, individ, përfaqësuesi ligjor i prokurorit shtetëror. Këta të tjerët: prokurorin e apelit dhe themelor, mos t'i quajmë kryeprokurorë se disi po devalvohet edhe kryeprokurori, por prokuror i apelit, prokuror themelor, kështu edhe ma thjeshtë edhe më lehtë edhe më kapshëm. Në parim po e them. Më pastaj, disa herë janë dhënë disa vërejtje, po japim edhe një se nuk prishë punë, Prokurori i shtetit nënkupton, nuk është si me thënë në natyrën e gjuhës nuk përkon, por është edhe vazhdon më tutje.

Te neni 11, paragrafi 3, do ta lexoj, shkurt është, paragrafi 4: Kryeprokurori i shtetit mund të marrë në kompetencë secilin nen me kërkesë apo në pajtim të kryeprokurorit". Domethënë kryeprokurori nga kryeprokurori, bile me gërmë të madhe del se kryeprokurori me kërkesën e vet ose me pëlqimin e vet, mund ta marrë lëndën e vet, rastin e vet, a në doktrinë dihet. Në Prokurori vlejné këto dy parime të delegacio dhe avokacio. Për këtë kryeprokurori nuk e pyet fare prokurorin vartës, por mund t'ia marrë rastin juridik edhe t'ia jep tjetërkujt. Por mund t'ia delegojë. Prandaj,

ky duhet të riformulohet se nuk mund të shpjegohet pastaj ashtu siç duhet të shpjegohet dhe ashtu si duhet të jetë.

Te neni 15, për këtë etapë do të duhej t'i hiqeshim këto, zotëri ministër mendoj kësisoj, përderisa nuk do ta miratojmë Ligjin për gjykatat se nuk do ta dimë përfundimisht. Ne e kemi skicën paraprake, por ndoshta nuk do të miratohet, pastaj do të bëhet diskrepancë, që bie fjala, përmendet Gjilani, Peja, Mitrovica e tjera e tjera, por t'i lëmë ato veç të thirren Prokurori i apelit, Prokurori themelo, pa i përcaktuar vendet se mund të ndodhë që ndonjë e tillë nuk miratohet me Ligjin për gjykatat, ndërsa me këtë, se ky sigurisht nuk do të miratohet më parë. Pastaj do duhej të ndryshohej dhe të plotësohej.

Neni 17, sipas gjykimit tonë, është i panevojshëm në këtë dokument, sepse bën përshkrim. Thuhet se Prokuroria speciale.... është përcaktuar me Ligjin për Prokurorinë Speciale, numër, datë e tjera e tjera. Një deskripcion i panevojshëm Ai është një institucion i përcaktuar me një akt ligjor që është në fuqi edhe ka mundur ... me ligjin, veç L i vogël edhe mos të shkojmë me numër edhe me datë të miratimit të tij ligji.

Përfundimisht na e suportojmë këtë dokument, në këtë etapë do të përpiqemi që të japim një kontribut modest në të mirë të hartimit të tij dhe të miratimit. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, Ligji për prokurorin e shtetit, përcakton detyrat e prokurorit të shtetit të Republikës së Kosovës dhe unë besoj se ky ligj i duhet më së tepërmi Republikës së Kosovës. Kur flasim për prokurorin e shtetit, nuk është fjala për kryeprokurorin, por për secilin prokuror veç e veç në fushën e sistemit prokurorial. Prandaj, kjo është rregulluar edhe me Kushtetutë, dhe besoj se nuk kemi çka të themi në këtë drejtim.

Kjo fushë e veprimit, ka qenë e rregulluar me legjislacion të vjetër të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe ka qenë e rregulluar me një koncept të vjetër. Mund të themi lirisht se ky ligj është i punuar shumë më mirë dhe shihet se është punuar nga ekspertët, gjithashtu është edhe në harmoni me legjislacionin evropian.

Kur themi se është i punuar më mirë, besojmë se edhe vetë ministri ka pasur dorë në këtë drejtim ose ka punuar në këtë ligj, sepse në dy ligjet e mëhershme, dy ligjet që i miratuam më herët, kanë qenë shumë më të këqija, të punuara. Dashë Zoti që prokurori i shtetit të punojë për shtetin e Republikës së Kosovës, sepse deri më tani kemi pasur probleme në këtë drejtim.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim këtë projektligj dhe vërejtjet tona eventuale, ne do t'i japim gjatë amendamentimit të këtij Ligji. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit, “7 +” fjalën e ka kërkuar deputetja Mufera Shinik

MUFERA ŞINIK: Teşekkür ederim,

Kosova Cumhuriyeti Devlet Savcısı Yasa Tasarısını görüşmekteyiz. Az önce görüştüğümüz iki tasarıya benzer olarak bu Tasarı da memorandumun açıklanmasında ve tasarının özetinden de

analozi, prema tome, Kosova Savcılık yasamasının bütünleşmesi, önceki düzenlemelerle planlaştırılmamış bazı konuların ele alınması, bunlar gerçek duruma uyarlanması ve bu Yasa sayesinde Avrupa yasama standartları ile uyumlaştırılmasının bir örneğidir. Bundan önceki yasa tasarılarında olduğu gibi bu Tasarıda da ayrımcılığa karşı garantiler 5. madde ile kapsanmaktadır. Bu madde ile bu yasanın, Anayasanın 109. maddesi 4. ve 110. fıkrası 3. fıkrası ile uyumlu olarak Kosovadaki etnik çeşitliliğin yansıtılması gerektiğine dair ilke saptanmıştır. Ayrıca görüşmüş olduğumuz önceki tasarılar da olduğu gibi bu tasarının 6. maddesinde, devlet savcısının atkinliği de anayasa ve insan hakları ile cinsiyet eşitliğine dair uluslararası prensipler ile uyumlu olarak farklı esaslar üzerine ayrımcılığa karşı belli bir garanti verilmiştir. Bu tasarıda da “insan hakları” tabirine “toplumsal hakları” tabiri de eklenmelidir. Devlet Savcılığının düzeni ve örgütlülüğünü yansıtan esaslı ve ayan bir yasadan söz edilmesi yanı sıra ülkemizin yasaları hazırlamaktaki becerisindeki ilerlemeyi bir kez daha kanıtlamıştır. Dolayısıyla, biz uyarılarımızla birlikte bu Yasa Tasarısını kabul temekteyiz.

Teşekkür ederim

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem gospodine predsedavajući,

Gospodo ministri,

Uvaženi poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala je Nacrt zakona. U principu tekst je u redu i mi ćemo u načelu podržati. Međutim, u članu 7. postoje neke jezičke i terminološke odrednice koje sasvim suštinski menjaju značaj ovih pravnih normi ovde, naznačićemo neke od njih.

U članu 7. stav 1.8, tekst je sledeći: „Podnošenje optužnice“, optužnice se ne podnose, optužnica se podiže, zato ćemo mi predložiti da umesto reči „podnošenje“ bude reč „podizanje optužnice“. Zatim, u članu 1.9, tu je predstavljane vanrednih i redovnih pravnih sredstava, opet „predstavljaju“ nije adekvatna reč, mislim da reč „podnošenje, redovnih, vanrednih, pravnih lekova“ adekvatnije odgovara pravnoj terminologiji i značenju same pravne norme.

U članu 8. u prvom stavu „državni tužilac mora da sarađuje sa ...“ i tako dalje. Reč „mora“ je imperativnog, znači zapovednog značenja i ja mislim da bi trebala bolja formacija da bude: „državni tužilac ima obavezu da sarađuje“, znači to je sasvim neka druga sadržina koja označava tu pravnu normu.

U članu 9. glavni državni tužilac opet „mora“. Ja mislim da ta reč “mora”, trebalo bi da bude izbačena i da se umesto nje, u celom tekstu Nacrta zakona uvede reč: „je obavezan“, ili “je u obavezi“. To je isto i u članu 10. U članu 10. stav 2. čitamo znači „državni tužilac ne sme pružiti bilo kakvu informaciju“, smatramo reč „pružiti“ da ne odgovara adekvatnoj terminologiji, umesto nje predlažemo reč „iznositi“ ne „ne sme iznositi bilo kakvu informaciju“.

U članu 11. stav 3. “Glavni državni tužilac će imati isključivo nadležnost nad svim predmetima koji imaju poseban pravni lek”. Mislimo da poseban pravni lek, ne postoji takva terminologija u pravu, možda bi bolje bilo da se radi o vanrednom, jer su pravni lekovi ili redovni ili vanredni, ne postoje posebni pravni lekovi. U istom članu, u stavu 6, poslednja rečenica: „Glavni državni tužilac može delegirati određene vlasti“. Mislimo da je neprecizna formulacija. Smatramo umesto reči „delegirati“, treba da stoji reč „podnošenje“ ili “podnositi” ili “prenositi” ustvari, ne “podnositi“.

Zatim ova primedba je suštinske prirode, jer bi trebalo precizirati koja ovlašćenja može da prenese glavni državni tužilac i na koga će preneti ta ovlašćenja, zato što je to veoma bitno, da ne dođe do toga da možda se dogodi da sve to može da izazove nejasnoće u daljem radu državnog glavnog tužioca. Opet se spominje reč „mora biti“, mislimo da je reč „je obavezan“ mnogo prihvatljivije, zatim postoje reči koje su buduće, u budućem vremenu i ne održavaju samu normu.

U članu 14. „Državni tužilac Republike Kosova biće organizovan“, mislimo da to reč „biće“ treba da bude uklonjena i treba da se govori u sadašnjem vremenu „je organizovan i funkcioniše u skladu sa ovim zakonom“ i tako dalje. Isti je slučaj i sa stavom 2. U članu 16. recimo buduće vreme je pozitivno i korisno iskorišćeno, recimo „Kancelarija apelacionog tužilaštva, biće imenovani“, to stoji „biće“ reč. Zatim, u stavu 2, „Kancelarijom apelacionog tužilaštva rukovodiće“, trebalo bi „rukovodi“, znači u sadašnjem vremenu i tako dalje i tako dalje. Imamo još jednu primedbu, radi se o članu 24. stavu 1. „Tužioci imaju pravo i moraju primiti odgovarajuću profesionalnu obuku“ Tužioci imaju pravo i obavezu, smatramo reč „obavezu“ da je mnogo prikladnija ovoj pravnoj terminologiji. Kažemo u načelo, SLS će podržati ovaj nacrt zakona i ja se u to ime zahvaljujem. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit për Integrim, fjalën e ka kërkuar deputeti Branislav Grbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uvaženo Predsedništvo,

Uvaženi premijeru, zameniče,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Ova tri zakona koja danas raspravljamo su jako bitni zakoni za državu Kosovo. Poslanička grupa za integracije smatra da stvaranje nezavisnog sudskog sistema, kao i njegovo ojačavanje, predstavljaju najbolju garanciju za vladavinu prava na Kosovu.

Sudije na Kosovu treba da poseduju institucionalnu i materijalnu sigurnost kako bi mogli da obavljaju svoju pravnu obavezu na odgovarajući i potpuno nezavisan način, van bilo kakvog spoljnog uticaja, u cilju vraćanja poverenja građana u kosovsko pravosuđe.

Reforma sudskog sistema u kvalitativnom i kvantitativnog smislu, kao vidljivo poboljšanje društvenog, institucionalnog i materijalnog položaja, su neophodni i neizbežni. Mi smatramo da će usvajanjem ovog zakona, ne ulazeći u pod zakonske tačke koje ovaj zakon u nekom smislu možda ima neke manjkavosti, je sigurno nebitna u odnosu na zakon koji ćemo usvojiti kao jedan od bitnih institucionalnih zakona, koji će stvoriti uslove da svi građani Kosova, bez obzira na multi etničku pripadnost, osećaju se sigurnim i da imaju poverenje u pravosuđe i u institucije Kosova, odnosno u javno tužilaštva. U tom smislu, jako si bitni članovi 5. i 6. ovog zakona i ovim još jednom potvrđujem da će Poslanička grupa za integracije podržati ovaj zakon i nadamo se da će ovaj zakon imati primene. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Meqë nuk kemi deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kalojmë në procedurat e votimit në parim të Projektligjit për Prokurorin e shtetit. Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Tash kemi edhe dy deputetë më shumë, do të thotë janë 67 deputetë në sallë. Bëhemi gati për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, dy abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Prokurorin e shtetit.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Para se të kalojmë në pikën e radhës, fjalën në pajtim me nenin 48 të Rregullores së punës së Kuvendit, fjalën e ka kërkuar kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI: Ju faleminderit, kryesues,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të shpreh konsideratën më të lartë për Parlamentin Evropian, deputetët e Parlamentit dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për nxjerrjen e Rezolutës për Kosovën me një votim, do të thotë, në mbështetje të shumicës absolute. Kjo është një rezolutë që njeh të arriturat dhe realitetin në Republikën e Kosovës, që legjitimon pavarësinë dhe sovranitetin tonë, që stimulon bashkëpunimin rajonal dhe forcon më tej rrugëtimin tonë për në Bashkim Evropian.

Pra, i nderuari kryesues, më lejo, duke i falënderuar gjithë deputetët e Parlamentit Evropian të shpreh qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë rezolutë më të fuqishme ndonjëherë në historinë e Kosovës.

Kjo rezolutë do të jetë udhërrëfyese e angazhimeve të Qeverisë dhe institucioneve të Kosovës. Kjo rezolutë jep një sinjal të qartë dhe shumë të mirë për pavarësinë e Kosovës, stabilitetin tonë në rrugën tonë për integritet evropian, bashkëpunimin rajonal, por shpresoj edhe qartësimin e të tjerëve në raport me Republikën e Kosovës.

Dua të theksoj në veçanti se kjo rezolutë është në përputhje të plotë me vizionin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të qytetarëve të Kosovës dhe është vullneti ynë i shprehur në pikat e kësaj rezolute.

Ne çojmë konstatimin se stabilitetin e Ballkanin Perëndimor dhe procesi i integritet i këtyre vendeve është prioritet i Bashkimit Evropian.

Pika e parë e kësaj rezolute që njeh Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, të 17 shkurtit 2008, që është e njohur nga 69 shtete, prej tyre 22 vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe se inkurajon edhe 5 shtetet anëtare tjera të Bashkimit Evropian që janë në proces të vendimmarrjes për njohje që të përshpejtohet ky proces. Pra, është jashtëzakonisht me rëndësi ky qëndrim unik i Bashkimit Evropian.

Me kënaqësi presim edhe konstatimet se qytetarët e Kosovës nuk duhet të jenë të fundit apo të izoluar nga qytetarët e vendeve tjera në rajon dhe të Bashkimit Evropian dhe se procesi i liberalizimit të vizave duhet të fillojë pa vonesë, me agjendë të qartë dhe fton Komisionin Evropian që ta definojë udhërrëfyesin menjëherë, ndërsa ne dje veç e kemi të konfirmuar se ky proces do të fillojë në fund të kësaj vere.

Kjo rezolutë njih faktin që pavarësia e Kosovës është njohur nga shumica e vendeve fqinje dhe që Kosova ka marrëdhënie të mira fqinjësore dhe njih faktin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Me këtë rezolutë theksohet se raportet ndërshtetërore me Serbinë përmes CEFT-as dhe bashkëpunimit regjional duhet të rriten dhe në këtë drejtim fton Serbinë që të ketë një qasje pragmatike dhe të krijojë një mundësi për integritet regjional. Kjo rezolutë thekson që bashkëpunimi dhe integriteti rajonal janë me rëndësi për sigurinë evropiane dhe theksohet nevoja e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, për çka ne jemi dakord. Thekson nevojën e forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë në fushat e ambientit, infrastrukturës dhe tregtisë. Kjo rezolutë i fton anëtarët e Bashkimit Evropian dhe Komisionin Evropian që të adaptojnë dispozita procedurale që lehtësojnë rastet e udhëtimeve të qytetarëve të Kosovës. Në këtë rezolutë çmohet lartë dhe mirëpritet zgjedhjet e lira, të drejta, transparente, me standardin më të lartë përëndimor të 15 nëntorit, të organizuara në përgjegjësi politike të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe çmohet pjesëmarrja e të gjitha komuniteteve, në veçanti e atij serb. Me këtë rezolutë, me të drejtë theksohet se Beogradi ende po mbështet strukturat ekstremiste dhe paralele në enklavat dhe fton Serbinë që të ketë qasje pozitive dhe të punojë në shpërndarjen e këtyre strukturave në mosmbështetje. Theksohet suksesi i implementimit të procesit të decentralizimit dhe çmohet lartë formimi dhe funksionimi i komunave të reja. Mirëpritet hapja e shtëpisë së Bashkimit Evropian në veri dhe hapat tjerë që janë ndërmarrë dhe fton për qetësi në atë pjesë, duke mirëpritur edhe regjistrimin e mallrave në pikën 1 dhe 31 dhe të punohet për ndalimin e plotë të kontrabandës edhe në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Rezoluta thekson se viti 2010 është me rëndësi për Qeverinë e Kosovës dhe të gjitha institucionet të arrijnë progres në reformat kyçe demokratike, qoftë në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, decentralizmin dhe reformave të administratës publike. Kjo rezolutë mirëpret reformat tjera në sistemin e drejtësisë dhe krijimin e bazës juridike të ligjeve, si ato për gjykata dhe angazhimet tjera të cilat i ka edhe sot Kuvendi në rend të ditës.

Gjithashtu, çmohet lartë roli i mediave, shoqërisë civile në pjesëmarrjen e hartimit të ligjeve, gjithashtu edhe në angazhimet tona për afirmimin e të drejtave të njeriut në interesin e përgjithshëm.

Rezoluta thekson nevojën e zhvillimit socio-ekonomik dhe për këtë fton Komisionin Evropian që përmes instrumentit të para anëtarësimit të ndihmojë këtë proces dhe në veçanti njerëzit e ri, por edhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që të pranojnë sa më shumë që është e mundur punëtorë sezonalë nga Kosova. Këtu theksohet nevoja edhe për shkëmbime akademike përmes programeve financuese.

Rezoluta mbështet qasjen aktive në fushën e energjetikës, si pjesë e zhvillimit të Kosovës dhe për këtë fton në një bashkëpunim rajonal. Rezoluta thekson nevojën e modernizimit të hekurudhave të Kosovës dhe lidhjet me vendet fqinje përmes fondeve të instrumenteve të para anëtarësimit, si dhe çështjet tjera ambientale.

Të nderuar deputetë, kjo rezolutë do t'ju dorëzohet edhe juve të gjithëve dhe ju ftoj që bashkërisht të japim kontributin të gjithë, pa dallim partie, në forcimin e institucioneve tona dhe arritjen e synimeve të përbashkëta për ecje sa më të shpejtë për t'u integruar si shtet në strukturat e NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Edhe Kuvendi i Kosovës i bashkohet mirënjohjes dhe çmon lartë kontributin e Parlamentit Evropian në afirmimin e shtetit të Kosovës përmes kësaj rezolute.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Pika e shtatë e rendit të ditës, është:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor apo raportuesin e komisionit që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk e ka kërkuar fjalën askush në emër të komisionit, andaj vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitura në raport nga komisioni funksional.

Para se të kalojmë në votim, konstatoj se në sallë kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve dhe raporti i fundit thotë se i kemi prezentë 72 deputetë. Atëherë, fillojmë me votimin e amendamenteve të propozuara. Ftoj regjinë dhe deputetët që të votojmë për amendamentin 1.

Amendamenti 1.

Bëhuni gati dhe votojmë tash:

Pa kartelë? Nuk kemi.

Konstatoj se Kuvendi miratoi amendamentin 1 me 62 vota “për”, 6 abstenime dhe 1 “kundër”.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 6 abstenime, asnjë “kundër” u miratua edhe amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 7 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 6 abstenime dhe asnjë “kundër” u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 6 abstenime dhe asnjë “kundër” u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 7 abstenime dhe asnjë “kundër” u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 7 abstenime dhe asnjë “kundër” u miratua amendamenti 7.

Amendamenti, i fundit, 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 5 abstenime dhe asnjë “kundër” u miratua edhe amendamenti 8.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatitemi për votimin e tekstit të Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi prezentë 76 deputetë.

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tash:

A ka pa kartela “për”?

Konstatoj se me 66 vota “për”, 6 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projekt - kodit të drejtësisë për të mitur

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projekt - kodin e drejtësisë për të mitur dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë për votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, nëse e kërkon fjalën, apo raportuesin në emër të komisionit, që ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka kërkuar deputeti, kryetar i Komisionit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk do t’ju marr asnjë minutë kohë, vetëm për të sqaruar. Janë edhe 4 amendamente të cilat i ka propozuar deputeti Riza Smaka. Komisioni i ka shqyrtuar me vëmendje dhe e ka aprovuar njërin nga amendamentet – amendamentin 6, kurse për amendamentet tjera ka konstatuar që janë pa përmbajtje dhe më mirë janë në projektligjin ekzistues.

Prandaj, për të mos hapur debat më vonë, vetëm amendamentin 6 e kemi shqyrtuar dhe e kemi aprovuar si komision, të tjerat kërkoj që deputetët t’i aprovojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës, të paraqitura në raport nga komisioni funksional. Votojmë amendamentet veç e veç.

Votojmë amendamentin 1.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 1.

Kalojmë në votimin e amendamentit 2.

Këtu kemi dy propozime, siç u tha. Ne votojmë fillimisht për amendamentin e propozuar nga Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi. Bëhemi gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 “kundër” dhe 6 abstenime, u miratua amendamenti 2 – versioni i Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe konsiderohet që nuk kemi nevojë të votojmë edhe për versionin tjetër, meqë kemi shumicën absolute të votimit për këtë.

Vazhdojmë me amendamentin 3.

Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 71 votë “për”, 4 abstenime dhe 2 “kundër”, Kuvendi e miratoi edhe amendamentin 3.

Vazhdojmë me amendamentin 4.

Regjia dhe deputetët, gati për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, 3 abstenime dhe 1 “kundër”, u miratua amendamenti 4.

Kemi amendamentin 5, të propozuar nga deputeti Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 32 vota “për”, 7 abstenime dhe 33 “kundër”, Kuvendi nuk e miratoi amendamentin 5 të propozuar nga deputeti Riza Smaka.

Vazhdojmë me amendamentin 6.

Regjia dhe deputetët, gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 3 abstenime dhe një “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Votojmë amendamentin e radhës, 7.

Regjia dhe deputetët, gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 6 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 6 abstenime dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 5 abstenime dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 6 abstenime dhe 1 kundër, u miratua amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 6 abstenime, 1 “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 70 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë kundër, u miratua amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë kundër, u miratua amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë kundër, u miratua amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, 4 abstenime, 1 “kundër”, u miratua amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë kundër, u miratua amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 24.

Amendamenti 25, që i ka dy propozime: propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, fillimisht e hedhim në votim.

Votojmë tash:

Konstatoj se amendamenti 25, propozimi i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi u aprovua me 60 vota “për”, 3 abstenime dhe 6 “kundër” që do të thotë se propozimin tjetër nuk e hedhim në votim.

Amendamenti 26, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 5 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua edhe amendamenti 26.

Në sallë kemi 73 deputetë.

Votojmë për tekstin e Projekt-kodit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi e miratoi Kodin e drejtësisë për të mitur.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, i cili nuk e ka kërkuar fjalën. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional. E kemi vetëm një amendament.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, 5 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti i parë.

Ju ftoj të votojmë për tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentin e miratuar.

Para se të votojmë, konstatoj se në sallë kemi të pranishëm 76 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 71 votë “për”, 4 abstenime, 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2009.

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Raportin financiar të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë.

Ftoj kryetarin komisionit funksional, deputetin Naser Rugova apo raportuesin e komisionit për ta arsyetuar raportin.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur me datën 1.6.2010 shqyrtoi Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2009, dhe vendosi që Kuvendit t'i propozojë edhe rekomandimet që i kemi bërë me konsensus të plotë në komisionin funksional.

Ky raport ka ardhur pakëz me vonesë, arsyet dihen, sepse kanë qenë vonesa deri te zgjedhja e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të kësaj zyre rregullatore. Përndryshe, raporti është shumë substancial, është një nga raportet e mira që i vijnë këtij Kuvendi nga autoritetet rregullatore dhe në emër të komisionit funksional kërkoj edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, po edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i mbështesin disa nga kërkesat legjitime të Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për kosto shtesë buxhetore, sepse kanë nevojë për organizimin më të mirë në bazë të organogramit të ri që e ka hartuar ky rregullator, kanë nevojë për inspektorë shtesë dhe staf tjetër që vërtet do të ndikojnë shumë në përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujit dhe menaxhimit të mbeturinave. Edhe në aspektin financiar, do të thotë, kemi një pasqyrë reale dhe një menaxhim solid të mjeteve që i plotësojnë kriteret dhe standardet e parapara për raportim në Kuvend, andaj kërkoj nga kolegët deputetë që ta mbështesin dhe në njëfarë forme t'i mbështesin edhe kërkesat legjitime të kësaj zyre rregullatore. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk e ka kërkuar fjalën askush. Kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave dhe mendon se ky raport është mjaft përmbajtjesor dhe bën pjesë në grupin e raporteve të mira të cilat sillen nga zyrat relevante.

Ajo që mendon Grupi parlamentar është se duhet të potencohet që Kuvendi i Kosovës, përveç se duhet të aprovohen rekomandimet nga ky Kuvend, të merren edhe shumë serioze në implementim, është se zakonisht nëpër qytete aplikohet ende reduktimi kolektiv i ujit për shkak të mungesës së

mundësisë së faturimit, gjegjësisht për shkak të borxheve të mëdha të konsumatorëve në raport me kompanitë rajonale të ujërave.

Ne mendojmë se shumica e objekteve kolektive kanë njehsorë të ujit të instaluar në banesat e tyre dhe ka mundësi që me një kosto mjaft të vogël të bëhet rifunksionalizimi i këtyre njehsorëve dhe t'i iket metodës së faturimit paushall, gjë që ka ndikuar në pamundësinë e faturimit, gjegjësisht në pamundësinë e pagesave të borxheve nga ana e konsumatorëve ndaj kompanive të ujërave. Andaj, me këtë vërejtje që kemi menduar të potencohet në këtë Kuvend, ne e aprovojmë raportin dhe gjithashtu i aprovojmë edhe rekomandimet të cilat i ka dhënë komisioni funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor për vitin 2009 nga Rregullatori për Ujëra dhe Mbeturina dhe pas shqyrtimit të raportit të përgatitur nga rregullatori, edhe përkundër angazhimeve që ka bërë rregullatori për prezantimin e drejtë të gjendjes në këtë sektor, duke filluar nga statusi ligjor dhe përgjegjësitë e ZRRUM-it përfshirë strukturën organizative, aktivitetet në monitorimin e kompanive regjionale të ujit për vitin 2009, trajtimin e ankesave të konsumatorëve përmes komisionit këshillues të konsumatorëve, çështjet financiare tjera, ekzistojnë mangësi të cilat duhet përmirësuar në të ardhmen.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, përkrah rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujërave, në sektorin e mbeturinave dhe në strukturën organizative të ZRRUM-it. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti dhe anëtari i Kryesisë, Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AAK-së do të votojë pro këtij raporti dhe rekomandimeve që, siç tha kryetari i komisionit, në mënyrë unanime janë miratuar në komisionin funksional, mirëpo ua tërheq vërejtjen deputetëve dhe përfaqësuesve të Qeverisë, posaçërisht ministrit këtu, se duke shikuar raportin që është bërë mirë, është hartuar mirë dhe paraqet një gjendje reale në këta sektorë në Kosovë, të gjitha tabelat që kanë të bëjnë me performancat e kompanive regjionale për ujë dhe mbeturina në Kosovë në vitin e kaluar kanë trend negativ dhe kjo duhet të jetë shqetësuese edhe për ne si deputetë, edhe për Qeverinë dhe për ministrinë gjegjëse. Mendojmë se duhet urgjentisht të ndërmerren hapa konkretë në qoftë se ka nevojë në ndryshimet e nevojshme që duhet të bëhen në Ligjin për pushtetin lokal. Mendojmë se arkëtimi qoftë për ujë ose për mbeturina për shërbimet publike duhet të jetë përgjegjësi e lëshuar në nivel lokal, pra në nivel të komunave dhe jo ajo të mbetet vetëm përgjegjësi e kompanive regjionale për shkak se në qoftë se vazhdohet edhe më tej ky trend negativ në arkëtim të shërbimeve publike, atëherë edhe ashtu këta dy sektorë janë para një kolapsi në Kosovë, do të zgjerohet ky kolaps dhe do të thellohet dhe problemet me menaxhimin e mbeturinave dhe me furnizimin me ujë do të jenë edhe më të theksuara në Kosovë. Singërisht duhet Qeveria të merret me

këta sektorë dhe duhet të ndërmerren hapa konkretë në përmirësimet në ligje dhe në përmirësimet në këto trende.

Grupi Parlamentar i AAK-së e miraton këtë raport me këto rekomandime, mirëpo po e potencoj dhe po e përsëris, në qoftë se nuk ndërmerren hapa konkretë në këta sektorë, atëherë ky votim do të jetë si votimi për shembull për raportin e Trustit pensional dhe asgjë s'u bë, nuk kaloi në Kuvend të Kosovës dhe askush nuk pati pasoja nga kjo dhe askujt kurrë nuk i ndodhi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti Heset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Raportin vjetor për vitin 2009 të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina e ka shqyrtuar edhe Grupi Parlamentar i AKR-së dhe e përkrah plotësisht, sepse ky raport i përmban të gjitha kërkesat që duhet t'i plotësojë raporti i paraparë sipas Ligjit numër 03/L-086.

Raporti vjetor për vitin 2009, krahasuar me vitin 2008, është përafërsisht i njëjtë, është një raport i punuar mirë dhe pasqyron gjendjen reale në terren, por gjendja në sektorin e ujërave dhe mbeturinave edhe më tutje nuk është në nivelin e dëshiruar për shkak të disa sfidave tash të njohura për të gjithë ne.

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen në të cilën e ka shqyrtuar këtë raport, ka vendosur që Kuvendit t'i propozojë disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujërave dhe mbeturinave të cilat edhe Grupi Parlamentar i ka përkrahur në tërësi.

Nëse krahasohen performancat relative të kompanive të ujit për vitin 2009, krahasuar me vitin 2008, shihet se shkalla e arkëtimit është me trend negativ për 6 kompani regjionale, me përjashtim të Kompanisë regjionale të ujit – Bifurkacioni, e cila ka pasur trend pozitiv me një përqindje diku 3%. Gjithashtu, edhe shkalla e arkëtimit të kompanive regjionale të grumbullimit të mbeturinave ka shënuar trend të uljes për 8%, krahasuar me vitin 2008, dhe shkalla e arkëtimit ka shënuar zbritje të kategoria e konsumatorëve komercial dhe industrial, ndërsa amvisëria ka mbetur në të njëjtin nivel. Prandaj, këto janë disa nga sfidat që vështirësojnë punën dhe nivelin e shërbimeve në kompanitë publike dhe ne konsiderojmë se këta operatorë duhet të kenë mbështetjen e institucioneve përkatëse me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimit për qytetarët e vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së prapë flet deputeti Naser Rugova, në emër të grupit tash.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet në parim rekomandimet e komisionit funksional, por edhe raportin dhe performancën e hartimit të këtij raporti që flet për gjendjen reale, mirëpo ne tërheqim vëmendjen në hartimin sa më të shpejtë dhe plotësim-ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e mbeturinave, Ligjit për ujëra, sepse vërtet do të kenë impakte direkte në përmirësimin e këtyre sektorëve që kanë të bëjnë shumë me shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës, por edhe me politikat mjedisore, andaj duam të besojmë si grup parlamentar që këto

rekomandime të komisionit funksional, që po mbështeten nga të gjitha grupet parlamentare në Kuvend, do të hasin në mirëkuptim edhe në adresat që këto rekomandime iu drejtohen. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav svima!

I Parlamentarna grupa „7+“ je razmatrala godišnji izveštaj Regulatornog ureda za vodu i otpad i uvažavajući rad funkcionalne komisije, u potpunosti podržava preporuke koje je izradila komisija.

Smatramo da će ove preporuke uticati na poboljšanje postojećeg stanja u sektoru vode i otpadaka, kao i na poboljšanje organizacione strukture ovog regulatora.

Važno je napomenuti i znatna planirana investiranja u sektoru vodovoda i kanalizacije za budući trogodišnji period koji će omogućiti kvalitetnije usluge za sve korisnike.

U izveštaju su opisani i aktivnosti na zakonodavnom planu, izmene i dopune primarnog i sekundarnog zakonodavstva, saradnja sa regulatorima i drugim institucijama na Kosovu, u regionu i Evropi.

Značajno je istaći tesnu saradnju ovog ureda sa nacionalnim institutom za javno zdravlje Kosova i zajedničku kontrolu kvaliteta i higijenske ispravnosti vode za piće i njihovo blagovremeno reagovanje kada kvalitet nije bio zadovoljavajući. U cilju zaštite životne sredine, a samim tim i zdravlja ljudi, neophodno je veće angažovanje u sprečavanju pojave divljih deponija. Region Đakovice je i dalje bez licencirane deponije pa su nelicencirane deponije van svakog standarda životne sredine.

I na samom kraju, Parlamentarna grupa „7+“ podržava izveštaj Regulatornog ureda za vodu i otpad i svakako preporuke funkcionalne komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka të paraqitur për diskutim, ndërkaq në emër të Grupit për Integrim, fjalën e ka kërkuar deputeti Branislav Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Grupa za integracije podržae ovaj izeštaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë me radhën e deputetëve të paraqitur për diskutim. Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu, le të përgatitet deputeti Abdyl Ymeri.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Në Kosovë problemet e ujit dhe të mbeturinave janë të mëdha. Rregullatori, si autoritet i pavarur që rregullon veprimtarinë e kompanive publike të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit të kanalizimit dhe mbeturinave, pas plotësimit të stafit menaxheria, të votuar në Kuvendin e Kosovës, po vazhdon të përforcojë funksionet e veta rregullatore në monitorimin dhe vlerësimin e performancës së kompanive, avancimit të procesit tarifor dhe bashkëpunimit me palët e interesit.

Tabelat e të dhënave financiare të performancës së kompanive rajonale të ujërave dhe mbeturinave tregojnë për efikasitetet dhe efektivitetet të dobët të këtyre kompanive. Rritja e efikasitetit të Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, posaçërisht rritja e efikasitetit të Zyrës për analizat e performancës financiare dhe shërbimit ndaj konsumatorëve është e domosdoshme. Efikasiteti si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të këtyre zyreve do të krijojnë impute për planifikim edhe të tarifave, por edhe të politikave për menaxhimin e ujit dhe mbeturinave së bashku me akterët tjerë të rëndësishëm, siç janë: Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike; Këshilli i Kosovës për Ujëra; Shoqata e Kompanive të Mbeturina; Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit e të tjera.

Për këtë arsye, vëmendje të posaçme duhet t’iu kushtohet konsumatorëve, po edhe konsumatorët edhe qytetarët duhet të marrin përsipër obligimet që kanë ndaj këtyre ndërmarrjeve publike, në mënyrë që të hapen shtigje të reja për planifikimin dhe shfrytëzimin e ujit si dhe riciklimin e mbeturinave. Në këtë kontekst, edhe bashkëpunimi me media qendrore, por edhe ato lokale do t’i kontribuojnë ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për shërbimet publike, por edhe për kursimin e ujit dhe çështjeve që lidhen me mbeturinat.

Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina duhet t’i rishikojë licencat e deponive të mbeturinave, si dhe ngritjen e standardeve për mbajtjen e këtyre deponive, të cilat shpesh janë bërë edhe vende të vizituara nga fëmijët dhe të varfrit. Në këtë kuptim, përmendi deponinë e ndërtuar në fshatin Koshtovë të Mitrovicës, e cila deponi ka shkaktuar drejtpërdrejt edhe ndotje të ambientit, por edhe të puseve për ujë të pijes.

Meqenëse Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina po vazhdon me ngrit performancën e saj, besojmë që është koha e fundit që t’i jepet përkrahje kësaj zyre për marrjen e masave dhe politikave për promovimin dhe mbështetjen e burimeve dhe kursimit të ujit, si dhe të masave për riciklimin e mbeturinave. Raportin e Zyrës së Rregullatorit do ta përkrahim dhe do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri, le të përgatitet diskutuesja e fundit, deputetja Nurisha Hula.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti në tërësi është gjithëpërfshirës dhe i punuar mirë. Në raport kemi të paraqitur vizione dhe misionin e qartë që tregon për rrugën dhe kahet e zhvillimit të këtyre sektorëve, si dhe për përmbushjen e obligimeve dhe detyrave që i ka kjo zyrë.

Kjo është shpresëdhënëse por, në fakt, nëse lexohet me kujdes dhe i bëhet një analizë e thuktë dhe krahasuese këtij raporti, shihet se përkundër angazhimit, vullnetit dhe përkushtimit të udhëheqësve të zyrës, është larg arritjes dhe përmbushjes së objektivave të saj, sepse gjendja në sektorin e ujërave dhe të mbeturinave edhe përkundër investimeve të shumta, qoftë nga Qeveria apo donatorët e ndryshëm, nuk është në nivelin e duhur.

Konsideroj se kjo zyrë në mënyrë reale dhe të detajuar ka paraqitur performancën operative financiare, si dhe performancën e shërbimeve ndaj konsumatorëve nga kompanitë regjistruara të ujërave dhe të mbeturinave.

Performanca e përgjithshme në sektorin e ujit përmes treguesve kyç për vitin 2009, krahasuar me vitin 2008, shihet se në 4 tregues kemi një trend negativ, ndërsa në 3 tregues kemi trend të njëjtë dhe vetëm në 1 tregues kemi trend pozitiv, që do të thotë se nuk kemi një performancë të kënaqshme, ndërsa kemi rritje të shpenzimeve operative për 4%.

Një problem që është shqetësues janë humbjet e mëdha të ujit të pijshëm, keqpërdorimi i ujit, kyçjet ilegale. Prandaj, në këtë drejtim është mirë që kompanitë, zyra dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të punojnë në identifikimin dhe zgjidhjen e këtyre problemeve. Zyra të ketë parasysh mbrojtjen dhe kërkesat e drejta të konsumatorëve, duke mos i shkyçur kolektivisht dhe duke mos i ngarkuar me paushall.

Performanca e kompanive regjionale, të cilat ofrojnë shërbime në grumbullimin e mbeturinave, sipas raportit dhe treguesve të performancës shihet se ka një trend në rënie, sidomos në treguesit financiarë. Shkalla e arkëtimit vetëm prej 53% gjatë vitit 2009 tregon se këto kompani, nëse vazhdojnë me një trend të tillë, do të ballafaqohen me vështirësi financiare, me çka këto kompani nuk do të kenë funksionim normal e po ashtu ofrimi i shërbimeve do të jetë në nivelin e ulët.

Kompanitë duhet të kenë një plan të veprimit me qëllim të ngritjes së performancës në menaxhim, si dhe ofrimin e shërbimeve në nivelin më të lartë për konsumatorët, sepse përkundër investimeve që janë bërë në ndërtimin e deponive, kudo që shkon dhe shikon në mjedisin tonë vërehet se ka mbeturina dhe kjo është si pasojë e mosmenaxhimit të mirë të mbeturinave.

Unë, për fund do të ngre një shqetësim tjetër, atë të furnizimit me ujë të pijes nëpër fshatra, të cilat nuk janë të kyçura në sistemin e ujësjellësit. Banorët nëpër fshatra kryesisht furnizohen me ujë nga puset, të cilat, sipas raporteve dhe analizave të bëra nga Instituti i Shëndetit Publik, në pjesën më të madhe është ujë jo i pijshëm. Pastaj, nga donatorët e ndryshëm dhe komunat janë ndërtuar projekte të shumta të ujësjellësve nëpër ato fshatra ku ka pasur burime të ujit, por problemi kryesor është menaxhimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e tyre, sepse kjo nuk është rregulluar mirë dhe këta ujësjellës janë jashtë menaxhimit të kompanive regjionale, ndërsa menaxhimi i tyre bëhet në mënyrë të ndryshme nga vetë banorët. Prandaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive, duhet të ketë parasysh edhe menaxhimin e këtyre ujërave dhe të përgatisë një plan strategjik për menaxhimin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë me qëllim të përmirësimit dhe zhvillimit të këtyre sektorëve. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesja e fundit është deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ministra dhe deputetë të nderuar,

Raporti i Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, i vitit 2009, është një raport i strukturuar mirë, me të dhëna reale, ashtu si është edhe gjendja ekzistuese në Republikën e Kosovës, me performancë të thukhtë të të gjitha kompanive, por mund t'i cek këto kompanitë më kryesore, shumë esenciale për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, sepse uji dhe mbeturinat janë faktorë që mund të ndikojnë në mënyrë direkte dhe indirekte në shëndetin e popullatës.

Tabelat e paraqitura në këtë raport janë më shumë të trendit negativ, disa janë edhe me gjendje të njëjtë, andaj kërkohet një angazhim me një dinamikë më të shtuar, sidomos të inspektorateve

komunale për rregullimin e çështjes së mbeturinave në komunë, por edhe në regjione të cilat mbeturina ende hudhen nëpër rrugët anësore magjistrale të Republikës së Kosovës.

Kompanitë regjionale për mbeturina të përkrahen me programe të veçanta nga ana e Qeverisë me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, sepse mbrojtja e mjedisit është një faktor esencial për qytetarët. Situata e tanishme ende regjistron shpërndarje të mbeturinave përrreth rrugëve dhe kjo çështje duhet të përkrahet si nga grandet qeveritare, ashtu edhe nga komunat me programe të veçanta katër herë në vit për të zhvilluar aktivitete, në mënyrë që të gjitha këto zona mjedisore të shpallen brenda vitit si zona ekologjike mjedisore të mbrojtura për Republikën e Kosovës.

Në raport nuk janë cekur shumë çështje të zonave rurale. Këtu janë cekur kompanitë për regjionin që e mbulojnë, i mbulojnë vetëm komunat, qytetet në brendi që kanë hidroregjion, domethënë uji kontrollohet dhe klorinohet, ndërsa zonat rurale sidomos qytetarët që pinë ujin e puseve, pusët janë të pakontrolluara, gjithashtu edhe mjediset e zonave rurale nuk janë të mbuluara me rregullimin e çështjes së mbeturinave, të cilën çështje duhet ta rregullojnë kuvendet komunale përkatëse.

Gjithashtu, në këtë raport nuk janë paraqitur edhe vlerat e kontrollit të ujit të pijes, që kompanitë regjionale të mbikëqyrjes dhe kontrollit të cilësisë së ujit të pijes e bëjnë në mënyrë permanente, domethënë këto të dhëna nuk i kemi komplet të paraqitura, që konsideroj se në bazë të të dhënave që ka Republika e Kosovës për kontrollin e ujit të pijes, rreth 82% të zonave rurale kanë ujin e kontaminuar me baktere, andaj kërkohet një angazhim më i shtuar dhe një përkrahje financiare jo vetëm kompanitë të mbështeten me donacione, por të kenë edhe përkrahje qeveritare dhe komunale. Kjo është shumë e rëndësishme dhe mund të them se ne ende nuk kemi në Republikën e Kosovës ujë cilësor të pijes, ne kemi ujë higjienik të pijes dhe rezultatet në këtë tabelën për kompanitë, hidroregjioni jugor i Prizrenit paraqitet me të dhëna më pozitive krahasuar me këto regjionet tjera, më tepër ka trend pozitiv se sa trend negativ, sepse është një regjion që i mbulon rreth 500.000 banorë dhe ka një rëndësi shumë të madhe në kontrollin dhe mbikëqyrjen e ujit të pijes.

Raportin në parim e përkrahim dhe konsideroj se në të ardhmen këto kompani do të kenë përkrahje më të fuqishme edhe qeveritare, edhe komunale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi të pranishëm 69 deputetë, mund të hyjmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2009, me rekomandimet e komisionit funksional.

Kalojmë në pikën e radhës:

11. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009

Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe financave, zotin Ahmet Shala, ta marrë fjalën.

AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër, i nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që sot të paraqes para jush Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, për vitin 2009.

Auditimi i brendshëm është pjesë themelore e qeverisjes së mirë, e cila fillon me përcaktimin e strategjisë, të politikave operacionale, alokimin e burimeve nëpër ministri, komuna dhe entitete tjera publike për t'i përdorur ato në përmbushjen e objektivave të qeverisjes dhe planit zhvillimor.

Qeveria e Republikës së Kosovës këssoj kërkon nga të gjithë shpenzuesit e mjeteve buxhetore që të ngrejë sisteme efikase të kontrollit, shpenzim racional të parasë publike, menaxhim të rrezikut në mënyrë moderne dhe performancë adekuate për t'u siguruar që mjetet e alokuara për secilin subjekt të sektorit publik të përdoren si duhet dhe në frymën e shpërndarë. Ndërsa roli i auditimit të brendshëm është për t'u siguruar se menaxherët kanë hartuar dhe po zbatojnë si duhet sistemet e kontrollit të brendshëm.

Hartimi i këtij raporti është rezultat i raporteve të pranuar nga njësitë e auditimit të brendshëm nëpër organizatat buxhetore që financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Aktivitetet e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2009 janë përqendruar në përmbushjen e planit vjetor, kryesisht në infrastrukturën ligjore dhe në ngritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm, si në harmonizimin e infrastrukturës ligjore për auditim të brendshëm me standarde dhe praktika ndërkombëtare, harmonizimin e udhëzimeve administrative, ngritjen profesionale të auditorëve të brendshëm, bashkëpunimin e Njesisë Qendrore Harmonizuese me Zyren e Auditorit të Përgjithshëm dhe për partnerët e tjerë relevantë, si dhe promovimin e rolit të auditimit në përgjithësi.

Ligji për auditim të brendshëm nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është aprovuar më 17 shtator 2009, kurse dekretimi nga presidenti është bërë më 13 tetor të njëjtin vit. Deri më tash janë nxjerrë dy udhëzime administrative, siç është Udhëzimi administrativ për përcaktimin dhe procedurën e pajisjes me licencë të përkohshme të auditorëve të brendshëm të sektorit publik dhe Udhëzimi administrativ për themelimin e funksionimit të Njesisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Në shtator të vitit 2009 ka filluar projekti – Përkrahja e bashkësisë evropiane për përmirësimin e menaxhimit, kontrollit dhe llogaridhënies publike në Kosovë, ku fokus kryesor është trajnimi i auditorëve të brendshëm në programin për certifikimin ndërkombëtar, i cili projekt do të vazhdojë deri në vitin 2011. Në këtë projekt janë përfshirë numër i caktuar i auditorëve të brendshëm, rreth 60, edhe pse insistimi ynë ka qenë që të përfshihen të gjithë, ndërsa konsideroj që në të ardhmen ky projekt duhet të vazhdojë për numër më të madh të auditorëve të brendshëm se sa auditorët aktivë, gjithnjë për të përcaktuar një treg rezervë nga sektori privat në rast të mos disiplinës apo përfundimit të auditorëve të brendshëm dhe gjithnjë me qëllim të disiplinimit dhe të ngritjes së efikasitetit në menaxhimin e auditorëve të brendshëm.

Po ashtu, është bërë përgatitja dhe publikimi i doracakut të auditimit të brendshëm dhe shpërndarja e tij tek auditorët e brendshëm. Ky doracak përfshin të gjitha udhëzimet e nevojshme për kryerjen e auditimit të brendshëm, siç janë standardet, kodi i etikës, statuti i njesisë së auditimit të brendshëm, praktikat më të mira për komitetin e auditimit, statutin e komitetit të auditimit dhe një sërë aspekte tjera të rëndësishme për auditim. Duhet theksuar se doracaku i auditimit të brendshëm merret si

model nga vendet e regjionit dhe janë dhënë vlerësime të larta nëpër takimet regjionale dhe ato botërore për organizimin e auditimit të brendshëm në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2009 është shënuar rritje e zërave që kontribuojnë në efikasitetin e auditimit të brendshëm dhe më lejoni t'i përmend disa.

- Rritja e numrit të njësive të auditimit të brendshëm për 18%;
- Rritja e numrit të komiteteve të auditimit për 29%;
- Rritja e numrit të auditorëve të brendshëm për 15%;

Edhe pse duhet të theksoj se përkundër kësaj rritjeje të numrit, ende nuk janë përmbushur kërkesat për auditorë të cilat dalin nga plani për kompletimin e njësive të auditimit të brendshëm, andaj kërkojmë nga të gjitha organizatat buxhetore që të përmbushin këtë nevojë të domosdoshme.

Po ashtu, është bërë rritje e numrit të auditimeve të kryera, diku për 23%, përkatësisht në vitin 2008 janë kryer 292 auditime, ndërsa në vitin 2009 janë 360 auditime të brendshme.

Në bazë të raporteve të pranura nga njësitë e auditimit të brendshëm nga niveli qendror dhe lokal, gjatë vitit 2009 janë dhënë 2.207 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Prej këtyre rekomandimeve, nga menaxhmenti janë implementuar 1.215, përkatësisht 55,05%, në proces janë 23,74%, përkatësisht 524 rekomandime dhe të pakryera ose të paimplementuara janë 469 ose 21,21%.

Sa i përket çështjes së rekomandimeve të paimplementuara, vërehen se disa prej këtyre rekomandimeve janë dhënë në tremujorin e katërt dhe përcjellja e zbatimit të tyre vazhdon edhe gjatë vitit 2010 dhe besojmë që këto rekomandime do të përmbillen. Sidoqoftë, është evidente se kërkesë kryesore për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Republikën e Kosovës është plotësimi i njësive të auditimit të brendshëm me auditorë të mjaftueshëm profesionalë, si dhe stimulimi dhe përmirësimi i kushteve të punës së tyre, trajnimi i vazhdueshëm i anëtarëve të Komitetit të Auditimit, ngritja e shkallës së implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti si dhe promovimi i rolit të auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat publike.

Duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e auditimit të brendshëm, jemi duke krijuar kushte dhe kujdes të veçantë ngritjes së kapaciteteve dhe forcimit të mëtejshëm dhe nuk do të ngarendim deri sa të përmbushim këtë objektiv shumë të rëndësishëm për menaxhimin e financave publike dhe kontrollin.

Duke konsideruar se në raport janë dhënë detaje të mjaftueshme për juve, ju lus që ta merrni në shqyrtim këtë raport, ta mbështetni, ndërsa staf i im dhe unë do të jemi në dispozicion tuajin për çfarëdo sugjerimi apo elemente të rëndësishme të debatimit rreth këtij raporti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i komisionit, a e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Ky raport që sot po e diskutojmë është i dyti me radhë prej se kur ka filluar të funksionojë auditimi i brendshëm në institucionet e Kosovës.

Ligji për auditimin e brendshëm e përcakton obligimin për ministrin e Financave që të raportojë më së paku një herë në vit para Qeverisë dhe Kuvendit për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës.

Funksionimi efikas i këtij sistemi është në radhë të parë në të mirë të institucioneve që e formojnë auditimin e brendshëm, pra të vetë organizatave buxhetore, sepse ajo e mundëson disiplinën, efikasitetin dhe efektshmërinë më të madhe të sistemit fiskal në sistemin publik.

Raporti që sot e kemi para veti i pasqyron aktivitetet e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe është një raport i përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për auditimin e brendshëm. Në bazë të këtij raporti ne shohim aktivitetet që janë bërë në vitin 2009 në këtë lëmi dhe në bazë të raportit mund të nxjerrim konkluzion që është shtuar një aktivitet në këtë fushë në krahasim me vitin e parë, në vitin 2008, kur ka filluar të funksionojë ky sistem. Po ashtu, ka pasur aktivitet shtesë edhe në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe të akteve të tjera që ndihmojnë funksionimin e këtij sistemi. Por, ajo që na brengos më tepër në sferën e auditimit të brendshëm është se disa organizata buxhetore ende nuk i kanë themeluar njësitë e auditimit të brendshëm, kurse shumë të tjera, prej tyre 36, gati gjysma këtë shërbim e kanë me vetëm nga një auditor të brendshëm. Nga raporti i cili përshkruan angazhimet e auditimit të brendshëm në vitin e kaluar, nuk mund të nxirret aspekti kualitativ i punës ose sa ka qenë efikase, sa është rritur eficienca e menaxhmentit nëpër organizata buxhetore, por vetëm përshkruhen me numra statistikor, numra sa ka auditor, sa takime, sa vërejtje, sa rekomandime, por nuk e kemi rezultatin në menaxhimin e financave publike.

Po ashtu, në raportet e auditorit gjeneral, të cilat aktualisht po i marrim, kanë filluar të vijnë raporte individuale të auditorit gjeneral, në pjesën e veçantë të të cilave flitet për auditimin e brendshëm. Të dhënat që vijnë nga auditori gjeneral nuk pajtohen me ato çka shkruan raporti i Njesisë Qendrore Harmonizuese, pra ky raport. Në këtë raport thuhet se vetëm 3 organizata buxhetore nuk e kanë themeluar shërbimin e auditimit të brendshëm, të kontrollit të brendshëm. Ne deri sot kemi marrë më së paku 10 raporte të auditorit gjeneral, raporte individuale dhe me ato që i kemi shqyrtuar deri sot – 5 prej tyre, në të gjitha thuhet që nuk është themeluar ende, është fjala për vitin 2009, shërbimi i auditorit të brendshëm. Kjo ka qitur pak në dilemë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Megjithatë, komisioni e ka shqyrtuar këtë raport, ka vlerësuar se raporti i përmbledh të dhënat dhe i plotëson kriteret për shqyrtim dhe miratim dhe Kuvendit i kemi rekomanduar që jo vetëm të aprovohet raporti, por edhe të krijohen kushtet për një organizim sa më të mirë të auditimit të brendshëm në organizatat buxhetore, sepse kjo është në dobi të forcimit të menaxhmentit në vetë organizatat buxhetore.

Prandaj, mendojmë që është e pranueshme të aprovohet dhe të ndihmohen këto shërbime, sepse është në dobi të mbarë qeverisjes. Ky është qëndrimi i komisionit dhe njëherësh është edhe qëndrim i Grupit Parlamentar të Aleancës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës dhe është i mendimit se ky raport i përmbush kërkesat që dalin për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, respektivisht për Njësinë

Qendrore Harmonizuese të auditimit të brendshëm nga neni 8 pika 1.2 të Ligjit për auditimin e brendshëm.

Ky raport në përgjithësi pasqyron aktivitetet e auditimit të brendshëm në institucionet e Republikës së Kosovës. Ne si Grup Parlamentar e vlerësojmë këtë komunikim që po ndodh tash e dy vite në mes të Ministrisë së Ekonomisë e Financave dhe Kuvendit, sepse në këtë mënyrë ne njihemi me të arriturat dhe problemet që i ka auditori i brendshëm, e që na krijohet mundësia ne si Kuvend t'i japim përkrahje në forma të ndryshme që të ketë efektivitet dhe efikasitet në punën e auditorit të brendshëm.

Pa një auditim të brendshëm funksional nuk mund të mendohet një menaxhim i mirë i institucioneve, prandaj edhe fokusimi ynë është që auditimi i brendshëm vërtet të gëzojë pavarësinë të cilën ia garanton ligji, ashtu që të kemi një sistem efikas të kontrollit, një menaxhim të mirë të parasë publike që burimet e alokuara në sektorin publik të përdoren drejt dhe ashtu si duhet.

Nga raporti që e kemi përpara vërehet se ka përmirësime të dukshme në sistemin e auditimit të brendshëm. Zyra e Auditimit të Brendshëm është përqendruar në realizimin e planit dhe po ashtu është angazhuar në nxjerrjen e legjislacionit dhe harmonizimin e infrastrukturës ligjore dhe harmonizimin e saj me legjislacionin dhe standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, e veçanërisht duhet theksuar se ka punuar shumë në ngritjen profesionale të auditorëve, ku auditorët kanë marrë njohuri të nevojshme për të kuptuar rolin e kontrollit të brendshëm të financave publike, kanë marrë njohuri për procedurat e kryerjes së auditimit në përgatitjen e raportit, si dhe janë pajisur me certifikata për përdorimin e programit të sistemit të kontabilitetit të qeverisë.

Në krahasim me vitet e kaluara, shihet se ka përmirësim në drejtim të strukturës organizative, ku janë shtuar numri i njësive të auditivitetit, e po ashtu është shtuar edhe numri i komiteteve të auditivitetit, çka do të thotë se ka pasur, ka dhënë rezultate pozitive edhe miratimi i ligjit, i cili në një mënyrë apo në një tjetër iu përshtatet standardeve ndërkombëtare dhe ka evituar ato konfuzionet të cilat kanë ekzistuar në legjislacionin e mëparshëm.

Gjatë vitit 2009 vërehet se janë kryer 360 auditime në nivelin qendror dhe atë lokal, nga 476 auditime të planifikuara. Nuk është sinjal i mirë që realizimi i planit të auditimit është realizuar vetëm 76%. Mbetet në të ardhmen të bëhet më shumë që të realizohet plani i auditimit nga ana e auditorëve.

Nga rekomandimet të cilat janë dhënë dhe të cilat i përmendi ministri dhe s'dua t'i përmend 468 rekomandime apo diku 21.21% të rekomandimeve nuk janë zbatuar, thuhet se shkak i moszbatimit të këtyre rekomandimeve është se shumica e tyre janë dhënë në tremujorin e katërt dhe pritet që të realizohen në të ardhmen. Në raport ka qenë mirë të njohfihemi se nga rekomandimet e mbetura nga viti i kaluar sa janë realizuar dhe sa kanë mbetur të pa realizuara. Sipas raportit, menaxhmenti i lartë shihet se ka marrë veprime për implementimin e rekomandimeve, duke marrë masa ndaj zyrtarëve përgjegjës, ka nxjerrë udhëzime administrative të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve, si dhe ka përgatitur plane për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Megjithatë, konsiderojmë se është dashur të bëhet shumë më shumë që këto rekomandime të zbatohen dhe të jenë të zbatueshme nga ana e institucioneve, qoftë të atyre në nivelin qendror, qoftë të atyre në nivelin lokal.

Mbetet të punohet shumë më shumë në të ardhmen në ngritjen e kapaciteteve për një planifikim më të mirë të buxhetit, domethënë të hyrave dhe shpenzimeve ashtu që buxheti të realizohet sipas planit, që procedurat e prokurimit të bëhen sipas ligjit dhe të bëhet regjistrimi i mirëfilltë i pasurisë, sepse si

auditori i brendshëm, ashtu edhe auditori i jashtëm në vazhdimësi kanë konstatuar se ka mangësi në këtë drejtim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Raportin e Auditimit të brendshëm, duke qenë në mbështetje të vazhdueshme për të siguruar krijimin e kushteve për punë dhe për ruajtjen e pavarësisë së auditorëve të brendshëm, për t'i hapur rrugën menaxhimit të mirë të financave publike dhe për të siguruar që reforma e financave publike do të jetë më e suksesshme në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e kërkon fjalën? Fjalën e ka Anita Morina-Saraçi.

ANITA MORINA-SARAÇI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Raporti në përgjithësi prezanton zhvillimin në fushën e auditimit të brendshëm në nivelin qendror dhe lokal, aktivitetin e Njesisë Qendrore të Harmonizimit të auditorit të brendshëm dhe rekomandimet e funksionimit të auditorit të brendshëm.

Është për t'u vlerësuar pozitivisht bashkëpunimi i Njesisë Qendrore të Harmonizimit të auditimit të brendshëm me partnerët e tjerë, gjithashtu edhe ngritja profesionale e auditorëve, mirëpo gjithashtu vlerësojmë në mënyrë pozitive ngritjen e numrit të auditimeve në krahasim me vitet e kaluara dhe rritjen e personelit, do të thotë rritjen e auditorëve nëpër njësitë e auditimit, megjithatë mbetet ende për t'u dëshiruar pasi që në disa nga institucionet zyrat e auditimit funksionojnë me vetëm nga një auditor. Është ky edhe një shqetësim që është paraqitur edhe në vetë këtë raport.

Disa nga mangësitë në sistemin e funksionimit të auditimit të brendshëm desha t'i potencoj këtu, pasi që janë mangësi që po paraqiten çdoherë në të gjitha raportet e audituara, sigurisht këto në mënyrë të përmbledhur në sektorin publik, një nga to është edhe planifikimi i buxhetit të nevojshëm i cili nuk planifikohet konform planeve të auditimit dhe si rrjedhojë e kësaj na paraqitet mosrekrutimi i auditorëve të brendshëm, edhe pse në përqindje jo shumë të lartë në nivelin qendror, mirëpo përqindja është më shqetësuesja në nivelin lokal, një përqindje prej 45.45%, kjo me arsyetimin e mungesës së buxhetit, edhe pse buxheti është aprovuar dhe kërkuar dhe edhe ky rekrutim është paraparë në planet vjetore dhe strategjinë vjetore.

Gjithashtu, si shqetësim tjetër kisha për të paraqitur procesin e prokurimit, të cilat nuk udhëhiqen në përputhshmëri me Ligjin e prokurimit publik. Këtu janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur, mirëpo është një problem që na paraqitet në secilin raport të audituar, pothuaj se në secilin dhe mos t'i përfshijmë të gjitha institucionet publike, dhe mosbarazimi i raporteve financiare të organizatave buxhetore me Departamentin e Thesarit.

Në përgjithësi, raporti vlerësohet pozitivisht nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe jemi në mbështetje të rekomandimeve që janë bërë në fund të këtij raporti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputetja Gjylnaze Sylja e ka kërkuar fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Kryetar, zoti Haki Shatri ka folur në emër të Grupit, unë do të flas si deputete.

KRYETARI: Jo, më vonë pra! Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje për të gjithë!

Grupi Parlamentar i AKR-së ka shqyrtuar Raportin e auditimit të brendshëm të sektorit publik të Kosovës për vitin 2009. Duke parë që në këtë raport i gjithë raporti është në përputhje me kërkesat e Ligjit për auditim të brendshëm dhe paraqitet një analizë e mirëfilltë e auditimit të brendshëm të zhvilluar në Kosovë, mirëpo prapëseprapë mund të them se edhe ministri edhe kolegë të tjerë potencuan që çështja e auditimit të brendshëm ka ngelur ende në atë nivelin jo superior të kënaqshëm, duke parë se edhe shifrat tregojnë se deri ku ka mbërri auditimi në sektorët e caktuar për arsye të numrit jo të mjaftueshëm të auditorëve.

Duke marrë parasysh se e gjithë çështja e auditimit është çështje e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit të Kosovës, atëherë parashihen edhe parametrat të cilët janë dhënë këtu, që do të thotë se nuk kalon plani mbi 76%, që do të thotë se do të ngelet akoma punë e auditorëve për të realizuar planin 100% të çështjes së auditimit të parasë publike.

Të gjitha rekomandimet të cilat janë paraqitur në këtë raport, mund të them se do të mbesin akoma në të ardhmen që mund të realizohet funksionimi i auditimit të brendshëm në atë mënyrë që të bëhet transparente paraja publike në shtetin tonë për arsye se, në rast se nuk jepet një mundësi e menaxhimit më të lartë të organizatave buxhetore dhe shpenzimet e parasë publike, atëherë vjen në shprehje keqpërdorimi i parasë publike, gjë që treguan rastet e fundit më së miri.

Në përgjithësi, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë raport dhe shpreson që në të ardhmen rekomandimet të cilat janë paraqitur këtu të realizohen 100%. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, për deputeten Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht kur trajtojmë dhe shqyrtojmë raporte, unë mendoj se Kuvendi duhet të ketë si objektiv dhe si synim t'i arrijë disa objektiva apo disa qëllime të cilat vërtet nuk e di nga ky Kuvend a janë prioritet apo vetëm janë formale sepse, si duket, edhe shqyrtimi edhe trajtimi i raportit nga ky Kuvend sikur e ka humbur kuptimin dhe po trajtohen vetëm sa për t'u përmbushur një kriter, ndërsa më tutje nuk po vazhdohet.

Është rasti më i freskët me raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, raport i cili u shqyrtua nga ky Kuvend, nuk e mori notën pozitive, u vlerësua me një notë negative dhe vërtet nuk po ndërmerret asgjë ndaj atij institucioni. Prandaj, edhe e shtroj si dilemë – a kemi nevojë të trajtojmë raporte dhe të mos ndërmarrim asgjë.

Si do që të jetë, kjo ishte një hyrje, e tash do ta them qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Konsiderojmë se roli dhe funksioni i auditorit të brendshëm është i një rëndësie të veçantë dhe ndër të tjera ka si qëllim që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë veprimet e organizatës në përmbushjen e objektivave të saj për përmirësimin e efikasitetit të procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Raporti për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë është një raport i shkurtër, i përmbledhur dhe përmbajtjesor. Ka sqaruar në mënyrë të përmbledhur të gjitha aktivitetet e auditorëve të brendshëm në sektorin publik dhe, si të tillë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e vlerësojmë dhe mendojmë se është pozitiv dhe duhet ta përkrahim. Nuk kemi nevojë ndoshta ne si deputetë ta komentojmë raportin, sepse të gjithë e kemi pasur para veti dhe të flasim për shifrat, mirëpo është e rëndësishme të jepet mendimi kritik rreth këtij raporti që, në fakt, në këtë Kuvend nuk po ndodh.

Si do që të jetë, shqetësim i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike mbetet çështja e mos implementimit të rekomandimeve të auditorëve të brendshëm nga ana e institucioneve të Kosovës. Gjithashtu, për çdo kritikë është edhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, e cila për vitin 2009 nuk ka pasur të angazhuar auditorët e brendshëm, Ministri kjo e cila ka shfrytëzuar pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës nga pozicioni i investimeve kapitale dhe krejt kjo është bërë pa një kontroll dhe pa një mbikëqyrje të auditorit të brendshëm. Kjo është çështje që duhet trajtuar dhe ka nevojë Kuvendi të debatojë më tutje.

Do të përmend diçka nga të gjeturat e auditorëve të brendshëm gjatë auditimit të tyre nëpër institucionet e Kosovës, duke filluar nga Presidenca, Kuvendi, Qeveria, komunat, institucionet e pavarura e tjera. Kjo njëherësh tregon në njëfarë mënyre performancën e këtyre institucioneve. Ajo që duhet të theksohet, është faqja 17 dhe ju sugjeroj të gjithë qeveritarëve dhe anëtarëve të Kuvendit që të fokusohen për këtë pjesë dhe të gjeturat e auditorëve. Buxheti jo gjithëherë është shfrytëzuar në bazë të planifikimit. Ne sot jemi para një faze kur po rishqyrtojmë dhe po bisedojmë për buxhetin dhe po ia japim formën e ligjit dhe vërtet auditori ka konstatuar një gjendje tjetër. Edhe pse ky Kuvend ia jep formën e ligjit, prapëseprapë buxheti menaxhohet në mënyrën qysh donë institucionet sepse nuk e përfillin Ligjin mbi buxhetin.

Tjetra. Proceset e prokurimit në disa raste nuk janë udhëhequr në pajtueshmëri me Ligjin e prokurimit publik. Edhe ky është një konstatim dhe vërtet do një shqyrtim dhe do një debat në vete, sepse nëse nuk respektohen ligjet që ne vetë i miratojmë, atëherë çfarë kemi nevojë të punojmë me ligje, apo të themi se duhet të punojmë pa përfilljen e ligjeve.

Një e gjetur tjetër është se jo gjithëherë barazohen raportet financiare të organizatave buxhetore me raportet e Departamentit të Thesarit dhe kjo më tepër për ministrin për Ekonomi e Financa.

I nderuari ministër, a është kjo çështje shqetësuese dhe a ka nevojë kjo për një debat? Nëse po, ju ftoj nga ky Kuvend që ta ngritni këtë çështje në Kuvend, të kërkonit debat ju si ministër, para se ta kërkojmë ne si deputetë, sepse këtu flitet haptas dhe qartas për keqpërdorim dhe keqmenaxhim të parasë publike. Kemi një mospërputhje të raporteve financiare nëpër institucione dhe kemi një institucion tjetër që është Departament i Thesarit, institucioni i fundit, institucioni më perfekt që duhet, vërtet, nëse këtu nuk përputhen pasqyrat financiare, atëherë nuk di çka të kërkojmë më tepër.

Në disa raste transaksionet financiare nuk regjistrohen nëpër kode adekuate. Edhe kjo për juve, zoti ministër, duke e njohur mjaft mirë këtë lëmi, është një çështje mjaft shqetësuese, sepse ndërrimi i destinacionit të mjeteve, ndërrimi i kodeve edhe kjo është një çështje që duhet të ndëshkohet me ligj.

Është rekomandimi tjetër për menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë që vërtet kjo nuk po ndodh, edhe 10 vite pas ndërtimit të shtetit ne nuk po arrijmë ta regjistrojmë pasurinë tonë nëpër institucione dhe vërtet nuk e di pse po ndodh kjo. Një çështje shumë e lehtë, shumë e thjeshtë dhe një trajtim jo serioz ndaj çështjes. Mandej, nuk zbatohen udhëzimet për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare dhe

kjo nuk do koment. Unë do ta lë me kaq, këtë që e ka thënë auditori, sepse nuk ka nevojë të komentohet më tutje.

Dhe, çështja e fundit, është rekrutimi i stafit dhe pajisja me kontrata në disa raste nuk bëhet në bazë të procedurave ligjore. Edhe kjo është një çështje që nuk do koment. Për të gjitha këto rekomandime, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë për këto të gjetura jemi të shqetësuar dhe kërkojmë që të debatohet në Kuvend në një seancë të radhës, sepse raportin e mbështesim, është një raport shumë i mirë, shumë i shkurtër dhe përmbajtësor, që e thamë edhe në fillim, mirëpo këto çështje dhe të gjeturat e auditorit duhet të debatohen në këtë Kuvend. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Rapor genelde merkezi ve yerel düzeyde iç denetim alanındaki gelişmeleri, iç denetimin uyumlaştırılmasına yönelik merkez biriminin faaliyetlerini, Kosovanın kamu sektöründe iç denetim sisteminin işlevliliğine yönelik düşünce ve önermelerini yansıtmaktadır. Kosova Hükümetinde iç denetim bağımsız olarak yürütülür, iç denetim sisteminin işlevliliği alanında en önemli aktörleri iç denetim birimi, iç denetleyiciler, denetim kurulu, yüksek yürütme organı ve iç denetimin uyumlaştırılmasına yönelik merkezi birimdir. Bu Rapor, İç Denetim Yasasının ihtiyaçlarıyla uyumlu olarak hazırlanmış, aynı zamanda 2009 yılında Kosovada iç denetim faaliyetlerinin analizini yansıtmıştır. Rapor iç denetimin uyumlaştırılmasına yönelik merkezi birimi tarafından ikinci yıllık rapordur. Öyleki Hükümet, Kosova Meclisi ve Genel Denetleme Dairesi, Kosova Meclisi ve Dairenin 2009 yılı boyunca Kosova Hükümetinde gerçekleştirilen iç denetimin faaliyetlerini ve gelişmeleri hakkında bilgi sahibi olma fırsatında bulunmuştur.

Dolayısıyla “7+” Parlamenter Grubu Raporu desteklemektedir.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nga grupet tjera parlamentare nuk kemi të paraqitur për diskutim. Vazhdojmë me deputetët e paraqitur. Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

REXHEP HOTI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Më lejoni t’i paraqes disa vërejtje rreth Raportit mbi auditimin e brendshëm të sektorit publik të Kosovës për vitin 2009.

Pika 5.3.4, Bashkëpunimi i Njesisë Qendrore për Harmonizimin e auditimit të brendshëm me auditorin e përgjithshëm dhe me partnerët relevantë. Është mbajtur vetëm një takim me ZAP-in, ku kanë marrë pjesë edhe drejtorët e auditimit të brendshëm dhe nuk kanë qenë fare frytdhënëse dhe me plotë kritika për Zyrën e Auditimit të Përgjithshëm për mosbashkëpunim, andaj në bazë të informacionit që kam nga njësitet e auditimit të brendshëm për ministritë, bashkëpunimi me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm edhe në periudhën audituese është shumë i mangët. Sugjeroj që Njësia Qendrore për Harmonizimin e auditimit të brendshëm, Zyra e Auditorit Gjeneral dhe Njësiti i Auditimit të Brendshëm, por edhe të organeve tjera shtetërore, policia për krime ekonomike, prokuroria të kenë një bashkëpunim të rregullt në koordinim të veprimeve për një efikasitet më të madh në respektimin e ligjeve dhe të ligjshmërisë.

Pika 6. Aktiviteti i auditimit të brendshëm në Qeverinë e Kosovës për vitin 2009. Duhet të bëhet përpjekje për funksionalizimin e njësive të auditimit të brendshëm me ato të institucioneve qeveritare dhe lokale, ku mungojnë, gjë që është edhe një obligim ligjor, si dhe institucionet komunale, veçanërisht në komunat serbe dhe në komunat e krijuara me procesin e decentralizimit.

Pika 6.1. Funksionimi i njësive të auditimit të brendshëm. Nga këto pika, nga tabela, paraqiten, shihet që mbi 90% 41 institucione nga gjithsej 50 të njësive të auditimit nëpër institucione përbëhen nga 1 deri 2 auditorë. 33 institucione përbëhen vetëm nga 1 auditor.

Duke marrë parasysh Udhëzimin administrativ numër 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, neni 3 paragrafi 2 mbi kriteret për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, nënshkruar nga ministri i MEF-it, ku janë përcaktuar stafi i njësive. Në bazë të buxhetit që kanë institucionet, konsideroj se shumica e këtyre institucioneve kanë buxhet mbi 5 milionë euro, prandaj Njësia Qendrore për Harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të bëjë përpjekje të menaxhmentit të këtyre institucioneve të Republikës së Kosovës që të rritet numri i auditorëve, në mënyrë që të vendoset një efikasitet më i lartë operacional në menaxhimin e parasë publike dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve që iu ofrohen qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pika 6.3. Auditimet e kryera gjatë vitit 2009. Shihet se në nivelin qendror janë kryer 360 auditime të brendshme, kanë dhënë 2207 rekomandime, janë implementuar 1215 ose 55.05%, që nuk është punë e kënaqshme pavarësisht që kemi një rritje në këtë drejtim. Është bërë një traditë shumë monotone kur ministrat, edhe pse nuk kanë realizuar pika shumë të rëndësishme të auditimit, dalin dhe thonë – kemi marrë një auditim shumë real e gjëra tjera. Madje, në këtë pikë e kisha ftuar opozitën këtu që të ketë një syçeltësi më të madhe dhe t'i shikojë ato gjëra konkretisht dhe të dëshmojë cilat pika janë realizuar dhe cilat nuk janë realizuar. Kjo është detyra e tyre. Prandaj, sugjeroi që Njësia Qendrore për Harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe Zyra e Auditimit Gjeneral që t'u jep përkrahje njësive të auditimit të brendshëm dhe të kërkohet llogari nga menaxhmenti i lartë i institucioneve buxhetore për mos implementimin e tyre. Nga ky numër i madh i auditimeve dhe rekomandimeve të dhëna, 2207, shumica e tyre janë të paraqitura si devijime procedurale ndaj administratës ligjore. Konsideroj që në menaxhmentet e këtyre institucioneve janë vërtetuar të gjetura në kundërshtim me legjislacionin dhe rregullat në fuqi.

Pika 6.5. Funksionimi i komiteteve të auditimeve. Edhe pse nga viti 2008 në 2009 kemi një rritje të numrit të komiteteve të auditimit prej 29.17% në 61.02%, institucionet me komitetet shihet se nuk është nivel i kënaqshëm sepse komitetet e auditimit shërbejnë si organe këshillëdhënëse për menaxhmentin e lartë dhe janë mbështetëse e fortë për implementimin e autoritetit të brendshëm, por edhe të auditorit gjeneral. Në bazë të raportit shihet se institucionet si Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale, Universiteti i Prishtinës, Komisioni për Miniera dhe Minerale, agjencionet tjera si i Privatizimit, i Pronës, Publik e tjera, nuk i kanë formuar ende komitetet e auditimit dhe konsideroj se kjo është një neglizhencë e madhe dhe në kundërshtim me Ligjin mbi auditimin e brendshëm nga menaxhmentet e këtyre institucioneve. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet deputetja Sanije Aliaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve!

Shikoni, në aspektin e pranimi apo mospranimi të këtij raporti, sa i përket Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e pranojmë si raport dhe shihet në treguesit, nga ky raport del se ka përparime të mëdha në procesin e auditimit, që tregon vetë raporti si në aspektin e ngritjes profesionale të auditorëve, si në aspektin e ngritjes së numrit të tyre, si në aspektin e bashkëpunimit. Mirëpo, mua më shtyri diçka tjetër këtu të dal, të tregoj sfidën kryesore të auditimit që është sot në Kosovë. Faktikisht, sfida që sot është për shfrytëzimin apo harxhimin e parasë publike është si ajo të shfrytëzohet me efikasitet, si të shfrytëzohet me efektivitet dhe me besueshmëri. Këto tri parime, në fakt, nuk e ka për detyrë auditori t'i realizojë dhe auditori nuk e ka detyrën e kontrollit në aspektin e menaxhimit financiar. Jo. Sfidë kryesore qëndron sot në raportin midis auditorit, në njërin anë, dhe menaxhimit financiar në agjencionin buxhetor. Menaxhimi financiar, respektivisht personeli apo udhëheqësit apo shefat e menaxhimit financiar në agjencinë buxhetore ata e kanë për obligim të shfrytëzojnë paratë publike me efikasitet dhe efikasitet, ndërsa auditori e ka vetëm një detyrë – respektohet rregullativa ligjore apo nuk respektohet. Pikë. S'ka kurrëgjë tjetër. Në këtë drejtim, tash nëse e shikojmë këtë, sot shumë keq interpretohet qoftë nga përfaqësuesit e agjencioneve buxhetore në nivel qendror, që janë ministrinë, qoftë nga agjencionet buxhetore në nivel lokal, që janë komunat apo të tjera, sot mundohet të mbulohet mosshfrytëzimi apo shfrytëzimi racional i këtyre mjeteve me daljen e raportit të auditimit, është auditor i mirë, ka dalë keq apo mirë. Auditori ka për detyrë, në fakt, vetëm të shih rregullativa ligjore a është respektuar. Jo menaxhimi a është efikas apo efektiv. Mua më befasuan sot edhe disa kolegë të mi të branshës në këtë kuptim. Mirëpo, çka po del nga sfida? Sot ne kemi një sfidë të madhe në Kosovë të shfrytëzimit të mjeteve publike. Faktikisht, sfida kryesore qëndron tash këtu: cili është raporti midis auditorit, në njërin anë, dhe menaxhimit financiar, respektivisht udhëheqësit të agjencisë? Me qëllim ligji e ka rregulluar këtë çështje. Është fjala për komitetin e auditimit, se komiteti i auditimit e ka për detyrë të bëjë komunikimin respektivisht bashkëpunimin intensiv midis agjencionit buxhetor, në njërin anë, dhe auditorit, në anën tjetër, por kjo nuk është duke u shfrytëzuar.

Vetë fakti sot që në agjencionet buxhetore, qoftë në komuna, qoftë në ministri, qoftë të tjera, ekziston vetëm një auditor dhe ai auditor e ndien si punëdhënësi shefin e menaxhimit financiar, tregon se ai nuk ka pavarësi. Dhe vetë fakti se ai kur nuk ka pavarësi, ai është i obliguar, sepse e merr pagën në atë agjencion, ai është i ndikuar politikisht, ai është i ndikuar profesionalisht e shumëçka tjetër. Këtu po shihet në raport se është aprovuar respektivisht është përdorur doracaku. Vërtet doracaku nga aspekti i ngritjes profesionale të auditorëve jep rregulla strikte dhe japin fakte pozitive. Mirëpo, ka shumë për t'u bërë në procesin e auditimit.

Deri sa ne nuk e kuptojmë këtë institucion si një institucion të pavarur që, në fakt, mbron rregullativën ligjore, mbron sistemin, e në anën tjetër agjencionin buxhetor, që e ka për obligim dhe të drejtë t'i shfrytëzojë financat publike, faktikisht nuk kemi suksese. Unë ju falënderoj dhe më falni se ndoshta e zgjata!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj, le të përgatitet deputeti Driton Tali, i fundit i paraqitur për debat.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Konsideroj se shqyrtimi i Raportit të funksionimit të sistemit të auditorit të brendshëm kërkon një vëmendje më të madhe nga ana e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse në këtë raport pasqyrohen përveç të arriturve dhe rritjes së numrit të auditimeve në organizatat buxhetore,

pasqyrohen si cilat organizata buxhetore kanë qenë në nivel të përgjegjësive për të ofruar raporte auditimit të brendshëm dhe cilave organizata buxhetore në nivelin qendror dhe në nivelin lokal iu kanë ofruar më shumë rekomandime nga auditori i brendshëm.

Raporti për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Republikës së Kosovës, për vitin 2009, prezanton zhvillimet në fushën e auditimit në nivelin qendror dhe lokal. Raporti i plotëson standardet, është i përgatitur në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për auditimin e brendshëm, duke paraqitur një pasqyrë për të gjitha aktivitetet dhe zhvillimin e auditimit të brendshëm si pjesë e sistemit të plotët të kontrollit të brendshëm në sektorin publik.

Njësia Qendrore Harmonizuese e auditimit të brendshëm punën e vet e mbështet në planin e punës dhe në strategjinë e funksionimit të auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm është realizuar në këto fusha në proceset buxhetore, në fushën e shpenzimeve, menaxhimit të hyrave, parasë së gatshme, prokurim, menaxhimit të pasurisë, listën e pagave dhe përdorimin e veturave tjera.

Auditimi i brendshëm rrit efikasitetin dhe funksionimin më të mirë të organizatave buxhetore për menaxhimin e financave publike. Auditori i brendshëm ka realizuar 360 auditime nga 473, sa ishin të planifikuara, apo 70% të planit të auditimit. Tabela numër 1 e raportit pasqyron se në bazë të njësive të auditimit, auditimi i brendshëm është realizuar në 59 organizata buxhetore dhe ka rritje për 18%, krahasuar me vitin 2008. Auditimet e kryera gjatë vitit 2009, krahasuar me planin e auditimit, për të njëjtin vit ka rritje 23% në të dy nivelet e institucioneve.

Vlerësoj se rritja numrit të auditimeve si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal është rezultat i rritjes së numrit të auditorëve për 15%, por përkundër rritjes së auditorëve të brendshëm, ka një rënie të numrit të femrave në fushën e auditimit.

Njësia qendrore për harmonizimin e auditimit të brendshëm prej 59 njësive të auditimit të brendshëm ka pranuar 56 raporte ose shprehur në përqindje – 95%.

Njësitet e auditimit që nuk kanë raportuar janë, merrni me mend kolegë të nderuar, Agjencioni Kosovar i Pronës dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit, dy agjencionet kryesore që kanë rol shumë të madh për menaxhimin e pronës në Republikën e Kosovës. Këto nuk janë të gatshme t'i ofrojnë auditimit të brendshëm raporte, por deklarohen se do të afrojnë këto raporte për vitin 2010, prandaj edhe e kanë këtë vëmendje kolegët tanë.

Përkundër rritjes së numrit të auditorëve, krahasuar me planifikimin, ende mungojnë burimet e mjaftueshme për auditim të brendshëm më efektiv në konsolidimin e rolit të auditimit të brendshëm, duke motivuar dhe stimuluar auditorët përmes përkrahjes, sigurimit të kushteve dhe pavarësisë në punë, se në bazë të raportit edhe pavarësia e plotë në punë nuk dominon te këta.

Numri më i madh i rekomandimeve nga auditori i brendshëm për institucionet e nivelit qendror i janë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Merre me mend, rekomandimet Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili kërkon përgjegjësitë nga të gjithë kryetarët dhe gjyqet e Kosovës. Ai ka nevojë për 94 rekomandime për të qenë funksional dhe në nivel të përgjegjësive. Kurse në nivelin lokal numri më i madh i rekomandimeve i është drejtuar komunës së Suharekës, Rahovecit dhe Lipjanit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht Ministria për Ekonomi e Financa, që ministri s'paska pasur durim të qëndrojë këtu, duhet të kërkojë që organizatat buxhetore të sipër përmendura të jenë në nivel të detyrave dhe përgjegjësive për të realizuar objektivat e tyre të programuara dhe të menaxhojnë mirë me buxhetin që i është ndarë nga buxheti i Kosovës.

Raportin e përkrah sepse eviton parregullsitë dhe rrit efikasitetin për realizimin e objektivave programore në institucionet publike, duke ofruar rekomandime dhe konkluzione konkrete. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pak siklet kështu, ne të fundit, sepse të gjitha ato fjalët e mira e të mençura po i thonë kolegët tanë paraprakisht dhe po na mbesin neve shumë pak për të thënë.

Unë do të ndalesha te faqja 17, sepse u thanë, ndonëse kolegja Synavere Rysha, kolegja e nderuar, i përmendi apo i hyri kështu shkarazi kësaj... Do të ndalesha te të gjeturat dhe po i numëroj, disa më interesante. Thotë, buxheti jo gjithë herë është shpenzuar në bazë të planifikimit. Mbase edhe nuk është një krim i madh kjo. Pastaj vazhdon, proceset e prokurimit në disa raste nuk janë udhëhequr në pajtueshmëri me Ligjin e prokurimit publik, nëse e përkthejmë në gjuhën tonë, kjo i bie – hajni.

Jo gjithëherë barazohen raportet financiare të organizatave buxhetore me raportet e Departamentit të Thesarit. Kjo i bie, edhe më shumë hajni, nëse e përkthejmë.

Në disa raste, transaksionet financiare nuk regjistrohen nëpër kode adekuate, gjithqysh mund t'i thuash kësaj. Në disa raste nuk ka regjistrim të mirëfilltë të pasurisë, nuk zbatohen udhëzimet për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, që është në kundërshtim me atë që kjo Qeveri apo ky koalicion jo parimor, jo i natyrshëm, pati premtuar me razmitaz kur erdhi në fuqi. Dhe të gjitha, siç thotë këtu, janë domethënë auditim i brendshëm vetëm për menaxhmentin e lartë të organizatave buxhetore. Domethënë, jo për zyrtarët e imtë, por për menaxhmentin e lartë. Dhe kur ta lexosh këtë, deshe s'deshe të bie në mend, mbase disa edhe e kanë harruar, ka qenë njëfarë Theo Jakobs, një prokuror i famshëm i EULEX-it, i cili në shtator të vitit të kaluar pati pas premtuar se kah dhjetori i vitit 2009, më së largu janari 2010 peshqit e mëdhenj do të përgjigjen. Pastaj ... njëfarë Van Vresfik, apo van Vrefsjak, se na ka qitë probleme, s'po dimë t'ia theksojmë emrin, edhe ky goxha ia dha kosës gjanë, tash kohën e fundit ia ka nisë edhe ky të na kallëzojë përralla, thotë jo në shtator, më së largu në marsin apo shtatorin e vitit 2011 qind për qind, i skadon edhe afati i kontratës atij deri atëherë. Iu merr do pare, si Theo Jakobs dhe s'bën kurrëgjë hiq, neve na shesin mjegull. Po atë që desha t'ia them gjeneralit të respektuar, Iv de Kermabo, se publikisht në televizor pat dal, me gojë të veten pati thënë – mos më jepni llafë, mos më jepni fjalë, por prova, fakte. Nëse këto s'janë fakte, zoti Iv de Kermabo, s'di se çka do të jenë faktet. Nëse ai pret...

KRYESUESI: Ju lutem, përmbajuni, jemi në raportin e auditimit!

DRITON TALI: ... Krejt në raport jam, në raport jam, zoti kryesues! Krejt në raport jam duke folur, të auditimit të brendshëm dhe jam kah e përmendi zotin Iv de Kermabo, që është shefi mbi ministrin e Drejtësisë, i cili domethënë edhe është përgjegjës për këtë auditim. Ai është fjala e fundit. Sa herë që s'del auditimi i mirë, aty ka hajni, ka korrupsion dhe zoti Iv de Kermabo paguhet ta luftojë korrupsionin në Kosovë së bashku me këtë Van Vrefcik a Vrefcjak, se ai Theo Jakobs na dha fjalë,

por iku pa bërë kurrë hiq?! Tash edhe qe ky Vrecfjak a Vrecfik a Vrecfraik, edhe ky veç është kah na jep fjalë. Faleminderit! Le ta lexojnë në faqën 17 të këtij auditimi dhe do të kenë fakte të bollshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! Vazhdojmë me diskutuesen e fundit të paraqitur, deputeten Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E para, mendoj se ministri erdhi dhe na mbajti një fjalim kështu, në mënyrë si ministër turist dhe pastaj shkoi. Mendoj që është jo serioze dhe pa përgjegjësi të mos i dëgjojë deputetët. Mbase kaq i intereson auditimi i brendshëm.

Sa i përket raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009, është një përgjegjësi që kërkohet nga vet Ligji për auditimin e brendshëm. Në përgjithësi, raporti e ka një masë vlerësuese, që krahasimi bëhet kryesisht me të arriturat në vitin 2008, krahasuar me vitin 2009. Dhe, sipas këtij raporti, bien që ka pasur të arritura, sidomos në shtimin e numrit të njësive të auditimit, pastaj edhe të komitetit të auditimit, të shtimit të numrit të auditorëve dhe të numrit të auditimeve.

Megjithatë, është e qartë se të gjeturat për të cilat folën dy koleget e para më herët, tregojnë se ka keqpërdorime dhe unë nuk do të vazhdoj për t'i paraqitur këtu, por është e qartë se nuk po arrin qëllimin për çka është krijuar sistemi i auditimit të brendshëm. Realisht se ai nuk po funksionon në nivelin që duhet, ashtu që të sigurojë se do të kemi një menaxhim efikas të parasë publike.

Sipas të arriturave kryesore, krahasuar me vitin 2008, është në të vërtetë dekretimi i vet Ligjit për auditimin e brendshëm, udhëzimet e ndryshme administrative, pastaj ngritja profesionale e auditorëve të ndryshëm, gjegjësisht rritja e kapaciteteve të auditorëve.

Megjithatë, të dhënat nga raporti tregojnë se 95% të njësive të auditimit të brendshëm kanë raportuar në Njësinë Qendrore për Harmonizimin e auditimit të brendshëm, pos Njesisë së Agjencionit Kosovar të Pronës, Agjencionit Kosovar për Privatizim dhe komunës së Shtërpçës, që thuhet se do të raportojë në vitin 2010.

Megjithëkëtë, shqetësuese është se Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit nuk ka pasur auditim të brendshëm që nga tremujori i tretë i vitit 2009, sepse thuhet në raport se ky auditor ka shkuar në KEK, ku ka pasur një pagë më të madhe. Nëse është kështu, do të thotë se nuk kemi auditim të një njësie të organizatës buxhetore, e cila ka marrë pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës. Tjetra është se pasqyrat të cilat janë paraqitur për vitin 2009, kanë treguar një rritje të vetë njësive të auditimit, diku prej 18%, kurse të komiteteve për 29%. Rekomandimet të cilat i kanë dhënë auditorët, nuk janë përmbushur plotësisht. Po ashtu, ka pasur trajnime të ndryshme dhe, siç e përmendi ministri, ende shkon periudha e certifikimit ndërkombëtar meqenëse ka pasur mbështetje edhe nga organizatat ndërkombëtare, sidomos Komisioni Evropian.

Unë jam e mendimit se rekomandimet të cilat i ka paraqitur auditori i brendshëm, gjegjësisht rekomandimet që janë dhënë nga ky raport, duhet të mbështeten sidomos nga Kuvendi i Kosovës, sepse ka të bëjë me fuqizimin e mëtejshëm të sistemit të auditimit të brendshëm. Këto rekomandime kanë të bëjnë me përmbushjen e përgjegjësiave ligjore, që kërkojnë të gjithë sektorët publikë të kenë njësi të auditimit, të rritet numri i auditimeve dhe të stafit, pastaj të sigurohen kushtet për punën e

auditorëve, të krijohen komitetet e auditimit dhe sidomos të ketë një përkushtim më të madh të menaxhmentit në kontrollin e brendshëm, në transparencë dhe llogaridhënie.

Të nderuar deputetë, që raporti mos të mbetet veç fjalë, që mos të vijë ministri dhe të na mbajë një fjalim dhe të shkojë pa asnjë përgjegjësi, unë i propozoj Kuvendit që përmes komisionit funksional të sigurojë se rekomandimet të cilat janë dhënë në vetë raportin, por edhe nga vetë deputetët të plotësohen dhe pastaj ato t'i përcillen seancës dhe të diskutohet ashtu që të sigurohemi se ky raport do të arrijë qëllimin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Meqë të paraqitur tjerë për diskutim nuk kemi, lus regjinë që me zile të ftojë deputetët, edhe dy deputet na duhen për të pasur kuorumin për votim të këtij raporti. Do të thotë, tani kemi numër të mjaftueshëm për votim. Në sallë janë prezentë 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 7 abstenime dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009, me rekomandimet e komisionit funksional.

Meqë kemi edhe 3 pika të rendit të ditës...

(Reagime në sallë)

Atëherë, në emër të grupeve, keni propozim? Vazhdojmë, edhe pse ishte edhe një mundësi. Vazhdojmë me pikën e radhës, pika e dymbëdhjetë:

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin, për shqyrtim dhe miratim.

Sipas radhës, në emër të komisionit funksional, nuk ka të paraqitur. Në emër të grupeve, nuk ka. Atëherë, vazhdojmë me votimin... Ndërkohë është paraqitur për diskutim, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pas vlerësimit negativ që i është bërë sistemit të prokurimit në Kosovë nga ana e Komisionit Evropian, Qeveria e Kosovës me datën 11.2. lidhur me reformën e sistemit të prokurimit publik ka vlerësuar gjendjen, si vijon. Unë e kam materialin që është diskutuar në Qeverinë e Kosovës dhe është aprovuar.

Perceptimi i aktiviteteve të prokurimit në Kosovë është në nivelet më të ulëta deri më tani. Korniza ligjore dhe institucionale ka nevojë për ndryshime drastike. Çdo kontratë apo ankesë që këshilltarët e partneritetit publik të Bashkimit Evropian e kanë shikuar, ka treguar shkelje të procedurave

standarde të prokurimit dhe të Ligjit të prokurimit publik. Furnizuesit ngurojnë të ankohen nga frika se do të përjashtohen nga tenderët e ardhshëm.

(Ndërhyrje)

Është material i Qeverisë, i aprovuar në Qeveri. Nëse ata kanë rrejt, po rrej edhe unë.

(Reagime)

Ndjekjet aktive të shkeljeve janë të ulëta...

KRYESUESI: Zoti deputet, e kemi në rend dite emërimin, jo raportin.

HAKI SHATRI: Pikërisht për këtë, për prokurimin është fjala dhe për... Zoti kryesues, jam duke folur në emër të Grupit Parlamentar.

Zyrtarët e prokurimit, thotë në material, vuajnë nga presioni dhe ngacmimet që u bëhen atyre nga oficerët e lartë në organizatën e tyre për të prodhuar rezultate të caktuara për tenderët.

Më tutje, pas plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për prokurimin publik, është themeluar një organ që quhet Organi Shqyrtues i Prokurimit, bordin e të cilit e ka propozuar Qeveria dhe Kuvendi e ka emëruar. Por, çka ka konstatuar vetë Qeveria për organin shqyrtues dhe bordin të cilin e ka propozuar vetë struktura e kësaj qeverisje, flet i njëjti material dhe nuk ka nevojë që të rilexohet apo që të plotësohet, sepse veç është e kuptueshme. Sot Qeveria, në kundërshtim me rekomandimet e veta për Bordin e KRPP-ës propozon kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kushtet në bazë të nenit 86.3 të Ligjit për prokurimin publik. Pra, njerëz që nuk disponojnë certifikatë që dëshmon që kandidatët ose konkretisht zonja e propozuar në vendimin e Qeverisë, nuk e ka asnjë ditë punë, as përvojë as dokument që ka punuar në procedurën e prokurimit publik.

(Ndërhyrje)

Jo, ligji nuk parasheh standarde. Ligji parasheh... ju lutem, ligji parasheh rregulla dhe kriteret profesionale. Nuk jemi kundër që dikush nga komunitetet tjera pakicë të jetë anëtar i bordit, por jemi që të respektohen kriteret e parapara me ligj, kriteret e profesionalizmit.

Më tutje, Qeveria ka propozuar një kandidat, i cili deri ditën që është propozuar ka qenë kryetar dege i PDK-së në Therandë. Që të jemi korrekt, ky kandidat i plotëson kriteret e përshtatshmërisë profesionale, por është i ngarkuar me politicizëm dhe ky organ rrezikohet që të politizohet. Ju lutem...! Mirë, mirë...! Ju lutem, zoti kryesues, nëse s'jeni në gjendje të mbani rregull në sallë, mbylleni seancën.

KRYESUESI: Vazhdoni, zoti deputet!

HAKI SHATRI: Të nderuar deputetë, Sistemi i prokurimit në Kosovë funksionon që nga themelimi i organeve të përkohshme, pra nga viti 1999. Ne kemi sistem të prokurimit, kemi edhe njerëz të cilët janë përgatitur për të kryer këtë punë në mënyrë profesionale dhe të mirë dhe po ashtu kemi shpenzuar shumë para për përgatitjen e tyre profesionale dhe përgatitjen e shumë njerëzve në terren nëpër organizata buxhetore që ta kryejnë këtë punë mirë.

Unë, bashkë me mendimin tim, është edhe Grupi Parlamentar i Aleancës. Si është e mundur që një strukturë e cila është vlerësuar pozitivisht nga Komisioni Evropian, nga vetë Qeveria që ka funksionuar mirë, të shmanget, të hiqet nga lista e kandidatëve dhe të propozohen njerëz tjerë të cilët përveç njerit, njerëz tjerë të cilët nuk kanë ndonjë dëshmi për ndonjë profesionalizëm dhe për ndonjë përmbushje të kriterit të ligjit. Pra, Qeveria me këtë po e shkel Ligjin për prokurimin publik, po e shkel aspektin e profesionalizmit dhe po rrezikon që edhe ai institucion që ka funksionuar mirë të shndërrohet në një institucion të ngjashëm me OSHP-në i cili ka marrë kritikën më të mëdha në lëmin e prokurimit. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës kërkon që ky vendim të tërhiqet nga Qeveria ose t'i kthehet, ata të na propozojnë kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret morale, profesionale dhe ligjore dhe ne do ta përkrahim në atë rast. Përndryshe, jemi kundër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Meqë është fjala për një rekomandim edhe të komisionit, e ka kërkuar fjalën kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues! Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin që e ka bërë Qeveria për emërimin e 3 anëtarëve në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës e ka shqyrtuar, po them sinjerisht, me një seriozitet shumë të madh dhe nga asnjë anëtar, nga asnjë anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk ka pasur një vërejtje të caktuar lidhur me një kandidat që ka qenë i propozuar. E vetmja vërejtje që është përmendur, është përmendur një vërejtje – një kusht i paplotësuar që ka informacione se edhe ai kusht pas një jave do të plotësohet, se ka qenë nëpër ato trajnimet dhe certifikimet kandidati, është fjala për Silvana Nikollçeviq dhe ne kemi pasur këtë fakt parasysh dhe edhe përkundër këtij fakti, ne kemi propozuar dhe duhet të jetë në këtë bord edhe për shkak të asaj që u tha këtu, se vërtet duhet të plotësohen edhe standardet, edhe ato që i kemi marrë përsipër. Ne nuk jemi duke folur për aktivitetin e prokurimit publik, as për ambientin e prokurimit publik, as për nivelin e prokurimit publik, ne jemi duke folur për të zgjedhur 3 anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, që të gjitha prokurimet janë ndaluar deri më tani për shkak të mungesës së këtyre 3 anëtarëve. Nga këta anëtarë, ka anëtar që njëri prej tyre është zgjedhur në kohën kur zoti Shatri ka qenë ministër dhe nëse ky dyshon në vlerat e tij, atëherë është çështje e tij, nuk është dashur atëherë të vendoset, ndërsa sa u përket dy të propozuarve tjerë, ju lutem, ligji është respektuar në plotshmërinë e vet dhe unë thërras deputetët e Kuvendit që të votojnë dhe të mos diskutojmë rreth kësaj çështjeje.

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit!

I nderuar zoti Gani, unë nuk kam folur për Ilaz Dulin, unë kam thënë - bordi ekzistues i derisotëm e ka dhënë provimin, sepse e ka vlerësimin pozitiv prej Komisionit Evropian. Aty hyn edhe Ilaz Duli. Unë kam folur për kandidatin e cila nuk e ka certifikatën që është e certifikuar nga IKAP-i dhe kam folur për kandidatin tjetër i cili ka ardhur direkt prej politike. Kjo ishte vërejtja ime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për diskutim janë paraqitur edhe 3 diskutues. Fjalën e ka....

(Ndërhyrje)

Shikoni, në emër të grupit parlamentar ia dhamë mundësinë, sepse është fjala për një propozim të Qeverisë dhe kishim shkuar në votim, meqë edhe ashtu jemi lodhur. Grupet parlamentare nuk janë paraqitur. Atëherë, shkojmë në votim. Para se të votojmë, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 70

deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten... Naim, jemi futur në procedurat e votimit. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 14 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e trembëdhjetë:

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit këshilldhënës për Mbrojtjen e Mjedisit

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshilldhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, nëse e do fjalën, e ka kërkuar, Naser Rugova, që ta marrë fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur me datën 11.6.2010 shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin rekomandohen anëtarët e Bordit mjedisor dhe vendosi që Kuvendit t’i propozojë këtë rekomandim, që:

- Behxhet Mustafa,
- Sylejman Berisha,
- Islam Fejza,
- Kemajl Bislimi,
- Nysrete Doda-Gashi,
- Tush Markaj, dhe
- Luan Shllaku,

të votohen, do të thotë, dhe lus deputetët që ta votojnë këtë përbërje, sepse kanë qenë para komisionit dhe vërtet janë propozime shumë profesionale dhe janë njerëz të thirrur nga fusha e mjedisit dhe politikave mjedisore në vend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Dëgjuat propozimin e përfaqësuesit të komisionit funksional. Nuk kemi më të paraqitur për diskutim, shkojmë në votim. Në sallë kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve, i kemi 62 deputetë dhe në ndërkohë ndërron numri, kemi më shumë deputetë – 69. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 4 abstenime dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshilldhënës për Mbrojtjen e Mjedisit. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërmbëdhjetë, të fundit:

14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e drunjve” në Prishtinë

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e drunjve” në Prishtinë dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për shqyrtim dhe miratim.

Në emër të komisionit funksional, fjalën e ka kërkuar deputeti Naser Rugova, që ta arsyetojë këtë raport me rekomandimet.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Po ashtu, edhe këtë propozim-vendim të Qeverisë, komisioni funksional e ka shqyrtuar me datën 6.7.2010 dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta miratojë në seancën plenare Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale 31141 deri në ngastrën kadastrale 31252, me sipërfaqe prej 90.736 metra katrorë, te vendi i quajtur “Lama e drunjve”, e cila është pronë e IMN “Kosova”. Gjithashtu, ky propozim-vendim është i bazuar në Vendimin e Komunës së kryeqytetit të Prishtinës dhe është në përputhje me planin urbanistik të qytetit dhe duke ditur interesin publik për ndërtimin e institucioneve arsimore atje, i rekomandojmë Kuvendit dhe lus deputetët që ta mbështesin këtë propozim-vendim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe këtu e dëgjuat propozimin.... Fjalën e ka kërkuar deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: ... Lama e drunjtëve, drunjve e të tjera, por “Lama e druve”, ashtu si e thekson populli, ashtu edhe duhet të shkruhet. Thuaje mirë, vëlla!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët që të përgatitemi për votim. Në sallë kemi të pranishëm 68 deputetë dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e druve” në Prishtinë.

Të nderuar deputetë, konstatoj përfundimin e punimeve të kësaj seance. Ju falënderoj! Seanca e radhës, sipas ftesës që e keni, nesër dhe të hënën.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës